



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT**

**Nr. 314 Akti**

**Nr. 503 Vendimi  
Tiranë, më 18.1.2022**

**V E N D I M**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

<b>Etleda Çiftja</b>	<b>Kryesuese</b>
<b>Firdes Shuli</b>	<b>Relatore</b>
<b>Roland Ilia</b>	<b>Anëtar</b>

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Ertugena Sokoli, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Branko Hrvatin, në datat 14.1.2022 dhe 18.1.2022, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

**SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:** **Z. Drini Pali**, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

**OBJEKTI:** **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

**BAZA LIGJORE:** **Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;**

**Ligji nr. 84/2016**, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

**Ligji nr. 44/2015**, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

**Ligji nr. 49/2012**, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

**TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,**

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, znj. Firdes Shuli, mori në shqyrtim çdo provë dhe dokument të vënë në dispozicion nga organet kompetente ligjore, shpjegimet dhe provat shpresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, përfundoi procesin e rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit Drini Pali, i cili në seancë dëgjimore publike kërkoi konfirmimin në detyrë, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

## V Ë R E N:

### I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Z. Drini Pali është subjekt i rivlerësimit për shkak të funksionit të tij si prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, bazuar në nenin 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim ligji nr. 84/2016).

2. Bazuar në pikën 2, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin të Pavarur të Kualifikimit”, është zhvilluar shorti në datën 12.11.2019, në përfundim të të cilit rezultoi që subjekti i rivlerësimit Drini Pali do t’i nënshtrohej procesit të rivlerësimit, nga trupi gjykues i përbërë nga komisionerët Etleda Çiftja, Firdes Shuli dhe Roland Ilia. Relatore e çështjes u zgjodh me short komisionere Firdes Shuli. Në vijim, nga relatori i çështjes janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016.

3. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, u administruan raportet e vlerësimit të hartuara: (i) nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI), sipas neneve 31 - 33, të ligjit nr. 84/2016; (ii) Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK), sipas neneve 34 - 39, të ligjit nr. 84/2016; (iii) Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim KLP), sipas neneve 40 - 44, të ligjit nr. 84/2016.

4. Me vendimin nr. 1, datë 20.11.2019, trupi gjykues vendosi të fillojë hetimin administrativ, sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit të subjektit Drini Pali, duke u bazuar në të tria kriteret e rivlerësimit, si dhe të caktojë kryesuesin e trupit gjykues, komisioneren Etleda Çiftja. Të gjithë anëtarët deklaruan mosqenien në kushtet e konfliktit të interesit. Subjekti deklaroi në rrugë elektronike në datën 17.12.2019, se nuk ka konflikt interesi me anëtarët e trupit gjykues.

5. Me vendimin nr. 2, datë 14.12.2021, trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh prej relatores së çështjes me rezultatet e hetimit dhe me provat e grumbulluara për kriterin të tria kriteret, vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale, vendosi: (i) përfundimin e hetimit kryesisht për të tria kriteret e vlerësimit për subjektin e rivlerësimit Drini Pali; (ii) njoftimin e subjektit të rivlerësimit për t’u njohur me materialet e dosjes; (iii) kalimin e barrës së provës subjektit për të paraqitur shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, mbështetur në pikën 5, të nenit Ç, të Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

6. Në datën 21.12.2021, përmes postës elektronike, trupi gjykues njoftoi subjektin e rivlerësimit mbi: (i) rezultatet e hetimit administrativ për të tria kriteret; (ii) kalimin e barrës së provës, sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, për të dhënë sqarime mbi konstatimet e Komisionit, jo më vonë se data 10.1.2022; (iii) njohjen me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016, si dhe nenet 45 - 47 dhe 35 - 40, të Kodit të Procedurave Administrative.

7. Në datën 10.1.2022, subjekti i rivlerësimit, pasi ishte njohur me aktet e dosjes në datën 22.12.2021, dërgoi me anë të postës elektronike shpjegimet e tij dhe dokumentacionin shoqërues mbi rezultatet e hetimit administrativ kryesisht.

8. Pas shqyrtimit të shpjegimeve dhe provave të vëna në dispozicion nga subjekti, me vendimin nr. 3, datë 12.1.2022, trupi gjykues vendosi kalimin në seancë dëgjimore.

9. Në datën 14.2.2022, u zhvillua seanca dëgjimore, në të cilën subjekti i rivlerësimit ishte i pranishëm, i shoqëruar nga av. A. S. dhe në përfundim kërkoi konfirmimin në detyrë.

## **II. PARIME TË PËRGJITHSHME TË PROCESIT TË RIVLERËSIMIT**

10. Procesi i rivlerësimit që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces administrativ kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, me qëllim garantimin e funksionimit të shtetit të së drejtës, pavarësisë së sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

11. Parashikimet e pikës 2, të nenit 179/b, të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, në nenin 4, pika 5 dhe nenin 52, pika 1, të tij, kanë përcaktuar qartë të gjitha rregullat e posaçme për kryerjen e rivlerësimit mbi bazën e parimeve thelbësore që përfaqësojnë elementet e një procesi sa më objektiv mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor.

12. Sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit. Sipas kreut V të ligjit nr. 84/2016, DSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin në lidhje me kontrollin e figurës. Sipas kreut VI të ligjit nr. 84/2016, parashikohen burimet për rivlerësimin e aftësive profesionale dhe procedura që duhet të ndiqet nga organet ndihmëse.

13. Referuar vendimit nr. 2/201721 të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

## **III. FAKTET DHE PROVAT MBI TË CILAT ËSHTË MARRË VENDIMI**

### **Vlerësimi i pasurisë**

14. Në zbatim të nenit 31/1 të ligjit nr. 84/2016, rezulton se subjekti i rivlerësimit Drini Pali, ka dorëzuar në ILDKPKI deklaratën e pasurisë në datën 27.1.2017, pra, në periudhën kur ligji ka qenë në fuqi dhe brenda afatit 30-ditor nga hyrja e tij në fuqi. Gjithashtu, në referencë të nenit 32/2 të ligjit nr. 84/2016 dhe në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, si dhe ligjit nr. 9367, datë 10.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, vërehet se subjekti i rivlerësimit Drini Pali është bërë subjekt deklarues në ILDKPKI në vitin 2003, me nr. indeksi \*\*\* dhe ka dorëzuar rregullisht deklaratat e interesave private 2003 – 2010, 2012 dhe në vijim.

15. ILDKPKI-ja ka dërguar aktin e përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë, ku në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera për subjektin Drini Pali, ka konstatuar se: (i) deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin; (ii) ka mungesë dokumentacioni për të justifikuar pasuritë; (iii) ka mosdeklarime të pasurisë ndër vite; (iv) nuk ka kryer deklarim të rremë; (v) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

16. Në përmbushje të funksioneve të tij kushtetuese, sipas pikës 1, të nenit 45, të ligjit nr. 84/2016, Komisioni ka kryer një proces të plotë hetimi administrativ për pasurinë e subjektit të rivlerësimit Drini Pali, si dhe të personave të lidhur me të, sipas dispozitave ligjore të kreut

VII të ligjit nr. 84/2016, bazuar në: (i) deklaratimet e subjektit në ILDKPKI; (ii) provat shkresore të administruara nga ky institucion dhe raporti i dorëzuar në Komision; (iii) çdo dokument ligjor që përbën mjet prove ligjore të kërkuar nga Komisioni gjatë procesit të rivlerësimit, sipas nenit 49 të ligjit nr. 84/2016; (iv) komunikimet me subjektin sipas nenit 46 të ligjit nr. 84/2016 dhe dispozitave përkatëse të Kodit të Procedurave Administrative; (v) sugjerime të vëzhguesit ndërkombëtar sipas nenit 49 pika 11, të ligjit nr. 84/2016.

**17.** Hetimi administrativ, në lidhje me rivlerësimin e pasurisë, konsistoi në: (i) verifikimin e vërtetësisë së deklaratimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe të personave të lidhur në deklaratat periodike vjetore (në vijim DPV) dhe në deklaratën *Vetting*; (ii) verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve, me qëllim evidentimin ose jo të mungesës së burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; (iii) evidentimin ose jo të fshehjes së pasurive; (iv) evidentimin e deklaratimeve të rreme; si dhe (v) nëse subjekti ndodhet në situatën e konfliktit të interesit, me qëllim vërtetimin ose jo të deklaratimeve të pamjaftueshme në lidhje me kriterin pasuror, sipas parashikimit të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, i cili i referohet nenit 33 të tij.

**18. Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar:** *“Apartament nr. \*\*\*, me sip. 110.45 m<sup>2</sup>, rruga ‘\*\*\*’, ish-\*\*\*, Tiranë, blerë me kontratën e sipërmarrjes nr. \*\*\*, datë 14. 7.2015. Burimi i krijimit: kursime nga paga (kursime në shumën 565.000 lekë, gjendje në datën 31.12.2015, në llogarinë në ‘Raiffeisen Bank’), të ardhura nga paga nga puna si prokuror dhe nga fondi i investimeve në ‘Raiffeisen Bank’, të ardhura nga vendimi gjyqësor nr. \*\*\*, datë 22.9.2011, total në shumën 1.500.000 lekë. Dhuratë në shumën 3.500.000 lekë dhënë nga prindërit e bashkëjetueses G.N. me transfertën në datën 25.6.2015, nga llogaria nr. \*\*\*, në NBG, nga P. N. në BKT, nr. llogarie \*\*\*\*\*, këto të ardhura të siguruara pas shitjes së apartamentit të ndodhur në rrugën ‘\*\*\*’, pallati \*\*\*, hyrja \*\*\*, ap. \*\*\*, Tiranë, me kontratë shitblerjeje nga N. K. B. Nr. \*\*\*, regjistruar sipas certifikatës së pronësisë nr. \*\*\*, nr. pasurie \*\*\*. Vlera: 5.000.000 lekë. Pjesa takuese: 50%”.*

**18.1** Në lidhje me këtë pasuri, ILDKPKI-ja ka konstatuar:

- Mungesë dokumentacioni justifikues ligjor, për shprehjen e vullnetit të shtetasit P. N., lidhur me dhuratën në shumën 3.500.000 lekë, kaluar me transfertë bankare në favor të vajzës G. N. Dokumentohet transfertat e kryer, por nuk qartësohet nëse shuma është dhuratë apo detyrim dhe as qëllimi i përdorimit.

- Mungesë dokumentacioni justifikues ligjor, lidhur me pagesën në shumën 2.500.000 lekë, të kryer nga znj. G. N. në favor të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., për blerjen e apartamentit me sip.110.45 m<sup>2</sup>, të ndodhur në rrugë “\*\*\*\*”, ish-\*\*\*, Tiranë, me vlerë 5.000.000 lekë. Referuar deklaratimeve të subjektit (në deklaratat e interesave private 2015-2016 dhe deklaratës së rivlerësimit), detyrimi i mbetur ndaj shoqërisë së ndërtimit është në shumën 1.000.000 lekë, i cili do të paguhet nga znj. G. N. me marrjen në dorëzim të apartamentit dhe përpilimin e kontratës së shitblerjes.

**Në lidhje me mënyrën e krijimit të pasurisë dhe statusin e saj, gjatë hetimit administrativ të Komisionit, nga aktet<sup>1</sup> në dosje rezultoi se:**

**19.** Me vendimin nr. \*\*\* prot., datë 18.11.2013, të kryetarit të bashkisë, subjektit ndërtues “\*\*\*\*” sh.p.k. i është miratuar leja zhvillimore e ndërtimit nr. \*\*\* prot., datë 17.1.2014, për objektin “strukturë 1.3.4.5 dhe 6 kat banimi dhe shërbime me 1 kat parkim nëntokë”, në pronë të znj. B. B. etj., me vendndodhje në rrugën “\*\*\*\*”, K\*\*\*.

<sup>1</sup>Shihni aktet në Anexsin \*\*\* në dosjen e ILDKPKI-së.

**20.** Me kontratë sipërmarrjeje nr. \*\*\*, datë 14.7.2015, shtetasit Drini Pali dhe G. N., në cilësinë e porositësve kanë porositur nga investitori “\*\*\*\*” sh.p.k. apartamentin nr. \*\*\*, 2+1 dhe ambiente ndihmëse, kati i \*\*\* i banimit, shkalla \*\*\*, në rrugën “\*\*\*\*”, Tiranë, me sipërfaqe ndërtimore 110.45 m<sup>2</sup>, nga të cilat 97.83 m<sup>2</sup> sipërfaqe e shfrytëzueshme dhe 12.62 m<sup>2</sup> sipërfaqe e përbashkët me çmim 5.000.000 lekë.

**21.** ASHK-ja<sup>2</sup> nuk ka konfirmuar të regjistruar në emër të subjektit dhe bashkëjetueses këtë pasuri. Në përgjigjet e pyetësorit nr. 2, subjekti sqaroi se ky apartament nuk është ende i regjistruar në hipotekë, pasi ende nuk është lidhur kontrata e shitblerjes.

**22.** Për këtë apartament është lidhur kontrata e furnizimit me energji elektrike me nr.\*\*\*. Nga të dhënat e FSHU-së<sup>3</sup> konstatohet se kjo kontratë vijon të jetë në emër të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k. dhe se pagesat kanë nisur që prej muajit maj të vitit 2016 në vlera aforfe, ndërsa pagesat e mirëfillta për shpenzimin e energjisë, fillojnë në muajin dhjetor të vitit 2018. Ky fakt përputhet edhe me deklarimin e subjektit gjatë procesit të rivlerësimit se jetesën në këtë apartament e ka nisur në periudhën dhjetor 2018 – janar 2019.

**23.** UKT-ja<sup>4</sup> konfirmoi kontratën nr. \*\*\*, në emër të shtetasit Drini Pali, të bërë të ditur edhe nga subjekti i rivlerësimit, për objektin në rrugën “\*\*\*\*”, Tiranë, me detyrime të likuiduara deri në muajin dhjetor të vitit 2019, por nuk ka informacion për datën e hapjes.

#### **Në lidhje me mënyrën e likuidimit të çmimit të shitjes dhe deklarimet e subjektit**

**24.** DPPP-ja<sup>5</sup> ka informuar se për shtetasin Drini Pali ka raportime të kontratës së sipërmarrjes nr. \*\*\*, datë 14.7.2015, me anë të së cilës ka porositur apartament me çmim të deklaruar 5.000.000 lekë nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k. Kjo kontratë, e cila është deklaruar nga subjekti në DPV-në e vitit 2015, parashikon se:

**24.1.** *“Drini Pali do të paguajë një shumë prej 1.500.000 lekësh dhe në këtë raport do të jetë bashkëpronar në apartamentin e porositur prej tyre; kjo shumë do të paguhet brenda datës 15.8.2015; pagesa e këtij çmimi, vërtetohet me akt bankar ‘njoftim debitimi’ të ‘Raiffeisen Bank’, datë 13.8.2015, sipas të cilit Drini Pali ka paguar shumën 1.500.000 lekë me përshkrim ‘pagesë blerje apartamenti sipas kontratës nr. \*\*\*, datë 14.7.2015’, në llogarinë e shoqërisë ‘\*\*\*\*’ sh.p.k. në llogarinë e tij në BKT”.* I pyetur gjatë procesit të rivlerësimit në lidhje me pjesën e tij takuese prej 50%, të deklaruar në deklaratën *Vetting*, ndërkohë që sipas kontratës kjo pjesë do të ishte sa kontributi i tij, subjekti në përgjigjet e pyetësorit nr. 2 deklaroi se ka rënë dakord me bashkëjetuesen që bashkëpronësia e tyre do të jetë në raportin 50%, fakt ky që sipas tij do të pasqyrohet edhe në kontratën e shitjes që do të lidhet në të ardhmen.

Subjekti ka deklaruar në DPV-në e vitit 2015 pakësimin e llogarisë në “Raiffeisen Bank”, me nr. \*\*\*, datë 13.8.2015, për pagesën e shumës prej 1.500.000 lekësh për blerjen e apartamentit. Ndërkohë nga verifikimi i të dhënave bankare rezulton se në datën 13.8.2015, shuma 1.500.405 lekë është transferuar nga llogaria e subjektit në llogarinë e shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., në “Raiffeisen Bank”, me përshkrimin “pagesë blerje apartamenti sipas kontratës nr. \*\*\*, datë 14.7.2015, ap. nr. \*\*\*, 2+1, shkalla \*\*\*”, pra, sipas parashikimit të kontratës së porosisë, brenda datës 15.8.2015.

**24.2.** Znj. G.N. do të paguajë një shumë prej 3.500.000 lekësh dhe në këtë raport do të jetë bashkëpronare në apartamentin e porositur prej tyre. Kjo shumë do të paguhet prej saj si vijon:

<sup>2</sup>Shihni shkresën kthim përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 22.1.2020 nga ASHK Tirana Veri; shkresë kthim përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 18.1.2020, nga ASHK Tirana Rurale 2; shkresë kthim përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 27.1.2020, nga ASHK Kamëz Vorë; shkresë kthim përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 5.2.2020, nga ASHK Tirana Jug.

<sup>3</sup>Shihni informacionin e dërguar nga FSHU-ja në rrugë elektronike, në dosjen e Komisionit.

<sup>4</sup>Shihni shkresën kthim përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 23.1.2020, nga UKT-ja në dosjen e Komisionit.

<sup>5</sup>Shihni shkresën kthim përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 15.01.2020 nga DPPP-ja në dosjen e Komisionit.

shuma prej 2.500.000 lekësh brenda datës 1.8.2015; shuma prej 1.000.000 lekësh do të paguhet nga G.N. në dy këste: (a) shuma prej 500.000 lekë do të paguhet në datën që porositësit do të marrin në dorëzim të përfunduar apartamentin nga sipërmarrësi; (b) pjesa e mbetur prej 500.000 lekë do të paguhet në datën e hartimit të kontratës së shitblerjes dhe do të derdhet në llogarinë bankare të noterit; të gjitha pagesat e mësipërme do të bëhen në BKT në llogarinë bankare të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., nr. llogarie \*\*\*, përveç shumës prej 500.000 lekësh që do të derdhet në llogarinë e noterit dhe do të kalojnë në llogarinë e shitësit, pas lëshimit të certifikatës së pronësisë.

Bashkëjetuesja e subjektit ka deklaruar në DPV-në e vitit 2015: (i) pagesën e kështit në shumën prej 2.500.000 lekësh, duke deklaruar *pakësim i depozitës në BKT me 2.500.000 lekë në datën 14.7.2015, si pagesë për blerje apartamenti sipas kontratës nr. \*\*\*, datë 14.7.2015, shoqërisë ‘\*\*\*’ sh.p.k.*; si dhe (ii) detyrimin në shumën 1.000.000 lekë ndaj shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., që rrjedh nga kontrata e sipërmarrjes, datë 14.7.2015, për blerjen e apartamentit me sip. 110.45 m<sup>2</sup>, nr. \*\*\*, rruga “\*\*\*\*”, \*\*\*, Tiranë. Ky detyrim financiar në shumën 1.000.000 lekë është deklaruar në DPV-në e vitit 2016 dhe në vijim edhe në deklaratën *Vetting*. Nga lëvizjet e llogarisë në BKT, rezulton se në datën 14.7.2015, shuma 2.500.000 lekë, është transferuar nga llogaria e shtetasës G. N. në llogarinë e shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., me përshkrimin “G. P. N. për shoqërinë ‘\*\*\*’ sh.p.k., për likuidim kësti për blerje apartamenti”, pra, sipas parashikimit të kontratës së porosisë brenda datës 15.8.2015.

**25.** Sa më sipër, u vërtetua se është paguar në total shuma prej 4.000.000 lekësh dhe ka mbetur si detyrim i papaguar ndaj shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k. shuma 1.000.000 lekë. Në përfundim të hetimit administrativ, nuk u evidentuan problematika në lidhje me likuidimin e çmimit të shitjes së pasurisë.

### **Në lidhje me trajtime të mundshme preferenciale në blerjen e pasurisë**

**26.** Sipas kontratës së sipërmarrjes, datë 14.7.2015, çmimi i apartamentit me sip. 110.45 m<sup>2</sup> është në vlerën 5.000.000 lekë. Ndërkohë që referuar çmimit të referencës për zonën përkatëse, rezulton që ky çmim të jetë 65.000 lekë/m<sup>2</sup>. Kështu, për sipërfaqen 110.45 m<sup>2</sup> vlera e apartamentit do të ishte 7.179.250 lekë<sup>6</sup> ose 44% më e lartë se vlera e paguar prej subjektit.

**27.** Pas kërkesës së Komisionit, shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k.<sup>7</sup> vuri në dispozicion 10 kontrata të tjera sipërmarrjeje të lidhura në periudhën 2014 – 2017, me objekt apartamente në të njëjtën godinë, nga përmbajtja e të cilave vihet re se çmimet për metër katror të blerësve të të gjitha apartamenteve, variojnë nga çmimi minimal 424 euro/m<sup>2</sup> në çmimin maksimal 550 euro/m<sup>2</sup> (në këto kontrata çmimi për metër katror, është përlllogaritur së bashku me sipërfaqet e përbashkëta). Ndërsa referuar kontratës së subjektit, vlera e apartamentit është 5.000.000 lekë, për një sipërfaqe totale 110.45 m<sup>2</sup>, ose çmimi i paguar për metër katror është 45.237 lekë/m<sup>2</sup> ose 329 euro/m<sup>2</sup>. Pra, krahasimisht me 10 apartamentet e tjera, çmimi i paguar nga subjekti është rreth 25% më i ulët se çmimi minimal dhe 40% (1.7 herë) më i ulët se çmimi maksimal.

**28.** Pas verifikimeve në drejtim të ndonjë konflikti të mundshëm interesi në kryerjen e detyrës nga subjekti, nuk rezultuan çështje të shqyrtuara<sup>8</sup> nga subjekti, ku palë me çfarëdolloj statusi

<sup>6</sup><https://www.tirana.al/artikull/informacion-mbi-tregun-e-pasurive-te-palujtshme-ne-qytetin-e-tiranes>  
[http://ekb.gov.al/wp-content/uploads/2015/11/UKM-4-dt.-30.09.15-Kosto-mes.ndert\\_banesave-2015.pdf](http://ekb.gov.al/wp-content/uploads/2015/11/UKM-4-dt.-30.09.15-Kosto-mes.ndert_banesave-2015.pdf)

<sup>7</sup>Shihni shkresën kthim përgjigje datë 4.7.2021, nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., protokolluar nga Komisioni me nr. \*\*\* prot., datë 7.7.2021, në dosjen e Komisionit.

<sup>8</sup>Shihni shkresën kthim përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 19.4.2021, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës dhe shkresë kthim përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 9.7.2021, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, në dosjen e Komisionit.

të kenë qenë shtetasit R. B. dhe G. K., përfaqësues ligjorë të investitorit “\*\*\*\*” sh.p.k., apo të dhëna për përfshirje të tyre në veprimtari të krimit të organizuar<sup>9</sup>.

**29.** Në përfundim të hetimit administrativ, ishte e paqartë përse pasuria është blerë me çmim më favorizues krahasuar me blerësit e tjerë. Për këtë arsye, subjektit i është kërkuar të japë sqarime me dërgimin e rezultateve të hetimit administrativ. Në parashtrimet e tij, subjekti ka deklaruar se çmimi i apartamentit është real, i përcaktuar me vullnet të lirë dhe të pavesuar të palëve, në kuadër të lirisë kontraktore sipas legjislacionit civil dhe se nuk ka pasur asnjëherë ndonjë konflikt interesi me palën shitëse. Në mbështetje të deklarimeve të tij, subjekti ka paraqitur deklaratë noteriale nr. \*\*\*, datë 6.1.2022, të administratorit të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., z. G. K., në të cilën paraqiten shkaqet e përcaktimit të çmimit të shitjes më të ulët se kontratat e tjera si: (i) pozita e vështirë financiare e shoqërisë në kohën e shitjes çka ka sjellë që blerësit ta likuidojnë shumicën e vlerës menjëherë; (ii) vendndodhja jo e favorshme dhe jo e kërkueshme e apartamentit, për shkak të zhurmës së ashensorit që kalonte pranë dhomës së gjumit; (iii) sipërfaqja e shfrytëzueshme e kufizuar e dhomës së fëmijëve për shkak të dy kolonave në të; (iv) vendndodhja në pjesën veriore dhe lindore e apartamentit dhe me ballkon të pambuluar; (v) mospasja e pretendimeve për rifinitura të brendshme dhe cilësore nga ana e blerësve (pllaka, parket, hidrosanitare, elektrike, bojatisje etj.).

**30.** Gjithashtu, subjekti ka sjellë në vëmendje të Komisionit vendimin nr. 5/2019, të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në të cilin arsyetohet se: *“Trupi gjykues i Kolegjit arsyeton se dyshimet e ngritura nga Komisioni në vendimin nr. \*\*\*, datë 12.7.2018, nëse çmimi i kontratës së shitjes së vitit 2009 është i drejtë ose jo, nuk janë të bazuara, megjithëse nuk e ngarkojnë subjektin me përgjegjësi. Në Kodin Civil nuk ka dispozita që të rregullojnë çmimin e drejtë dhe as dispozita mbi pavlefshmërinë e shitjes, nëse çmimi është i padrejtë. Sipas neneve 92 dhe 93 të Kodit Civil, veprimi juridik i shitjes me një çmim të padrejtë mund të goditet vetëm për fiktivitet. Duke qenë se nga aktet e administruara gjatë hetimit administrativ rezulton se kontrata e shitjes është në formën e kërkuar nga ligji dhe nuk është provuar fiktiviteti i saj, trupi gjykues i Kolegjit arrin në përfundimin se çmimi i përcaktuar në këtë kontratë nuk është relevant për çështje”.*

**31.** Sa i takon referimit në vendimin e KPA, vlen të theksohet se, edhe pse nuk janë ngritur dyshime nga Komisioni nëse çmimi i shitjes është i drejtë ose jo, subjektit i janë kërkuar shpjegime në lidhje me blerjen e pasurisë në një çmim më të ulët se çmimi i referencës dhe çmimi në kontrata të ngjashme. Në analizë të parashtrimeve dhe dokumenteve të paraqitura, u konstatua se subjekti është përpjekur dhe ka evidentuar shkaqet që kanë ndikuar në këtë çmim, duke paraqitur një dokument shkresor lëshuar nga shoqëria sipërmarrëse. Veç kësaj, sikurse me të drejtë subjekti pretendon, çmimi i shitjes është pasojë e vullnetit të lirë dhe të pavesuar të palëve, bazuar në lirinë kontraktore civile, për më tepër kushtet kur, nga hetimi administrativ nuk rezultuan të dhëna për konflikt interesi gjatë ushtrimit të detyrës me administratorin e shoqërisë apo përfaqësuesit ligjorë të saj, apo *indicie* të tjera të çfarëdolloji në këtë drejtim. Në këto rrethana, si dhe në kushtet kur nuk janë gjendur elemente që bëjnë kontratën një akt të pavlefshëm, Komisioni çmoi se nuk gjendet përpara një situatë të trajtimit preferencial të subjektit në blerjen e pasurisë për shkak të detyrës.

### **Në lidhje me burimin e krijimit të pasurisë**

**32.** Komisioni kreu verifikime për të dyja burimet e deklaruara nga subjekti, nga ku rezultoi se:

**32.1.** Sa i takon shumës në total prej 1.500.000 lekësh, u vërtetua burimi i ligjshëm i krijimit të saj me:

<sup>9</sup>Shihni shkresën kthim përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 19.4.2021, nga SPAK-u në dosjen e Komisionit.

i) Të ardhura nga fondi i investimeve në “Raiffeisen Bank”, në shumën 1.000.000 lekë. Ky fond investimesh është çelur në datën 8.10.2013 dhe e ka burimin nga të ardhurat e përfituara nga vendimi gjyqësor nr. \*\*\*, datë 22.9.2011, i Gjykatës së Apelit Tiranë<sup>10</sup>, vendim i cili është ekzekutuar në datën 27.9.2013, kur shuma 2.170.344 lekë ka kaluar në llogarinë e subjektit Drini Pali, në “Raiffeisen Bank”.

ii) Kursimet nga pagat e pa tërhequra në bankë, të cilat deri në datën 4.8.2015 kanë qenë në shumën 430,480.16 lekë.

Shumat e mësipërme, së bashku me interesat e përfituara nga investimi i shumës 1.000.000 lekë në fondin Raiffeisen Prestige, kanë krijuar shumën 1.500.000 lekë, e cila është përdorur për pagesën e apartamentit shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k.

**32.2.** Sa i takon shumës 3.500.000 lekë dhënë nga prindërit e bashkëjetueses G. N., nga aktet e administruara gjatë hetimit administrativ, u konstatua se:

- Me kontratë shitblerjeje nr. \*\*\*, datë 20.12.1993, shtetasit P. N., B. N. dhe A. N. kanë blerë nga N. K. B. Nr. \*\*\*, apartamentin me sip. 75 m<sup>2</sup>, në rrugën “\*\*\*\*”, me çmim 16.969 lekë, e cila u regjistrua në emër të tyre, sipas certifikatës lëshuar në datën 17.8.2010, si pasuria nr. \*\*\*<sup>11</sup>.

- Me kontratë shitjeje me kusht nr. \*\*\*, datë 29.4.2015, pala shitëse P.N., B. N. dhe A. H. (N.) i shesin blerësit G. L., pasurinë me nr. \*\*\*, kundrejt çmimit 3.500.000 lekë, shumë me të cilën blerësi do të likuadojë palës shitëse në llogarinë e z. P. N., me marrjen e kredisë në NBG dhe do të vërtetohet me mandat bankar të lëshuar nga kjo bankë<sup>12</sup>.

- Nga verifikimi i lëvizjeve të llogarisë në NBG (sot ABI Bank)<sup>13</sup>, evidentohet se në datën 25.6.2015 është kryer një transfertë në shumën 3.499.930 lekë nga z. G. L. te llogaria e babait të bashkëjetueses, z. P. N., me përshkrimin “kalimi shumës sipas kontratës së shitblerjeje nr. \*\*\*, datë 29.4.2015”. Po në të njëjtën datë më 25.6.2015, shuma 3.501.500 lekë është transferuar nga llogaria e z. P. N. në NBG te llogaria e znj. G. N. në BKT, me përshkrimin “transfertë nga shitja e pronës”.

- Në DPV-në e vitit 2015, bashkëjetuesja e subjektit ka deklaruar: “Llogari në BKT me gjendje 300,000 lekë dhe 761 euro, shtuar në datën 26.6.2015 me shumën 3.500.000 lekë, sipas transfertës nga NBG nga babai P.N., si dhuratë nga shitja e apartamentit në rr. ‘\*\*\*\*’, p. \*\*\*, h. \*\*\*, ap. \*\*\*, \*\*\*, Tiranë”.

- Për të ardhurat nga shitja është paguar tatimi në burim në shumën 337.530 lekë nga z. P. N., sipas mandatpagesës në datën 29.4.2015 të “Credins Bank”<sup>14</sup>.

- Në datën 14.7.2015, shuma 2.500.000 lekë, është transferuar nga llogaria e znj. G. N. në llogarinë e shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k. me përshkrimin “G. P. N. për ‘\*\*\*\*’ sh.p.k., për likuidim kësti për blerje apartamenti”.

- Sa i takon shprehjes së vullnetit të të gjithë bashkëpronarëve të pasurisë për kalimin e çmimit të shitjes së pasurisë te znj. G. N., në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti paraqiti deklaratë noteriale të shtetasit P. N., në të cilën konfirmon dhurimin e shumës prej 3.500.000 lekësh vajzës së tij. Ndërsa me kërkesë të Komisionit, në parashtrimet e datës 10.1.2022, subjekti ka paraqitur dy deklarata noteriale të znj. B. N. dhe znj. A. N. (përkatësisht nëna dhe motra e znj.

<sup>10</sup>Sipas këtij vendimi Prokuroria e Përgjithshme ka detyrimin të paguajë në favor të paditësit Drini Pali pagën për gjithë kohën e qëndrimit pa punë, vendim i lënë në fuqi me vendimin nr. 341, të datës 28.6.2012, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

<sup>11</sup>Shihni aktin në aneksin \*\*\* në dosjen e ILDKPKI-së.

<sup>12</sup>Shihni aktin në aneksin \*\*\* në dosjen e ILDKPKI-së.

<sup>13</sup>Shihni shkresën kthim përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 6.1.2020, nga “ABI Bank”, në dosjen e Komisionit.

<sup>14</sup>Shihni shkresën kthim përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 5.2.2020, nga ASHK Tirana Jug.



G. N.), ku ato shprehen dakord për dhurimin e shumës prej 3.500.000 lekësh vajzës dhe motrës së tyre G. N.

Bazuar në sa më sipër, shuma prej 3.500.000 lekësh është konsideruar si e ardhur e ligjshme në analizën financiare të kryer për blerjen e apartamentit objekt shqyrtimi, referuar në mënyrë të përmbledhur fakteve dhe rrethanave si vijojnë: (i) u vërtetua mënyra e ligjshme e përfitimit të saj dhe pagimi i tatimit mbi këtë të ardhur sipas ligjit; (ii) dhurimi i kësaj shume është deklaruar në DPV-në e vitit 2015 nga bashkëjetuesja e subjektit; (iii) është vërtetuar vullneti i bashkëpronareve për dhurimin e kësaj shume; (iv) të gjitha lëvizjet e shumës prej 3.500.000 lekësh janë kryer në rrugë bankare me përshkrime të rregullta veprimesh bankare.

**33.** Në përfundim të hetimit administrativ, referuar analizës së burimeve si më sipër, u provua se shuma prej 4.000.000 lekësh, paguar për blerjen e apartamentit objekt shqyrtimi në datën 13.8.2016, nga të cilat 2.500.000 lekë paguar nga bashkëjetuesja dhe 1.500.000 lekë paguar nga subjekti, është krijuar me burime të ligjshme. Pjesa tjetër, vlera prej 1.000.000 lekësh, është detyrim i pashlyer ndaj palës sipërmarrëse, deklaruar sipas ligjit nga subjekti i rivlerësimit në DPV për vitin 2015 dhe deklaratën vetting.

**34. Subjekti ka deklaruar në deklaratën Vetting:** “Apartament nr. \*\*\*, p. \*\*\*, ish-rruga ‘\*\*\*’, aktualisht rruga ‘\*\*\*’, ish-\*\*\*, Tiranë. Burimi i krijimit: trashëguar nga babai S.P., pjesa takuese sipas dëshmisë së trashëgimisë nr. \*\*\*, datë 26.12.2015, në pjesën 1/3 e pronësisë, datë 15.11.2015, fituar me kontratë shitblerje nga N. K. B. Nr. \*\*\*. Pjesa takuese: 25%”. Nuk është shënuar vlera. ILDKPKI-ja nuk ka konstatuar problematika në lidhje me këtë pasuri.

**35.** Në lidhje me këtë pasuri, nga Komisioni u kryen verifikimet si vijojnë:

- Me kontratën e shitjes nr. \*\*\*, datë 1.12.1995, blerësit N. P., S. P. dhe B. P. kanë blerë nga N. K. B. Nr. \*\*\*, ap. \*\*\*, që ndodhet në p. \*\*\*, rruga “\*\*\*”, 2+1, me sip. 65 m<sup>2</sup>, kundrejt shumës 2.816 lekë, regjistruar sipas kartelës së pasurisë si pasuria nr. \*\*\*<sup>15</sup>.

- ASHK-ja Tirana Jug<sup>16</sup> konfirmon të regjistruar në bashkëpronësi të shtetasve N. P. dhe S. P., apartament me sip. 65 m<sup>2</sup>, me nr. pasurie \*\*\*, z. k. \*\*\*. Subjekti vërtetoi lidhjen e kantatave të energjisë elektrike dhe ujit në emër të nenës së tij, për këtë pasuri.

- Me dëshminë e trashëgimisë nr. \*\*\*, datë 26.12.2015, janë përcaktuar trashëgimtarët ligjorë të radhës së parë të shtetasit S. P., të cilët janë B. P., R. P. (L.), Drini Pali, R. P., që trashëgojnë ¼ pjesë të pasurisë trashëgimore. I pyetur gjatë procesit të rivlerësimit, mbi rifreskimin e kartelës së pasurisë pas lëshimit të kësaj dëshmie, subjekti deklaroi<sup>17</sup> se nuk janë kryer veprime pranë ASHK-së për rifreskimin e saj dhe nga ana tjetër nuk ka asnjë marrëveshje mes bashkëpronarëve për mbajtjen e pasurisë nga ana e tij.

- Në deklaratën e vitit 2003 subjekti ka deklaruar këtë pasuri me burim krijimi nga ligji për privatizimin e banesave, pjesa takuese 1/5 dhe në vijim deri në deklaratën për vitin 2016, subjekti ka deklaruar si adresë banimi këtë pasuri.

- Në përgjigjet e pyetësorit nr. 1, subjekti ka deklaruar se që nga viti 2003, kur ka marrë detyrën për herë të parë, ka banuar në këtë banesë.

Në përfundim të hetimit administrativ, nuk rezultuan problematika dhe dyshime në lidhje me këtë pasuri.

<sup>15</sup>Shihni aktet në aneksin \*\*\* në dosjen e ILDKPKI-së dhe aktet bashkëngjitur shkresës kthim përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 6.2.2020, nga ASHK Tirana Jug, në dosjen e Komisionit.

<sup>16</sup>Shihni shkresën kthim përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 6.2.2020, nga ASHK Tirana Jug.

<sup>17</sup>Shihni përgjigjet e pyetësorit nr. 2 në dosjen e Komisionit.

**36. Subjekti ka deklaruar në deklaratën Vetting:** “Tokë arë me sipërfaqe 9710 m<sup>2</sup>, \*\*\*, Peshkopi. Burimi i krijimit: trashëguar nga babai S. P., pjesa takuese sipas dëshmisë së trashëgimisë nr. \*\*\*, datë 26.12.2015, fituar sipas ligjit nr. 7501, me AMTP nr. \*\*\*, \*\*\*, Peshkopi”. ILDKPKI-ja nuk ka konstatuar problematika në lidhje me këtë pasuri.

**37. Në lidhje me këtë pasuri, nga Komisioni u kryen verifikimet si vijojnë:**

- ASHK-ja Dibër<sup>18</sup> nuk ka konfirmuar të regjistruar këtë pasuri në emër të subjektit, bashkëjetueses apo prindërve të tij.

- ASHK-ja Njësia e Kadastrës dhe Hartografisë ka informuar se shtetasi Drini Pali dhe personat e lidhur me të nuk figurojnë si subjekte aplikues për vetëdeklarimin e ndonjë objekti informal në funksion të përfshirjes në procesin e legalizimeve.

- Sipas AMTP-së nr. \*\*\*, administruar nga ILDKPKI-ja, shtetasit S. R. P. si kryefamiljar, i jepet në pronësi sip. 9710 m<sup>2</sup> tokë arë<sup>19</sup>.

- Me dëshminë e trashëgimisë nr. \*\*\*, datë 26.12.2015, janë përcaktuar trashëgimtarët ligjorë të radhës së parë të shtetasit S. P., të cilat janë B. P., R. P. (L.), D. P., R. P., që trashëgojnë ¼ pjesë të pasurisë trashëgimore. Kjo pasuri është deklaruar saktësisht nga subjekti në DPV-në e vitit 2015.

- I pyetur gjatë procesit të rivlerësimit se nga kush zotërohet dhe për çfarë përdoret kjo pasuri aktualisht, subjekti deklaroi<sup>20</sup> se nuk ka dijeni se ku ndodhet fizikisht pasuria e përshkruar në AMTP dhe nuk ka dijeni se nga kush zotërohet apo është zotëruar kjo pasuri.

Në përfundim të hetimit administrativ nuk rezultuan problematika dhe dyshime në lidhje me këtë pasuri dhe deklaratimet e subjektit përputhen me dokumentet e administruara.

**38. Në deklaratën Vetting, subjekti ka deklaruar:** “Automjet tip ‘Volkswagen’, me targa \*\*\*. Burimi i krijimit: trashëguar nga babai S. P., pjesa takuese imja sipas dëshmisë së trashëgimisë. Ky automjet është dhuruar nga mua (sipas pjesës takuese) nënës time B. P. në bazë të kontratës së dhurimit që i bashkëlidhet deklaratimit. Ky automjet është blerë nga babai me kontratën e shitblerjes nr. \*\*\*, me të ardhurat e siguruara nga motra R. P., sipas deklaratës noteriale nr. \*\*\*, lëshuar në D\*\*\* Gjermani, me të ardhura të siguruara nga punësimi në Gjermani sipas kontratës së punës me ‘\*\*\*’. Vlera: 6.000 euro. Pjesa takuese: 25%”.

**38.1.** ILDKPKI-ja, në lidhje me këtë pasuri, ka konstatuar se: “Subjekti deklaroi pjesë takuese 25% edhe pse e ka dhuruar pjesën e tij”. Në deklaratën e interesave private 2016, subjekti nuk e ka deklaruar dhurimin e pjesës takuese të automjetit të përfituar nga trashëgimia ligjore e babait, në favor të nënës së tij.

**39.** Gjatë hetimit administrativ, nga aktet e administruara<sup>21</sup> rezultoi se në rend kronologjik janë kryer veprimet si vijojnë:

- Sipas faturës së shitjes të datës 27.1.2014, znj. Q. R. ka blerë automjetin tip “Volkswagen Golf”, targa \*\*\*, nr. shasie \*\*\*, në çmimin prej 4.185 euro, zhdoganuar në datën 31.1.2014, në shumën 121.092 lekë.

- Me kontratë shitblerjeje nr. \*\*\*, datë 16.7.2014, z. S. P. (babai i subjektit) ka blerë nga shtetasja Q. R. këtë automjet, në çmimin 6.000 euro.

<sup>18</sup>Shihni shkresën kthim përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 20.1.2020, nga ASHK Dibër në dosjen e Komisionit.

<sup>19</sup>Në certifikatën familjare të vitit 1991 rezultojnë se përbërja e familjes së origjinës së subjektit në datën 1.8.1991, është 6 persona: gjyshja e tij, dy prindërit dhe tre fëmijët.

<sup>20</sup>Shihni përgjigjet e pyetësorit nr. 2 në dosjen e Komisionit.

<sup>21</sup>Shihni aktet në aneksin \*\*\* në dosjen e ILDKPKI-së dhe përgjigjet e pyetësorit nr. 2, në dosjen e Komisionit.

- Me dëshminë e trashëgimisë nr. \*\*\*, datë 26.12.2015, janë përcaktuar trashëgimtarët ligjorë të radhës së parë të shtetasit S. P., të cilat janë B. P., R. P. (L.), Drini Pali, R. P., që trashëgojnë ¼ pjesë të pasurisë trashëgimore.

- Sipas kontratës së dhurimit të automjetit nr. \*\*\*, datë 26.12.2015, trashëgimtarët ligjorë të S. P., B. P., R. P., Drini Pali dhe R. P. i dhurojnë B. P. automjetin, i cili ishte pajisur me targa \*\*\*. Këtë kontratë subjekti e ka deklaruar në DPV-në e vitit 2015, me pjese takuese e subjektit 20%. Pra, subjekti edhe pse ka dhuruar pjesën e tij takuese në vitin 2015, vazhdon ta deklarojë përsëri këtë pjesë në deklaratën *Vetting*. I pyetur gjatë procesit të rivlerësimit mbi këtë fakt, subjekti sqaroi se ka vlerësuar ta deklarojë pjesën takuese edhe në deklaratën *Vetting*, për shkak se e ka pasur në bashkëpronësi për një periudhë të shkurtër kohore në vitin 2015, megjithatë kjo pasaktësi nuk ka pasur asnjë qëllim të kundërligjshëm.

- DPSHTRR-ja<sup>22</sup> nuk e ka konfirmuar të këtë automjet të regjistruar në emër të subjektit dhe personave të lidhur, ndërkohë nga dosja e DPSHTRR-së vënë në dispozicion nga subjekti<sup>23</sup>, konfirmohet se automjeti është regjistruar në DPSHTRR në datën 29.12.2015, në emër të znj. B. P., sipas kontratës së dhurimit nr. \*\*\*\*, datë 26.12.2015. Ndërkohë, sipas kontratës së dhurimit nr. \*\*\*, datë 4.7.2016<sup>24</sup>, znj. B. P. i ka dhuruar automjetin vajzës R. P. Automjeti është çregjistruar në mënyrë të përhershme në datën 28.9.2016.

**40.** Në lidhje me burimin e krijimit, të ardhurat e siguruara nga motra R. P. nga punësimi në Gjermani, u konstatua se:

- Me deklaratën e datës 7.11.2016 (përkthyer dhe noterizuar)<sup>25</sup>, kjo shtetase deklaroi se në vitin 2014 i ka dhënë nga kursimet e saj shumën prej 6.000 euro babait S. P., i cili ka vdekur në vitin 2015, për të blerë automjetin tip “Golf 5” dhe se këtë automjet e ka përdorur edhe vetë.

- Sa i takon të ardhurave të ligjshme të motrës R. P., subjekti ka paraqitur disa dokumente shkresore<sup>26</sup>, në formën e kërkuar nga ligji, të cilat informojnë për të ardhurat *neto* të saj për vitet 2009 – 2016<sup>27</sup>. Sipas këtyre dokumenteve, rezulton se kjo shtetase, për periudhën 2012 – 16.7.2014, kur është blerë automjeti, ka pasur të ardhura personale në shumën 37.741 euro dhe shpenzime jetese për një person në vlerën 29.919 euro<sup>28</sup>. Kështu, motra e subjektit R.P./D.<sup>29</sup> ka pasur mundësi për kursime në vlerën 7.822 euro dhe, për rrjedhojë, ka pasur mundësi për t’i dhënë babait të saj shumën 6.000 euro për blerjen e automjetit në korrik të vitit 2014.

Në përfundim të hetimit administrativ nuk rezultuan problematika dhe dyshime në lidhje me këtë pasuri dhe deklaratimet e subjektit përputhen me dokumentet e administruara.

**41. Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar:** “*Automjet tip ‘Mercedes-Benz’, prodhim i vitit 2001, me targa \*\*\*. Burimi i krijimit: trashëguar nga babai i cili e ka blerë këtë automjet sipas kontratës nr. \*\*\*, me të ardhurat e siguruara nga e bija, R. P. (L.) dhe bashkëshorti H. L., sipas deklaratës noteriale nr. \*\*\*, të cilët deklarojnë se në vitin 2008 i kanë dhënë të ndjerit, S.P., shumën 4.000 euro të siguruara nga llogaria e bashkëshortit H. L. pranë \*\*\* nr. \*\*\*.*”

<sup>22</sup>Shihni shkresën kthim përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 14.1.2020, nga DPSHTRR-ja në dosjen e Komisionit.

<sup>23</sup>Shihni dokumentet bashkëngjitur përgjigjeve të pyetësorit nr. 2.

<sup>24</sup>Shihni kontratën bashkëngjitur shkresës kthim përgjigje nga notere Sh. Gj.në dosjen e Komisionit.

<sup>25</sup>Shihni dokumentin në aneksin \*\*\* në dosjen e ILDKPKI-së.

<sup>26</sup>Shihni DIVA-t për vitet 2009 deri në vitin 2015 dhe vitin 2016, të paraqitura në pyetësorin nr. 2 për shtetasen R. D. dhe dokumentet e paraqitura nga subjekti, protokolluar nga Komisioni me nr. \*\*\* prot., datë 15.6.2021, në dosjen e Komisionit.

<sup>27</sup>Dokumentet e protokolluara nr. \*\*\*, datë 21.7.2021, të përkthyer, noterizuara dhe me vulë apostile, të ndodhura në dosjen e Komisionit.

<sup>28</sup>[https://appsso.eurostat.ec.europa.eu/nui/shoë.do?dataset=ilc\\_li01&lang=en](https://appsso.eurostat.ec.europa.eu/nui/shoë.do?dataset=ilc_li01&lang=en)

<sup>29</sup>Nisur nga data dhe vendi i lindjes, të cilat janë të njëjtat si në ID shqiptare ashtu edhe në dokumentit gjermane, R. P. dhe D. është i njëjti person.

Vlera: 500.000 lekë. Pjesa takuese: 25%”. ILDKPKI-ja nuk ka konstatuar problematika në lidhje me këtë pasuri.

**42.** Gjatë hetimit administrativ, nga aktet e administruara<sup>30</sup>, rezultoi se në rend kronologjik janë kryer veprimet si vijojnë:

- Me kontratë shitblerjeje nr. \*\*\*, datë 27.6.2008, z. S. R. P. ka blerë nga z. L. D. automjetin tip “Daimler Chrysler \*\*\*”, me nr. shasie \*\*\*, me targa \*\*\*, në shumën 500.000 lekë.

- Me dëshminë e trashëgimisë nr. \*\*\*, datë 26.12.2015, janë përcaktuar trashëgimtarët ligjorë të radhës së parë të shtetasit S. P., të cilët janë B. P., R. P. (L.), Drini Pali, R. P., që trashëgojnë ¼ pjesë të pasurisë trashëgimore.

- Në DPV-në e vitit 2015, subjekti ka deklaruar automjet tip “Mercedes-Benz”, prodhim i vitit 2001, me targa \*\*\*, trashëguar nga babai me pjesë takuese 20%.

- Sipas kontratës për shitblerje automjeti nr. \*\*\*, datë 22.8.2018, automjeti me targa \*\*\* është shitur nga trashëgimtarët ligjorë të z. S. P., palës blerëse D. B., në shumën 3.000 euro, i cili ia ka shitur sipas kontratës nr. \*\*\*, datë 3.12.2019, shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k.

**43.** Në lidhje me burimin e krijimit të të ardhurave të znj. R. P. (L.) dhe bashkëshortit H. L., u konstatua se:

- Me deklaratën e datës 27.11.2016 (përkthyer dhe noterizuar), shtetasja R. P. deklaroi se në vitin 2008 i ka dhënë babait të saj të ndjerë, z. S. P., shumën prej 4.000 euro për të blerë një automjet dhe se paratë i ka tërhequr pjesë-pjesë nga llogaria e bashkëshortit pranë C\*\*\* D\*\*\*.

- Në përgjigje të pyetësorit nr. 1, subjekti ka paraqitur një statement të llogarisë bankare dyemërore me bashkëmbajtës H. dhe R. L., nga 4.11.2019-29.11.2019.

- Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka paraqitur<sup>31</sup> dokumente të përkthyer, noterizuara dhe me vulë apostile, lidhur me të ardhura të motrës R. P. dhe, konkretisht:

i) deklaratë noteriale e datës 2.5.2021 e z. H. L. dhe znj. R. L., në të cilën deklarohet se: “ ... që nga viti 2003 në 2008 kemi mbështetur prindërit e R. L. – S. P. dhe B. P. – me rreth 2.400 euro/vit. Paratë vijnë nga shitja (31.12.1999) e aksioneve të kompanisë sime”;

ii) kontratë shitjeje e datës 30.12.1999, ku si palë shitëse paraqiten z. F. L. dhe z. H. L., secili me ½ pjesë të aksioneve dhe si palë blerëse shoqëria “\*\*\*\*”. Vlera e kësaj kontrate është 4.533.000 marka gjermane ose 2.266.500 euro<sup>32</sup>, nga ku pjesa takuese e z. H. L. është 1.158.843 euro;

iii) dokumente që vërtetojnë të ardhura të shtetasit H. L.: tatim mbi të ardhurat për vitet 2003, 2004 dhe 2006–2008, si dhe lëvizjet e llogarive bankare të tij në C\*\*\* për vitet 2004-2007, të gjitha të përkthyer, noterizuara dhe me vulë apostile.

Në analizë të dokumenteve të paraqitura, duke përllogaritur shpenzime jetese për dy persona në shumën 83.158 euro<sup>33</sup>, nga viti 2000 – 2007 (kur është dhënë shuma 4.000 euro) dhe shumën 12.000 euro dërguar prindërve S. dhe B. P. (2.400 euro/vit nga viti 2003 – 2007), rezultoi se motra e subjektit R. L. (P.) ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për t’i dhuruar babait shumën 4.000 euro në fund të vitit 2007.

Në përfundim të hetimit administrativ, nuk ka pasur problematika dhe dyshime në lidhje me këtë pasuri dhe deklaratimet e subjektit përputhen me dokumentet e administruara.

<sup>30</sup>Shihni aktet në aneksin \*\*\* në dosjen e Komisionit, dokumentit bashkëngjitur përgjigjeve të pyetësorit nr. 2, në dosjen e Komisionit dhe shkresën kthim përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 14.1.2020, nga DPSHTRR-ja në dosjen e Komisionit.

<sup>31</sup>Dokumentet e protokolluara nr. \*\*\*, datë 21.7.2021, të ndodhura në dosjen e Komisionit.

<sup>32</sup>1 euro = 1.95583 DEM sipas <https://www.ecb.europa.eu/euro/intro/html/index.en.html>

<sup>33</sup>[https://appsso.eurostat.ec.europa.eu/nui/show.do?dataset=ilc\\_li01&lang=en](https://appsso.eurostat.ec.europa.eu/nui/show.do?dataset=ilc_li01&lang=en)

**44. Në deklaratën Vetting, subjekti ka deklaruar:** “Në datën 8.10.2013, dhënë hua pa interes shuma 1.000.000 lekë djalit të hallës, shtetasit A. M. nga llogaria nr. \*\*\*, në ‘Raiffeisen Bank’, në llogarinë e BKT-së, me nr. \*\*\*, konfirmuar nga deklarata noteriale nr. \*\*\*, e vitit 2017. Burimi i krijimit: të ardhura nga vendimi gjyqësor nr. \*\*\*, datë 22.9.2011, i Gjykatës së Apelit Tiranë. Vlera: 1.000.000 lekë. Pjesa takuese: 100%”. ILDKPKI-ja nuk ka konstatuar problematika në lidhje me këtë hua.

**45. Në analizë të akteve shkresore të administruara në dosjen e ILDKPKI-së<sup>34</sup>, rezultoi se:**

- Sipas deklaratës noteriale për njohje huaje nr. \*\*\*, datë 26.1.2017, z. A. M. deklaroi se i ka marrë djalit të dajës Drini Pali, një hua në shumën 1.000.000 lekë për nevojat e tij personale, fakt që e vërteton me mandatin bankar të lëshuar nga “Raiffeisen Bank”, datë 8.10.2013, që i bashkëngjitet kësaj deklarate, shumë të cilën do ta likuidojë deri në datën 26.1.2018.

- Në DPV-në e vitit 2013 nga subjekti është deklaruar: “Dhënë hua pa interes shtetasit A. M., nëpërmjet transferimit të fondeve nga depozita në ‘Raiffeisen Bank’, në BKT, datë 8.10.2013, shuma 1.000.000 lekë”.

- Në lidhje me burimin e krijimit të shumës 1.000.000 lekë të dhënë hua shtetasit A. M., subjekti ka deklaruar të ardhura nga vendimi gjyqësor nr. \*\*\*, datë 22.9.2011, të Gjykatës së Apelit Tiranë lënë në fuqi nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë. Në DPV-një e vitit 2013, subjekti ka deklaruar të ardhura në shumën 2.170.344 lekë të përfituara me vendim gjykatë.

- Nga verifikimi i lëvizjeve të llogarisë në “Raiffeisen Bank” rezultoi se në datën 27.9.2013 është transferuar në llogarinë e pagës së subjektit shuma 2.170.344,2 lekë me përshkrimin “derdhur nga Prok. e Përgjith. Ekz., vendimi nr. \*\*\*, datë 22.9.2011”. Shuma 1.000.000 është transferuar në datën 8.10.2013 në llogarinë e shtetasit A. M. me përshkrimin “transferim fondesh”.

- Gjatë hetimit administrativ u kryen verifikime në drejtim të konfliktit të interesit apo përfshirje të shtetasit A. M. në veprimtari të krimit të organizuar, nga ku nuk rezultuan çështje të shqyrtuara<sup>35</sup> nga subjekti, apo që ky shtetas të këtë pasur procedime penale<sup>36</sup> të regjistruara në emër të tij.

Në përfundim të hetimit administrativ u vërtetua se subjekti ka kryer deklarime të sakta në lidhje me këtë hua dhe se ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për dhënien e saj.

**46. Në deklaratën Vetting, subjekti ka deklaruar:** “Depozitë bankare në Bankën Kombëtare Tregtare sipas kontratës së depozitës, datë 6.9.2013, në emër të vajzës S. P. me IBAN \*\*\* me gjendjen në shumën 284.466,01 lekë në datën 29.12.2016. Burimi i krijimit: paga e bashkëjetueses G. N. si mësuese në Kolegjin ‘\*\*\*’, Tiranë. Vlera: 284.466 lekë. Pjesa takuese: 100%”.

Nga aktet në dosjen e ILDKPKI-së<sup>37</sup> konstatohet se me kontratën e depozitës të datës 6.9.2013, nga prindi Drini Pali është hapur depozitë në emër të S. P., në BKT, për shumën fillestare 10.000 lekë, me afat deri në datën 17.1.2035, konfirmuar gjatë hetimit administrativ edhe nga BKT-ja<sup>38</sup>. Si burim krijimi për këtë pasuri është deklaruar paga e bashkëjetueses G. N., deklarim që përputhet me aktet e administruara gjatë hetimit administrativ.

<sup>34</sup>Shihni aktet në aneksin \*\*\* në dosjen e ILDKPKI-së.

<sup>35</sup>Shihni shkresën kthim përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 19.4.2021, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës dhe shkresën kthim përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 9.7.2021, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier në dosjen e Komisionit.

<sup>36</sup>Shihni shkresën kthim përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 19.4.2021, nga Prokuroria e Përgjithshme në dosjen e Komisionit.

<sup>37</sup>Shihni aktet në aneksin \*\*\* në dosjen e ILDKPKI-së.

<sup>38</sup>Shihni shkresën kthim përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 15.1.2020, nga BKT-ja në dosjen e Komisionit.

**47. Në deklaratën Vetting, subjekti ka deklaruar:** “Llogari rrjedhëse në ‘Raiffeisen Bank’ me nr. klienti \*\*\* dhe \*\*\*\* me gjendje në datën 19.1.2017, në shumën 84.806 lekë. Pjesa takuese: 100%. Gjatë hetimit administrativ ‘Raiffeisen Bank’ ka konfirmuar këtë pasuri”.

Nga verifikimi i lëvizjeve të llogarisë së pagës së subjektin në këtë bankë, deklarimi i subjektit përputhet me aktet e administruara nga Komisioni gjatë hetimit administrativ.

#### **Deklaratë e pasurisë së personit të lidhur**

**48.** Bashkëjetuesja e subjektit të rivlerësimit, znj. G. N., ka plotësuar autorizimin për kontrollin e deklaratës së interesave, ku ka evidentuar se ka pasuri veçmas të regjistruar në emrin e saj. Në deklaratën Vetting, znj. G. N. midis të tjerash, ka deklaruar dy pasuri të paluajtshme të cilat janë përfituar në të njëjtën mënyrë dhe kanë të njëjtën origjinë në mënyrën e përshkruar më poshtë.

**48.1. Znj. G. N. ka deklaruar në deklaratën Vetting:** “Apartament me sipërfaqe 61.27 m<sup>2</sup>, Y\*\*\*, dhënë nga babai P. N. me certifikatë nr. \*\*\*, nr. pasurie \*\*\*\*, Y\*\*\*. Burimi i krijimit: dhuruar nga prindërit sipas kontratës nr. \*\*\*, datë 28.12.2011, e vërtetuar dhe me vendim gjyqësor nr. \*\*\*, datë 4.3.2016. Toka është blerë nga babai sipas kontratës së shitblerjes nr. \*\*\*, datë 24.3.1999, regjistruar 810 m<sup>2</sup>, në z. k. \*\*\*, nr. pasurie \*\*\*, Y\*\*\*, Tiranë. Kjo sipërfaqe toke është dhënë për të ndërtuar pallat firmës ndërtuese ‘\*\*\*’ sh.p.k. Sipas kontratës së ndërtimit me firmën ndërtuese, në këmbim të tokës që vihej në dispozicion për ndërtim pallati, babai (pronari i tokës) kur të përfundonte pallati do të fitonte apartamentin e mësipërm (bashkëlidhur kontrata e shkëmbimit me nr. \*\*\*, datë 26.5.2010, është fituar apartamenti. Nuk është pasqyruar vlerë pasurie. Pjesa takuese: 100%”.

**48.2.** Në lidhje me këtë pasuri, ILDKPKI-ja ka konstatuar:

- Mungesë dokumentacioni justifikues ligjor, lidhur me apartamentin me sip. 61.27 m<sup>2</sup>, Y\*\*\*, nga babai në favor të znj. G. N. Referuar dokumentacionit të paraqitur, apartamenti është fituar dhe regjistruar në pronësi të znj. G. N. nëpërmjet kontratës së shitblerjes nr. \*\*\*, datë 28.12.2011, ku palët deklarojnë likuidimin mes tyre të vlerës 3.565.914 lekë.

- Mosdeklarim i apartamentit me sip. 61.27 m<sup>2</sup>, Y\*\*\*, në deklaratat e interesave private në ILDKPKI.

**48.3. Znj. G. N. ka deklaruar në deklaratën Vetting:** “Apartament me sipërfaqe 52.92 m<sup>2</sup>, në Y\*\*\*, certifikatë nr. \*\*\*. Burimi i krijimit: dhuruar nga prindërit sipas kontratës nr. \*\*\*, datë 28.12.2011, e vërtetuar dhe me vendim gjyqësor nr. \*\*\*, datë 4.3.2016. Toka është blerë nga babai sipas kontratës së shitblerjes nr. \*\*\*, datë 24.3.1999, regjistruar 810 m<sup>2</sup>, në z. k. \*\*\*, nr. pasurie \*\*\*, Y\*\*\*, Tiranë. Kjo sipërfaqe toke është dhënë për të ndërtuar pallat firmës ndërtuese ‘\*\*\*’ sh.p.k. Sipas kontratës së shkëmbimit me firmën ndërtuese, në këmbim të tokës që vihej në dispozicion për ndërtim pallati, babai (pronari i tokës) kur të përfundonte pallati do të fitonte apartamentin e mësipërm bashkëlidhur kontrata e shkëmbimi me nr. \*\*\*, datë 26.5.2010, është fituar apartamenti. Nuk është pasqyruar vlere pasurie. Pjesa takuese: 100%”.

**48.4. Në lidhje me këtë pasuri, ILDKPKI-ja ka konstatuar:**

- Pasaktësi në deklarimin e referencave të kontratës për përfitimin e apartamentit me sip. 52.92 m<sup>2</sup>, në Y\*\*\*, në emër të shtetasve G. N. nga P. N., pasi është deklaruar kontrata nr. \*\*\*, datë 28.12.2011, në fakt referuar ZVRPP-së Tiranë dhe DPPPP-së, por edhe vendimit nr. \*\*\*, datë 4.3.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është kontrata nr. \*\*\*, datë 28.12.2011.

- Subjekti nuk ka paraqitur kontratën e shitblerjes së apartamentit nr. \*\*\*, datë 28.12.2011.

- Mungesë dokumentacioni justifikues ligjor, lidhur me dhurimin e apartamentit me sip. 52.92 m<sup>2</sup>, në Y\*\*\*, nga babai në favor të znj. G. N. Referuar dokumentacionit të paraqitur,

apartamenti është fituar dhe regjistruar në pronësi të znj. G. N. nëpërmjet kontratës së shitblerjes nr. \*\*\*, datë 28.12.2011, ku palët deklarojnë likuidimin mes tyre të vlerës 3.079.994 lekë. Në vendimin e gjykatës së paraqitur nga subjekti, përveç objektit të padisë, theksohet se pavarësisht kontratave të shitblerjes, dy apartamentet janë përfituar nga znj. G. N., nëpërmjet dhurimit, pa paguar vlera monetare. Gjithsesi, padia është rrëzuar nga gjykata.

- Mosdeklarim i apartamentit me sip. 52.92 m<sup>2</sup>, në Y\*\*\*, në deklaratat e interesave private në ILDKPKI.

### **Në lidhje me origjinën dhe mënyrën e fitimit të pronësisë të të dyja pasurive**

**49.** Nga aktet në dosje<sup>39</sup>, në rend kronologjik rezultoi se janë kryer veprimet si vijojnë:

- Me kontratën e shitblerjes nr. \*\*\*, datë 24.3.1999, z. P. N. babai i bashkëjetueses së subjektit, ka blerë nga shitësit A. Gj., etj., tokën me sip. 810 m<sup>2</sup>, në shumën prej 500.000 lekësh të rinj, pasuri e regjistruar në emër të tij, sipas certifikatës për vërtetim pronësie lëshuar në datën 8.4.1999, nga ZVRPP-ja Tiranë.

- Me kontratë shkëmbimi nr. \*\*\*, datë 26.5.2010, z. P. N., në cilësinë e pronarit të truallit, në këmbim të këtij trualli të vënë në dispozicion të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., përfitoi 10 apartamente, 2 njësi dhe garazh, midis të cilëve edhe dy apartamentet e banimit objekt shqyrtimi, përkatësisht apartament me sip. 61.27 m<sup>2</sup> me nr. pasurie \*\*\* dhe apartament me sip. 52.92 m<sup>2</sup>, me nr. \*\*\*. Me kërkesë të Komisionit, në parashtrimet e tij, subjekti deklaroi dhe vërtetoi se nuk ka shqyrtuar çështje ku palë pjesëmarrëse në procese me çfarëdolloj statusi të këtë qenë shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k. ose përfaqësues të saj<sup>40</sup>.

- Me kontratë shitje pasurie të paluajtshme nr. \*\*\*, datë 28.12.2011, pala shitëse P. N. (dhënëse pëlqimi bashkëshortja B. N.), i ka shitur znj. G. N. apartament me sip. 61.27 m<sup>2</sup>, i ndodhur në Y\*\*\*, Tiranë, me nr. pasurie \*\*\*, me çmim 3.565.914 lekë, likuiduar totalisht jashtë zyrës noteriale (çmimi është përlllogaritur ekzaktësisht duke shumëzuar sipërfaqen me çmimin<sup>41</sup> 58.200 lekë/m<sup>2</sup>). Sipas certifikatës për vërtetim pronësie, datë 13.1.2012, pasuria u regjistrua në emër të znj. G. N.

- ASHK-ja Tirana Rurale<sup>42</sup> konfirmon të regjistruar në pronësi të shtetases G. N. pasurinë nr. \*\*\*. OSHEE-ja<sup>43</sup> ka konfirmuar kontratë në emër të shtetases G. N. UKT-ja<sup>44</sup> nuk ka konfirmuar kontrata të furnizimit me ujë, por subjekti ka informuar se këtij apartamenti i përket kontrata e furnizimit me ujë nr. \*\*\*, në emër të shtetases G. N.

- Pasuria me nr. \*\*\* nuk është deklaruar nga subjekti në DPV-në e vitit 2012 dhe në vijim, sipas ligjit nr. 85/2012, i cili parashikonte deklarimin e interesave privatë të subjektit, që burojnë nga marrëdhëniet familjare apo të bashkëjetesës. Gjithashtu, bashkëjetuesja e subjektit nuk e ka deklaruar këtë pasuri në DPV-në për vitin 2014, kur i lindi detyrimi, por e ka deklaruar për herë të parë në deklaratën *Vetting* si pasuri të përfituar me dhurim.

- Me kontratë shitjeje pasurie të paluajtshme nr. \*\*\*, datë 28.12.2011, z. P. N. (dhënëse pëlqimi bashkëshortja B. N.), i ka shitur znj. G. N., apartament me sip. 52.92 m<sup>2</sup>, i ndodhur në Y\*\*\*, Tiranë, me nr. pasurie \*\*\*, me çmim 3.079.994 lekë, likuiduar totalisht jashtë zyrës noteriale (çmimi është përlllogaritur ekzaktësisht duke shumëzuar sipërfaqen me çmimin 58.200

<sup>39</sup>Shihni aktet në aneksin \*\*\* dhe \*\*\* në dosjen e ILDKPKI-së.

<sup>40</sup>Shihni shkresën e datës 29.12.2021, lëshuar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës dhe shkresën nr. \*\*\* prot., datë 7.1.2022, lëshuar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

<sup>41</sup>Sipas udhëzimit nr. 4, datë 23.11.2011, “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, për vitin 2011”, rezulton se çmimi referencë për metër katror për zonën Y\*\*\*, ku ndodhet pasuria (zona \*\*\*), është 60.000 lekë/m<sup>2</sup>.

<sup>42</sup>Shihni shkresën kthim përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 28.1.2020, nga ASHK-ja Tirana Rurale 2, në dosjen e Komisionit.

<sup>43</sup>Shihni shkresën kthim përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 31.12.2019, nga OSHEE-ja në dosjen e Komisionit.

<sup>44</sup>Shihni shkresën kthim përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 23.1.2020, nga UKT-ja në dosjen e Komisionit.

lekë/m<sup>2</sup>). Sipas kartelës së pasurisë në datën 20.1.2012 kjo pasuri është regjistruar në emër të znj. G. N.

- ASHK-ja Tirana Rurale<sup>45</sup>, konfirmon të regjistruar në pronësi të shtetases G. N. pasurinë nr.\*\*\*. OSHEE-ja<sup>46</sup> ka konfirmuar në emër të shtetases G. N. kontratën e furnizimit me energji elektrike. UKT-ja<sup>47</sup> nuk ka konfirmuar kontrata të furnizimit me ujë, ndërkohë që subjekti ka informuar se këtij apartamenti i përket kontrata e furnizimit me ujë me nr. \*\*\*, në emër të shtetases G. N.

- Pasuria nr. \*\*\* nuk është deklaruar nga subjekti në DPV-në e vitit 2012 dhe në vijim, sipas ligjit nr. 85/2012, i cili parashikonte deklarimin e interesave privatë të subjektit, që burojnë nga marrëdhëniet familjare apo të bashkëjetesës. Bashkëjetuesja e subjektit nuk e ka deklaruar këtë pasuri në DPV-në për vitin 2014, kur u bë subjekt deklarues, por e ka deklaruar për herë të parë në deklaratën *Vetting* si pasuri të përfituar me dhurim.

**50.** Me vendimin nr. \*\*\*, datë 14.3.2016, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila ka shqyrtuar çështjen civile me palë paditëse P. N. dhe palë e paditur G. N., me objekt: (1) shpalljen të pavlefshëm të veprimit juridik, kontratë e shitblerjes nr. \*\*\*, datë 28.12.2011 dhe kthimin e palëve në gjendjen e mëparshme duke u çregjistruar pasuria me nr. \*\*\*, apartament me sip. 61.27 m<sup>2</sup>, i ndodhur në Y\*\*\*; (2) shpalljen të pavlefshëm të veprimit juridik, kontratë e shitblerjes nr. \*\*\*, datë 28.12.2011 dhe kthimin e palëve në gjendjen e mëparshme duke u çregjistruar pasuria me nr. \*\*\*, apartament me sip. 52.92 m<sup>2</sup>, i ndodhur në Y\*\*\*, ka vendosur rrezimin e kërkesëpadisë.

**51.** Në këtë vendim, i cili ka marrë formë të prerë pa u ankimuar nga palët, gjykata, ndër të tjera, ka arsyetuar se: “... konstaton se kontratat e shitjes objekt gjykimi të lidhura midis palëve ndërgjyqëse, janë kontrata të simuluar, pasi palët në të vërtetë kanë dashur që të lidhin një kontratë dhurimi dhe në dukje kanë lidhur një kontratë shitje bazuar në provat: (i) pohimi gjyqësor i paditësit, i cili ka pohuar se ia ka dhënë të gjithë pasurinë objekt gjykimi me qëllim që e paditura G. N. ta mbante në pleqëri; (ii) në gjykim paditësi P. N., ka pranuar dhe pohuar se çmimi i kontratave të shitjes është fiktiv dhe se e paditura G. N., nuk i ka dhënë asnjë lekë për këtë kontratë; (iii) gjykata arrin në konkluzionin se kontratat e shitjes lidhur midis palëve janë të simuluar, pasi në të vërtetë palët kanë dëshiruar që të lidhin një kontratë dhurimi. Gjykata konstaton se ky çmim është vënë për të shmangur taksën për kalimin e pronësisë ...”.

**52.** I pyetur gjatë procesit të rivlerësimit, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka deklaruar se *de facto* veprimet e kalimit të pronësisë së pasurive përkatësisht nr. \*\*\* dhe nr. \*\*\*, kanë qenë dhurime nga babai te e bija dhe jo shitje. Per të vërtetuar këte deklaram subjekti ka paraqitur dy akte noteriale të redaktuara në datën 20.4.2021<sup>48</sup>, sipas të cilave palët P. N., B. N. dhe G. N. bien dakord që të revokojnë kontratën me nr. \*\*\*, datë 28.12.2011 dhe kontratën me nr. \*\*\*, datë 28.12.2011, pasi shumat e përcaktuara në këto akte si çmime të shitjeve, nuk janë paguar nga ana e palës blerëse dhe se palët nuk kanë asnjë pretendim apo detyrim ndaj njëritjetrit. Gjithashtu, subjekti ka deklaruar se bashkëjetuesja dhe babai i saj janë duke kryer procedura të dhurimit të pasurive.

Me kërkesë të Komisionit për të vërtetuar dhe paraqitur dokumente në lidhje me vijimësinë e procedurave të dhurimit, në parashtrimet e tij, subjekti paraqiti: (i) kontratë dhurimi nr. \*\*\*, datë 6.5.2021, e cila vërteton dhurimin e pasurisë \*\*\* nga z. P. N. te znj. G. N., si dhe kartelë pasurie në emër të znj. G. N., sipas të cilës pasuria është regjistruar në hipoteke e fituar me dhurim; (ii) kontratë dhurimi nr. \*\*\*, datë 6.5.2021, për dhurimin e pasurisë nr. \*\*\*, nga z. P.

<sup>45</sup>Shihni shkresën kthim përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 28.1.2020, nga ASHK-ja Tirana Rurale 2, në dosjen e Komisionit.

<sup>46</sup>Shihni shkresën kthim përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 31.12.2019, nga OSHEE-ja në dosjen e Komisionit.

<sup>47</sup>Shihni shkresën kthim përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 23.1.2020, nga UKT-ja në dosjen e Komisionit.

<sup>48</sup>Shihni revokim aktesh të tjera (zgjidhje kontrate) nr. \*\*\*, datë 20.4.2021 dhe nr. \*\*\*, datë 20.4.2021.



N. te znj. G. N., si dhe kartelë pasurie në emër të znj. G. N., sipas së cilës pasuria është regjistruar në hipotekë e fituar me dhurim.

**53.** Sa i takon përdorimit të këtyre pasurive, po në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti deklaroi se së bashku me bashkëjetuesen nuk kanë banuar asnjëherë në këto apartamente, fakt i vërtetuar edhe gjatë hetimit administrativ, nga ku ka rezultuar se ata kanë banuar në banesën e prindërve të tij, (deklaruar si në paragrafin 35 të këtij vendimi), deri në vitin 2018 kur kanë filluar të banojnë në apartamentin e banimit të porositur në vitin 2015 (deklaruar si në paragrafin nr. \*\*\*).

Ndërkohë, subjekti ka kryer deklarime e ka paraqitur dokumenta shkresore sipas të cilave: (i) Në apartamentin me sip. 61.27 m<sup>2</sup>, me nr. pasurie \*\*\*, në periudhën 2012 – 2020 ka jetuar vëllai i bashkëjetueses E. N., ndërsa që prej datës 1.5.2020, sipas kontratës së qirasë me nr. \*\*\*, datë 1.5.2020, jeton shtetasja M. B. dhe për të ardhurat nga qiraja janë paguar detyrimet tatimore. Mobilimi i është kryer me mobilje dhe pajisjet ekzistuese të shtëpisë së vjetër të prindërve të bashkëjetueses në lagjen nr. \*\*\*; (ii) Në apartamentin me sip. 52.92 m<sup>2</sup>, me nr. pasurie \*\*\*, në periudhën 2012 – 2020 ka jetuar shtetasja M. M., vajza e hallës së bashkëjetueses, e cila ka sjellë dhe mobilje e pajisje të vetat. Ndërsa prej datës 1.5.2020, jeton me qira shtetasja J. R. (J.), sipas kontratës së qirasë nr. \*\*\* dhe për të ardhurat nga qiraja janë paguar detyrimet tatimore.

**54.** Sa i takon burimit të krijimit të të ardhurave për përfitimin e këtyre pasurive, gjatë hetimit administrativ, subjekti nuk ka dhënë sqarime dhe dokumente, për shkak të qëndrimit të mbajtur gjatë gjithë procesit se formalisht kalimi i pronësisë është bërë fillimisht me shitje, por në fakt, kjo marrëdhënie midis palëve ka qenë një marrëdhënie dhurimi, prind-fëmijë. Por, duke qenë se të dyja pasuritë objekt shqyrtimi, në momentin e plotësimit të deklaratës *Vetting* kanë qenë të regjistruara në hipotekë me dy kontrata shitjeje, të cilat nuk ishin deklaruar të pavlefshme nga gjykata, pavarësisht arsytimit të vendimit të gjykatës, në përfundim të hetimit administrativ, Komisioni verifikoi mundësinë e subjektit dhe bashkëjetueses për të kryer me të ardhura të ligjshme pagesat e vlerave të përcaktuara si çmime shitjeje, në total prej 6.645.908 lekësh<sup>49</sup>, në vitin 2011 (vit në të cilin subjekti nuk ka qenë në detyrë). Duke e konsideruar këtë shumë si shpenzim të tyre, analiza financiare e këtij viti ka rezultuar me një balancë negative në shumën 7.329.737 lekë.

**55.** Në përfundim të hetimit administrativ, në lidhje me pasuritë nr. \*\*\* dhe nr. \*\*\*, subjektit i kaloi barra e provës, sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, duket se:

i) Ka mospërputhje midis deklarimeve të bashkëjetueses së subjektit në deklaratën *Vetting*, ku është deklaruar se pasuritë janë përfituar me dhurim me kontratat e përfitimit të pasurive, sipas të cilave pasuritë janë përfituar me shitje.

ii) Subjekti nuk i ka deklaruar këto pasuri në pronësi të bashkëjetueses në DPFDF-në për vitin 2012 dhe në vijim deri DPV-në për vitin 2016, si dhe nuk janë deklaruar nga bashkëshortja e tij në DPV-në e vitit 2014 dhe në vijim deri në deklaratën *Vetting*, në të cilën i ka deklaruar pasuritë.

iii) Nisur nga fakti që pasuritë janë përfituar me kontrata shitjeje, të cilat në momentin e plotësimit të deklaratës *Vetting* nuk ishin deklaruar të pavlefshme me vendim gjykate, subjekti dhe bashkëjetuesja duket se nuk kanë pasur të ardhura të ligjshme për blerjen e të dyja pasurive në vlerën 6.645.908 lekë, për shkak të një balance negative në shumën 7.329.737 lekë, për vitin 2011.

---

<sup>49</sup>Kjo shumë përbëhet nga vlera 3.565.914 për blerjen e apartamentit me sip. 61.27 m<sup>2</sup>, në Y\*\*\* dhe vlera 3.079.994 lekë për blerjen e apartamentit me sip. 52.92 m<sup>2</sup>, në Y\*\*\*.

## **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit dhe vlerësimi i Komisionit bazuar në provat e administruara dhe në ligjin e zbatueshëm**

**56.** Në lidhje me mospërputhjet në deklarime, subjekti ka parashtruar se bashkëjetuesja ka deklaruar me vërtetësi për mënyrën e përfitimit të pasurive në deklaratën *Vetting*, pasi pasuritë janë të dhuruara *de facto* në vitin 2011, ndërsa aktualisht edhe *de jure* nga babai dhe se ajo nuk ka paguar ndonjë vlerë të hollash për përfitimin e këtyre pasurive. Gjithashtu, subjekti deklaroi se kur ka ardhur në dijeni të faktit se kontratat te noteri ishin përpiluar si kontrata shitje, i ka kërkuar bashkëjetueses të revokojë këto kontrata dhe të lidhë kontrata të rregullta dhurimi. Për këtë arsye, palët fillimisht i janë drejtuar gjykatës, e cila pavarësisht se gjatë gjykimit vërtetoi dhe arriti në përfundimin se kontratat e shitjes janë të simuluar, pasi palët në të vërtetë kanë dashur që të lidhin një kontratë dhurimi, nuk vendosi pavlefshmërinë e tyre, por e rrëzoi padinë. Më tej, subjekti ka sjellë në vëmendje të Komisionit edhe faktin se babai i bashkëjetueses iu ka shitur më pare edhe dy vajzave të tjera (motrave të bashkëjetueses) nga dy apartamente secilës edhe pse janë me banim jashtë vendit. Ndërsa për njëjërën prej tyre, znj. A. I. (N.) ka vërtetuar se pasi janë revokuar dy kontratat e shitjeve, pasuritë janë regjistruar në pronësi të saj me kontrata dhurimi, siç ka ndodhur edhe me bashkëjetuesen e subjektit. Për të vërtetuar këto deklarime, subjekti i është referuar dokumenteve të administruara gjatë hetimit administrativ, si dhe ka paraqitur disa dokumente të tjera shkresore<sup>50</sup>. Po kështu, në seancën dëgjimore, subjekti theksoi dhe kërkoi që Komisioni të mbajë në konsideratë faktin që kërkesa për pavlefshmërinë e akteve noteriale ishte bërë përpara hyrjes të procesit *Vetting*, fakt i cili rezultoi të jetë i vërtetë nisur nga data e vendimit të gjykatës, më 14.3.2016.

**56.1.** Pavarësisht parashtrimeve të subjektit, deklarimi i bashkëjetueses në deklaratën *Vetting* se pasuritë janë fituar me dhurim nga prindërit është i pasaktë, për shkak në momentin e deklarimit pasuritë ishin të fituara *de juro* me kontrata shitjeje të cilat edhe pse ishin goditur ligjërisht me parë, nuk ishin deklaruar të pavlefshme me vendim gjykate. Por, në vlerësimin përfundimtar të çështjes, pasi Komisioni krijoi bindjen se *de facto* pasuritë objekt verifikimi janë fituar me dhurim nga ana e bashkëjetueses së subjektit dhe çmoi se kjo pasaktësi është formale dhe pa pasoja, referuar fakteve dhe rrethanave si vijojnë:

- i) Është vërtetuar origjina dhe mënyra e ligjshme e përfitimit me këmbim të dy pasurive objekt verifikimi nga babai i bashkëjetueses së subjektit.
- ii) Është vërtetuar mungesa e përfshirjes dhe çdo lloj lidhjeje e përgjegjësie të subjektit me procedurat e kalimit të pronësisë mbi këto pasuri, si dhe nuk është vërtetuar ndonjë konflikt i mundshëm interesi gjatë ushtrimit të detyrës prej tij me shoqërinë e ndërtimit të godinës, ku ndodhen pasuritë, shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k.
- iii) Edhe pse në deklaratën *Vetting*, znj. G. N. i ka deklaruar pasuritë si të fituara me dhurim, në zbatim të ligjit nr. 84/2016, sipas të cilit subjektet kishin mundësinë dhe detyrimin të plotësonin një deklaratë të re të pasurisë, ku të jepnin sqarime dhe dokumente, në këtë deklaratë ka përmendur vendimin e gjykatës, si dhe ka dhënë shpjegime dhe dokumente shkresore në lidhje me mënyrën e fitimit të pronësisë së babait mbi dy apartamentet objekt verifikimi.
- iv) Në arsyetimin e vendimit të gjykatës përmenden fakte dhe rrethana, të cilat tregojnë se kontratat e shitjeve në thelb kanë qenë kontrata dhurimi.
- v) Vijueshmëria e veprimeve si: revokimi i kontratave të shitjeve, përpilimi i dy kontratave të dhurimit, si dhe reregjistrimi i të dyja pasurive aktualisht në emër të znj. G. N. bazuar në

---

<sup>50</sup>Shihni dokumentet bashkëngjitur parashtrimeve të subjektit dërguar në rrugë elektronike të datës 10.1.2021, në dosjen e Komisionit.

veprimin juridik të dhurimit, dëshmojnë se faktet e përmendura në arsyetimin e vendimit të gjykatës qëndrojnë dhe se pretendimet e subjektit janë të bazuara.

vi) E njëjta situatë faktike dhe juridike është vërtetuar se ka ndodhur edhe me motrat e bashkëjetueses së subjektit për pasuritë që atyre u kanë kaluar në pronësi me kontrata shitjeje, çka tregon se bashkëjetuesja e subjektit nuk është trajtuar në mënyrë të ndryshme nga motrat e saj dhe se përpilimi i kontratave nuk ka ardhur si pasojë e ndonjë ndikimi të subjektit të rivlerësimit për shkak të detyrës ose jo. Për njërën prej motrave të bashkëjetueses, subjekti vërtetoi se janë revokuar kontratat e shitjeve dhe me pas janë lidhur dy kontrata dhurimi, ashtu sikurse dhe me bashkëjetuesen e tij.

vii) Marrëdhëniet e ngushta prind-fëmijë, përjashtojnë dyshimet që prindërit i kanë shitur vajzës pasuritë e përfituara në këmbim të një trualli.

Në këto kushte, pasaktësia në deklarinimin e bashkëjetueses së subjektit, vlerësohet nga Komisioni të jetë formale/pa pasoja dhe jo me qëllim mbulimin e faktit të lidhjes së kontratave të shitjeve, por me qëllim qasjen e saj me situatën faktike, sipas të cilës pasuritë i janë dhuruar nga babai.

**57.** Në lidhje me mosdeklarimin e dy apartamenteve nga subjekti në DPFN-në e vitit 2012 dhe në vijim deri DPV-në për vitin 2016, subjekti ka sqaruar se në kuptim të nenit 3 të ligjit nr. 85/2012, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9049, datë 10.4.2003”, sipas të cilit parashikohet deklarimi i interesave private që përputhen, përmbajnë, bazohen ose burojnë nga marrëdhëniet familjare apo të bashkëjetesës, i ka konsideruar të dyja pasuritë si vetjake të bashkëjetueses të përfituara me dhurim nga babai i saj, mbi të cilat ai nuk ka pasur të drejta pronësie. Për këtë arsye, ka vlerësuar se nuk ka pasur detyrimin për deklarim.

Ndërsa sa i takon mosdeklarimit të pasurive nga ana e bashkëjetueses së subjektit në DPV-në e vitit 2014 dhe në vijim deri në DPV-në për vitin 2016, subjekti ka sqaruar se në vitin 2010 është shkëputur nga detyra. Kur është rikthyer dhe ka plotësuar deklaratën e vitit 2013, siç nënkuptohet nga shpagimet, ai dhe bashkëjetuesja e kanë konsideruar këtë deklarinim si deklaratë periodike vjetore në të cilën deklaroheshin vetëm shtesat dhe ndryshimet e pasurive. Për këtë arsye, pasuritë nuk janë deklaruar edhe në DPV-në 2014 dhe 2015. Më pas, në vitin 2016, sipas subjektit, bashkëjetuesja, pasi ka konstatuar mos deklarimin, ka kryer deklarinimet përkatëse në procesverbalin e datës 10.3.2016, në ILDKPKI, të administruar edhe nga Komisioni, ashtu sikurse i ka deklaruar edhe në deklaratën *Vetting*.

Subjekti sjell në vëmendje të trupit gjykues se pesha e pasaktësive të deklarinimeve periodike në procesin e rivlerësimit të një subjekti është trajtuar në një sërë vendimesh të Kolegjit<sup>51</sup> dhe të Komisionit<sup>52</sup>, nga ku rezulton se ato nuk mund të përbëjnë shkak të veçuar për marrjen e masës disiplinore.

---

<sup>51</sup> - Në vendimin nr. 20, të datës 31.7.2019, të Kolegjit arsyetohet se: “... mosdeklarimi prej subjektit të rivlerësimit i blerjes së automjetit në vitin 2005 është një pasaktësi e bërë në deklarinimin periodik të atij viti, i cili është ndrequr në vitin 2009, me vullnetin dhe iniciativën e vetë subjektit të rivlerësimit. Në këtë kuptim, kjo pasaktësi që i përket vitit 2005, e konsideruar si e tillë, nuk mund të shërbejë si një shkak i vetëm për të analizuar më tej drejt përgjegjësisë së subjektit të rivlerësimit në raport me procesin e rivlerësimit. Kolegji çmoi se kjo rrethanë fakti, e provuar nëpërmjet deklarinimeve si më sipër, duhet t'i nënshtrohet analizës financiare, duke qenë se nga hetimi nuk ka rezultuar asnjë e dhënë tjetër që të mund të vinte në dyshim ekzistencën e saj”.

- Në vendimin nr. 22/2019 të Kolegjit arsyetohet se: “Trupi gjykues, megjithëse e gjen të drejtë konkluzionin e Komisionit se deklarinimet periodike të subjektit kanë pasaktësi, vlerëson se bazuar në jurisprudencën e Kolegjit, pasaktësitë në deklarinimet periodike të pasurisë nuk përbëjnë shkak të veçuar për të ngarkuar subjektin me përgjegjësi disiplinore”.

<sup>52</sup>Në vendimin nr. \*\*\*, datë 15.12.2019, të Komisionit arsyetohet se: “Në pikëpamjen formale, mungesa e deklarinimeve të subjektit në lidhje me pasuri të bashkëjetuesit në deklaratat periodike për vitet 2012 dhe 2013, nuk ka pasur si qëllim fshehjen e ndonjë pasurie apo interesi privat të subjektit të rivlerësimit dhe as të bashkëjetuesit dhe si të tilla nuk janë konsideruar si shkak për penalizim të saj”.

**57.1.** Përkundër sa pretendohet e interpretohet nga subjekti, bazuar në nenin 3 të ligjit nr. 85/2012, i cili ka ndryshuar ligjin 9049/2003, edhe pse të dyja pasuritë ishin të përfituara nga bashkëjetuesja prej babait, subjekti ka pasur detyrimin e deklarimit, pavarësisht përdorimit ose jo të tyre, pasi detyrimi ligjor nuk kushtëzohet vetëm me përdorimin ose përfitimin e ndonjë lloj të ardhure prej tyre. Gjithashtu, pavarësisht argumenteve të subjektit, bashkëjetuesja e subjektit nuk ka përmbushur detyrimin ligjor për deklarimin e pasurive në DPV-në për vitin 2014, kur asaj i ka lindur detyrimi.

Por, në përfundim të procesit, Komisioni çmoi se mosdeklarimi i pasurive nga subjekti dhe bashkëjetuesja, nuk ka pasur si qëllim fshehjen e tyre, referuar fakteve dhe rrethanave si vijojnë:

i) Të dyja pasuritë objekt shqyrtimi kanë qenë të regjistruara në emir të znj. G. N. në regjistrat publikë që në vitin 2011, ndërkohe që për të dyja pasuritë janë lidhur kontratat e furnizimit me energji elektrike dhe ujë në emër të saj. Këto fakte janë tërësisht dhe lehtësisht të verifikueshme dhe, për pasojë, nuk është logjike të supozohet që subjekti dhe bashkëjetuesja kanë dashur t'i fshehin pasuritë objekt verifikimi.

ii) Pasaktësia në deklarimin e viteve të mëparshme është rregulluar në deklarimet e subjektit në ILDKPKI në vitin 2016, si dhe në deklaratën *Vetting*, ku bashkëjetuesja e subjektit ka kryer deklarime dhe ka dhënë sqarime në lidhje me të dyja pasuritë.

Për rrjedhojë, në përfundim të procesit, pasaktësitë në deklaratat periodike vjetore për shkak të mosdeklarimit të këtyre pasurive, në harmoni me të gjitha faktet, provat dhe rrethanat e evidentuara gjatë procesit të rivlerësimit, duke ndjekur edhe standardin e mbajtur nga Kolegji<sup>53</sup>, në raste të ngjashme, u vlerësuan nga Komisioni si pasaktësi pa pasoja dhe, për rrjedhojë, pa peshë specifike në disfavor të subjektit të rivlerësimit.

**58.** Lidhur me konstatimin, për mungesën e të ardhurave të ligjshme për blerjen e të dyja pasurive në vlerën 6.645.908 lekë, në parashtrimet e tij, subjekti ka vijuar të këmbëngulë se pavarësisht se pasuritë, fillimisht, janë përfituar nga bashkëshortja me dy kontrata të lidhura si kontrata shitjeje, sipas tij, vërtetohet te çdo dyshimi se për këto pasuri nuk është paguar ndonjë vlerë monetare. Sipas subjektit, këto pasuri tashmë janë regjistruar në emër të bashkëjetueses përfituar në bazë të kontratave të dhurimit dhe, për këto arsye, konstatimi se ata kanë qenë në pamundësi financiare për blerjen e pasurive, është i pabazuar. Më tej, subjekti ka sqaruar se si subjekt deklarues nuk mund të ketë përgjegjësi ligjore për ndonjë veprim të parregullt të bashkëjetueses apo babait të saj, për pasuritë vetjake të fituara prej saj në mënyrë krejtësisht të pavarur, për shkak të marrëdhënies së posaçme babë dhe bijë dhe sidomos në kushtet kur në kohën e përfitimit të këtyre pasurive (viti 2011) ajo nuk ka pasur as detyrimin për deklarim dhe nuk ka qenë as subjekt i lidhur me subjektin në kuptim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003.

**58.1.** Në analizë të të gjitha rrethanave të rezultuara nga hetimi administrativ, parashtrimeve dhe dokumenteve të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, si dhe në konsideratë të faktit që nuk u vërtetua dhe nuk ka pasur asnjë të dhënë për lidhje a ndërveprime të subjektit në çfarëdolloj veprimi juridik, që ka pasur lidhje me të dyja pasuritë objekt verifikimi, në procesin e vlerësimit përfundimtar të çështjes, arsyetuar hollësisht në këtë vendim, Komisioni vlerësoi

---

- Në vendimin nr. \*\*\*, datë 17.6.2020, të Komisionit arsyetoi se: "97.2 Mbi sa më lart, subjekti i rivlerësimit pretendoi se kjo pasuri, megjithëse është e ligjshme, nuk duhet të përfshihet në kuadër të rivlerësimit të tij. 98. Në përfundim, trupi gjykues vlerëson se shpjegimet e subjektit të rivlerësimit janë bindëse dhe përputhen me faktet e rezultuara gjatë hetimit. Pavarësisht se si bashkëpronare mbi këtë pasuri rezultoi të jetë regjistruar edhe subjekti i rivlerësimit, vetëm për shkak të procedurës së kryer në vitin 2011, për blerjen nga ALUIZNI të truallit në bashkëpronësi mes të gjithë pronarëve të apartamenteve të pallatit, kjo pasuri rezultoi e blerë në vitin 2006 (para martesë) dhe se nuk mund të lidhet me procesin e rivlerësimit të subjektit Edlira Petri. Kjo e drejtë është fituar para martesës dhe konsiderohet si pasuri vetjake në kuptim të Kodit të Familjes".

<sup>53</sup>Shihni vendimet nr. 20/2019 dhe nr. 22/2019 të Kolegjit.

se shpjegimet e subjektit të rivlerësimit janë bindëse dhe se ai dhe bashkëjetuesja nuk kanë paguar asnjë vlerë monetare për apartamentet e banimit objekt verifikimi.

**59. Në deklaratën *Vetting*, bashkëjetuesja e subjektit ka deklaruar:** “*Apartament me sip. 110.45 m<sup>2</sup>, nr. \*\*\*, rruga ‘\*\*\*’, ish-\*\*\*, Tiranë, blerë me kontratën e sipërmarrjes nr. \*\*\*, datë 14.7.2015*”. Trajtuar më sipër si pasuri e deklaruar nga subjekti.

**60. Në deklaratën *Vetting*, bashkëjetuesja e subjektit ka deklaruar:** “*Shuma 1.000.000 lekë gjendje cash. Burimi i krijimit: dhënë nga prindërit me transfertën, datë 25.6.2015, nga llogaria Nr.\*\*\* NBG P. N. në BKT, nr. llogarie \*\*\*, pas shitjes së apartamentit në rrugën ‘\*\*\*’, p. nr.\*\*\*, h. \*\*\*, ap. \*\*\*, Tiranë, fituar me kontratë shitblerje nga N. K. B. Nr. \*\*\*, regjistruar sipas certifikatës së pronësisë nr. \*\*\*, nr. pasurie \*\*\**”.

**61. Në lidhje me këtë likuiditet, gjatë hetimit administrativ, u konstatua se:**

- Pas transfertës së datës 25.6.2015, nga llogaria e z. P. N.te llogaria e znj. G. N. në BKT, të shumës 3.501.500 lekë<sup>54</sup>, datë 8.7.2015, znj. G. N. ka tërhequr *cash* shumën 1.000.000 lekë. Ndërsa, po në datën 8.7.2015, është tërhequr shuma prej 304.677 lekësh, nga llogaria nr. \*\*\*, pranë të njëjtës bankë.

- Në DPV-në e vitit 2015 bashkëjetuesja ka deklaruar *tërheqje nga depozita e BKT mbyllur në datën 8.7.2015, duke e pakësuar në shumën 1.300.000 lekë*, por nuk e ka deklaruar shumën e tërhequr as si gjendje *cash* as si shpenzim të kryer.

- Në DPV-në e vitit 2016 bashkëjetuesja ka deklaruar shumën 1.000.000 lekë si gjendje *cash* me burim “dhënë nga prindërit me transfertën e datës 25.6.2015, pas shitjes së apartamentit në rrugën “\*\*\*”, duke lënë të kuptohet që shuma prej 300.000 lekësh ishte shpenzuar.

- Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar shumën 1.000.000 lekë si gjendje *cash* me burim transfertën nga llogaria e babait të bashkëjetueses.

**62. Meqenëse bashkëjetuesja e subjektit nuk e ka deklaruar shumën e tërhequr prej 1.000.000 lekësh në datë 8.7.2015, si gjendje *cash* në fund të vitit 2015, kjo shumë nuk u konsiderua si burim që ka shërbyer për krijimin e gjendjes *cash* në vitin 2016 dhe, për rrjedhojë, edhe për shumën mbartur *cash* deri në deklaratën *Vetting*. Për këtë arsye, në përfundim të hetimit administrativ, Komisioni ka kryer analizën financiare mbi mundësinë e subjektit dhe bashkëjetueses, për të krijuar gjendjen *cash* gjatë vitit 2016, e cila ka rezultuar me një balancë negative në shumën 302.215 lekë, sikurse treguar në tabelën vijuese.**

Përshkrimi	2016
<b>Pasuri</b>	<b>794 966</b>
Gjendje <i>cash</i> i krijuar gjatë vitit 2016	1 000 000
<i>Shtesa/Pakësime likuiditete</i>	-205 034
Likuiditete gjendje	<b>399 835</b>
<b>Të ardhura dokumentuar</b>	<b>1 709 299</b>
Të ardhura nga paga e subjektit	1 203 241
Të ardhura nga paga e bashkëjetueses	501 840
Interesa nga bankat	4 218
<b>Shpenzime</b>	<b>1 216 547</b>
Shpenzime jetese	940 368
Shpenzime transporti të brendshëm	215 252
Paguar karta e kreditit në BKT	47 400
Dërgesa/dhurata dërguar me Western Union	13 527

<sup>54</sup>Burimi i kësaj shume është trajtuar në paragrafin 32.2 të këtij vendimi.

**63.** Sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit i kaloi barra e provës për të vërtetuar të kundërtën e këtij konstatimi. Në parashtrimet e tij, subjekti sqaroi se shuma 1.000.000 lekë *cash* është pjesë e shumës së tërhequr nga llogaria bankare në datën 8.7.2015 dhe ka qenë gjendje në banesë në fund të vitit 2015. Nga ana tjetër, subjekti ka pranuar pasaktësinë e bashkëjetueses në deklarimin e kryer në vitin 2015, e cila është ndrequr në vitin 2016 duke deklaruar në DPV-në e këtij viti. Më tej, subjekti ka sqaruar se sipas tij, këto para kanë qenë gjendje në llogari bankare dhe janë tërhequr nga bashkëshortja, e cila ka deklaruar pakësimin e kësaj depozite dhe gjatë këtij viti as ajo dhe as subjekti, nuk kanë kryer ndonjë shpenzim kapital apo të ndonjë lloji tjetër të konsiderueshëm që kjo shumë të jetë pakësuar. Sipas analizës financiare të subjektit, ku shuma 1.000.000 lekë është konsideruar si gjendje *cash* e mbartur nga viti 2015, rezultati i vitit 2016 do të ishte me balancë pozitive në shumën 697.785 lekë.

Subjekti sjell në vëmendje se edhe sikur të pranohej kjo balancë negative, bazuar në jurisprudencën e Kolegjit<sup>55</sup> dhe në dritën e parimit të proporcionalitetit, kjo diferencë nuk mund të përbëjë shkak për marrjen e masës disiplinore (aq më tepër që është e bashkëjetueses).

**64.** Në përfundim të procesit, Komisioni çmoi se bashkëjetuesja e subjektit ka pasur detyrimin ta deklarojë shumën 1.000.000 lekë si gjendje *cash* në DPV-në e vitit 2015, që nuk e ka bërë, pavarësisht deklarimit në DPV-në e vitit 2016. Për më tepër, ky qëndrim është mbajtur edhe nga Kolegji në disa situata të ngjashme<sup>56</sup>. Për këto arsye, kursimet e pretenduara *cash* në fund të vitit 2015, nuk janë marrë në konsideratë si të tilla në analizën financiare për vitin 2015, por si të krijuara rishtas gjatë vitit 2016 dhe, për rrjedhojë, analiza financiare për këtë vit nuk ndryshon nga ajo e dërguar me rezultatet e hetimit administrativ.

**65. Në deklaratën Vetting, bashkëjetuesja e subjektit ka deklaruar:** “Llogari rrjedhëse në BKT me Nr. IBAN \*\*\*, gjendje në datën 24.1.2017, në shumën 57.248,37 lekë. Vlera: 57.248,37 lekë. Pjesa takuese: 100%, konfirmuar nga BKT-ja”.

Nga verifikimi i lëvizjeve të llogarisë së bashkëjetueses së subjektit në këtë bankë, rezulton se përputhet deklarimi i saj me aktet e administruara nga Komisioni, gjatë hetimit administrativ.

**66. Në deklaratën Vetting, bashkëjetuesja e subjektit ka deklaruar:** “Detyrim monetar që rrjedh nga kontrata e sipërmarrjes nr. \*\*\*, datë 14.7.2015, për blerjen e apartamentit më sip. 110.45 m<sup>2</sup>, nr. \*\*\*, rr. ‘\*\*\*\*’, K\*\*\*, Tiranë, ndaj shoqërisë ‘\*\*\*\*’ sh.p.k”. Pas verifikimeve, u konstatua se ky detyrim është në shumën 1.000.000 lekë, aq sa është deklaruar edhe në DPV-në për vitin 2016.

## Verifikime të tjera të kryera nga Komisioni në lidhje me kriterin pasuror

<sup>55</sup>Në vendimin 11, datë 31.3.2021, të Kolegjit thekson se: “Pavarësisht se subjekti i rivlerësimit pretendon se vlera e blerjes së automjetit është arkëtuar që në datën 25.1.2012, nga dokumentacioni i administruar gjatë hetimit administrativ rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk kishte mundësi të kryente pagesat në vlerën 6.500 euro për automjetin deri më 17.2.2012, për një vlerë negative prej 695.735,87 lekësh. Kolegji çmoi që kjo mungesë e burimeve të ligjshme që ka shërbyer për blerjen e automjetit të subjektit të rivlerësimit, nuk është e tillë për t’u renditur si pamjaftueshmëri që çon në shkarkimin e subjektit të rivlerësimit sipas pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016”. Në vendimin nr. 31, datë 18.11.2020, të Kolegjit analizon se: “Edhe nga analiza financiare e kryer në Kolegji, për të verifikuar mundësinë e subjektit për të paguar këstin e parë për apartamentin me sip. 76 m<sup>2</sup>, për periudhën 1.1.2009 - 30.4.2009, konfirmohet rezultati i analizës financiare të kryer nga Komisioneri Publik, sipas së cilës rezulton se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij kanë pasur mungesë të të ardhurave të ligjshme për të likuiduar këstin e parë të apartamentit, në vlerën 838.738 lekë, në përputhje me parashikimin e germës ‘b’, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016, por kjo situatë në vlerësimin e trupit gjykues, është e tillë që nuk mund të ngrihet në nivelin e një shkaku shkarkimi në drejtim të vlerësimit të kriterit të pasurisë”.

<sup>56</sup>Shihni vendimet (JR) nr. 11/2019, në pikën 27.12.18 të paragrafit 27; (JR) nr. 19/2019 në paragrafin 84; (JR) nr. 20/2019 në paragrafin 59 dhe (JR) nr. 29/2019 në paragrafin 31.

**67.** Në DPV-në e vitit 2009, bashkëjetuesja e subjektit ka deklaruar: “Kontratë porosie nr. \*\*\*, datë 20.12.2009, me objekt porositjen për ndërtimin e një apartamenti me sip. 108.77 m<sup>2</sup> me investitor B. H.. Paradhënia në shumën 25.000 euro. Shuma 25.000 euro e tërhequr nga BKT, në datën 20.12.2009”. Duke qenë se në deklaratimet e DPV-ve në vijim mungon të jenë kryer deklarime të mëtejshme në lidhje me këtë pasuri, Komisioni kreu verifikimet si vijojnë, me qëllim heqjen e çdo dyshimi që pasuria objekt i kontratës së porosisë mund të jetë një pasuri e fshehur nga subjekti dhe/apo nga bashkëjetuesja.

**68.** Nga verifikimi i akteve në dosjen e ILDKPKI-së<sup>57</sup>, në lidhje me këtë pasuri, konstatohet se:

- Me kontratë porosie nr. \*\*\*, datë 20.11.2009, znj. G. N. ka porositur nga investitorët B. H. dhe A. P. apartamentin me sip. totale 108.77 m<sup>2</sup>, (marrja në dorëzim e të cilit është parashikuar për në fund të vitit 2011), me çmim 100.000 euro.

- Me deklaratën noteriale nr. \*\*\*, datë 21.3.2014, znj. G. N. deklaroi revokimin e kontratës së porosisë me nr. \*\*\*, datë 20.11.2009.

- Pas DPV-së për vitin 2009, nuk rezultoi të jenë kryer deklarime të mëtejshme në lidhje me këtë pasuri.

**69.** Në përfundim të hetimit administrativ, në analizë të deklaratimeve dhe dokumenteve të paraqitura nga subjekti<sup>58</sup> dhe shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., që ka marrë përsipër ndërtimin e apartamentit<sup>59</sup>, rezultoi se për pasurinë objekt verifikimi në rend kronologjik janë kryer veprimet si vijojnë:

**69.1.** Bashkëjetuesja e subjektit G. N., në cilësinë e porositësit, ka lidhur me investitorët B. H. dhe A. P., kontratën e porosisë nr. \*\*\*, datë 20.11.2009, me objekt porositjen e ndërtimit të një apartamenti me sip. totale 108.77 m<sup>2</sup> (marrja në dorëzim e të cilit është parashikuar për në fund të vitit 2011), me çmim 100.000 euro. Në lidhje me mënyrën e likuidimit të këtij çmimi, kontrata parashikon se në momentin e nënshkrimit të kontratës, porositësi do të paguajë 25% të çmimit total të objektit, në vlerën prej 25.000 euro, katër muaj para dorëzimit të apartamentit do të likuidohet edhe 75% e vlerës totale të kontratës në vlerën 75.000 euro, me marrjen në dorëzim të apartamentit porositësi duhet të ketë bërë likuidimin e shumës totale të objektit, si dhe pagesa që do të kryhet nga porositësi do të vërtetohet me faturën e shoqërisë ose me mandatpagesë lëshuar nga banka.

Me lidhjen e kësaj kontrate, është vërtetuar se nëpërmjet transfertës bankare në datën 20.11.2009, në BKT, është kryer pagesa e kësaj të parë prej 25.000 euro<sup>60</sup> nga znj. B. N., nena e bashkëjetueses së subjektit, për llogari të vajzës G. N., në llogari të B. H. Për të vërtetuar këtë transfertë, si dhe faktin që transferta i përkiste kontratës së porosisë nr. \*\*\*, palët kanë nënshkruar dhe mandatpagesën e datës 20.11.2009.

**69.2.** Subjekti informoi se ai dhe bashkëjetuesja kishin menduar që pjesën tjetër të çmimit të shitjes ta likuidonin nëpërmjet marrjes së një kredie. Por duke qenë se subjekti në vitin 2010 u largua nga puna dhe marrja e kredisë u bë e pamundur, ata vlerësuan të revokonin kontratën e porosisë. Në lidhje me kthimin e shumës prej 25.000 euro, subjekti sqaroi se duke qenë se kjo shumë kishte si burim të ardhurat e familjes N., bashkëjetuesja ia kaloi prindërve të saj në vitin 2011, të cilët e përdoren për blerjen e një apartamenti tjetër nga e njëjta shoqëri, duke theksuar se kjo shumë nuk ka qenë as dhurim e as hua, por kthim i kontributit të tyre.

<sup>57</sup>Shihni aktet në aneksin \*\*\* të dosjes së ILDKPKI-së.

<sup>58</sup>Shihni përgjigjet e pyetësorit nr. 2 dhe dokumentet bashkëlidhur.

<sup>59</sup>Shihni shkresën kthim përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 5.5.2021, nga shtetasi B. H. administrator i shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k. dhe dokumentacionin bashkëngjitur në dosjen e Komisionit.

<sup>60</sup>Përbërë nga 2 transferta në datën 20.11.2009: shuma prej 2.740.000 lekësh ekuivalent me 20.000 euro dhe 5.000 euro.

**69.3.** Kalimi i shumes prej 25.000 eurosh në favor të nënës së bashkëjetueses B. N. dhe pagimi i kësaj shume prej saj si parapagim për blerjen e një apartamenti tjetër, vërtetohet edhe me deklaratimet e shoqërisë ndërtimore “\*\*\*\*” sh.p.k., e cila vuri në dispozicion: (i) mandatpagesën nr. \*\*\*, datë 4.1.2011, me anë të së cilës vërtetohet kalimi i shumës së marrë nga B. H. për llogari të kontratës nr. \*\*\* (me znj. G. N.), në vlerën 15.000 euro, në favor të blerjes së apartamentit të znj. B. N. te investitori “\*\*\*\*” sh.p.k.<sup>61</sup>; (ii) mandatpagesën nr. \*\*\*, datë 6.9.2011, me anë të së cilës vërtetohet kalimi i diferencës prej 15.000 euro, të marrë nga B. H. për llogari të kontratës nr. \*\*\* (me znj. G. N.), në favor të blerjes së apartamentit të znj. B. N. te investitori “\*\*\*\*” sh.p.k.

**69.4.** Nëna e bashkëjetueses së subjektit, znj. B. N., ka parapaguar shumën 25.000 euro në vitin 2011 (në momentin që *de facto* është revokuar kontrata e porosisë e vitit 2009 midis shoqërisë dhe vajzës së saj G. N.), me qëllim porositjen e një apartamenti tjetër të ndryshëm nga apartamenti që kishte porositur vajza e saj, pasuri të cilin e ka blerë në vitin 2014 me kontratë nr. \*\*\*, datë 24.3.2014, nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k. (investitori i ri). Kjo pasuri ka qenë e regjistruar në ZVRPP-në Tiranë, në emër të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., me nr. pasurie \*\*\*, z. k. \*\*\*, ndërkohë nga verifikimi në sistemin *online*, aktualisht rezultoi e regjistruar në emër të shtetasës B. N. Po kështu, në emër të kësaj të fundit rezultoi edhe kontrata e furnizimit me energji elektrike për këtë pasuri<sup>62</sup>, pagesat për të cilën fillojnë në muajin prill të vitit 2014. Ky apartament me sip. 102.5 m<sup>2</sup>, është blerë nga znj. B. N., me çmim shitjeje 54.840 euro, pra, sa pothuaj 1/2 e çmimit me të cilën znj. G. N. e kishte prenotuar apartamentin me sip. 108.77 m<sup>2</sup>.

**69.5.** Apartamenti i porositur nga znj. G. N., me kontratë porosie të vitit 2009, revokuar në vitin 2011, nëpërmjet kontratës së shitjes nr.\*\*\*, datë 7.4.2014, i është shitur nga ana e investitorit të ri “\*\*\*\*” sh.p.k., një personi të tretë të quajtur L. G., në çmimin 50.233 euro. Nga verifikimi i të dhënave të kontratës së porosisë së znj. G. N., konstatohet se të dhënat e pasurisë përputhen me këtë kontratë shitjeje.

**69.6.** Pavarësisht se nuk ka në akt shkresor që vërteton revokimin e kontratës së porosisë nr. \*\*\*, datë 20.11.2009, të lidhur me znj. G. N., është vërtetuar revokimi i kësaj kontrate në vitin 2011, nëpërmjet: (i) dy mandatpagesave e sipërpërmendura; (ii) shitjes së pasurisë objekt i porositjes nga znj. G. N. një personi tjetër; (iii) deklaratimeve të shoqërisë ndërtuese. Ky revokim është konfirmuar në mënyrë të njëanshme vetëm nga ana e znj. G. N., pas tre viteve, me deklaratën noteriale nr. \*\*\*, datë 21.3.2014, vënë në dispozicion të ILDKPKI-së, por edhe nga notere M. D.<sup>63</sup>. Sipas deklaratimeve të subjektit dhe shoqërisë ndërtuese, kjo ka ndodhur për arsye mirëbesimi midis palëve. Ndërsa në parashtrimet e tij, subjekti ka deklaruar se deklarata noteriale e vitit 2014 është lëshuar prej bashkëjetueses G. N., me kërkesë të palës së re blerëse të kësaj pasurie, me qëllim krijimin e bindjes se kjo e fundit kishte shkëputur çdo marrëdhënie me apartamentin objekt i kontratës së porosisë.

**69.7.** Në vitet në vijim, bashkëjetuesja e subjektit u vërtetua të ketë shkëputur çdo lidhje me këtë pasuri dhe nuk ka kryer më deklarime ashtu sikurse dhe subjekti i rivlerësimit. Në lidhje me mosdeklarimin e revokimit të kontratës në DPV-në e vitit 2014 nga bashkëjetuesja, subjekti bën me dije se kjo ka ardhur për shkak të shkëputjes së tij nga puna në qershor të vitit 2010<sup>64</sup>, për t’u rikthyer më 10.1.2013, ndërkohë që palët janë kthyer në gjendjen e mëparshme që në

<sup>61</sup>Historikut të regjistrimit sipas ekstraktit historik të subjektit “\*\*\*\*”sh.p.k., rezultoi se shoqëria e ka marrë këtë emër në vitin 2015, duke u ndryshuar nga “\*\*\*\*” sh.p.k. në “\*\*\*\*” sh.p.k. Shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k. është investitori i ri të cilit i është shitur e drejta e investimit nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k.

<sup>62</sup>Shihni informacionin e administruar në rrugë elektronike në datën 6.12.2021, nga FSHU-ja, në dosjen e Komisionit.

<sup>63</sup>Shihni shkresën kthim përgjigje nga noterja M. D., protokolluar nga Komisioni me nr. \*\*\* prot., datë 16.4.2014, bashkëngjitur së cilës kopja e noterizuar e deklaratës noteriale të revokimit nr.\*\*\*, si dhe faqja e regjistrimit në të cilën është regjistruar kjo deklaratë me përshkrim “revokim kontratë porosie”.

<sup>64</sup>Subjekti ka marrë pagë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, deri në maj të vitit 2010.



vitin 2011. Përveç kësaj, sipas tij, është perceptuar se marrëdhëniet e posaçme nënë-bijë nuk ishin të formës së huadhënies apo dhuratës që mund të deklaroheshin.

**70.** Nga verifikimet në drejtim të ndonjë konflikti të mundshëm interesi, nuk rezultuan të dhëna për çështje të trajtuara nga subjekti i rivlerësimit me palë pjesëmarrëse shtetasit B. H., A. P. apo L. G.<sup>65</sup>.

### **Në lidhje me burimin e krijimit të shumës 25.000 euro**

**71.** Me qëllim vërtetimit të burimit të ligjshëm të të ardhurave që kanë shërbyer për krijimin e shumës 25.000 euro, paguar për porositjen e apartamentit në vitin 2009 nga ana e bashkëjetueses së subjektit, Komisioni kreu verifikimet si vijojnë:

**71.1** Subjekti ka deklaruar për herë të parë bashkëjetesën me znj. G. N. në DPV-në për vitin 2008. Në DPV-në për vitin 2009, znj. G. N. edhe pse nuk ka pasur detyrimin e deklarimit të interesave private, pasi ky detyrim ka lindur sipas ligjit nr. 45/2014, ka deklaruar pagesën e shumës 25.000 euro, për blerjen e apartamentit sipas kontratës së porosisë nr. \*\*\*, datë 20.11.2009, të zgjidhur në vitin 2011. Duke qenë se bashkëjetuesja e subjektit nuk kishte deklaruar burimin e të ardhurave që kishin shërbyer për pagesën e shumës prej 25.000 euro në datën 20.11.2009 pranë BKT, subjekti është pyetur në lidhje me burimet pranë ILDKPKI-së në mars të vitit 2016.

**71.2** Në procesverbalin e mbajtur nga ILDKPKI-ja në vitin 2016<sup>66</sup>, subjekti ka deklaruar se burim i shumës 25.000 euro ka qenë pakësimi i depozitës së bashkëjetueses në BKT dhe i asaj në “Intesa Sanpaolo Bank”, vërtetuar me statement bankare. Subjekti ka theksuar se paratë e ndodhura në depozitat e bashkëshortes kanë burim të ardhurat e ligjshme të familjes N., ndër vite, konfirmuar edhe me deklaratën noteriale të datës 4.10.2010<sup>67</sup>, lëshuar nga znj. B. N. Në vijim, subjekti deklaroi se qëllimi i krijimit të këtyre depozitave, ka qenë dëshira e prindërve të saj për t'i krijuar mundësinë që të banonte në një shtëpi në pronësi të saj, duke lënë të kuptohet që depozitimet e bashkëjetueses gjatë periudhës që ka jetuar me familjen prindërore, kanë qenë në një mënyrë një “pajë” e prindërve për vajzën e tyre.

**71.3.** Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka dhënë përgjithësisht të njëjtat deklarime si në ILDKPKI në vitin 2016, duke deklaruar se kjo shumë është tërhequr nga depozitat e bashkëjetueses të cilat ishin krijuar deri në fund të vitit 2007, periudhë gjatë së cilës, bashkëjetuesja bashkë me fëmijën e lindur në janar të vitit 2007 kanë jetuar pranë familjes prindërore për shkak të ndihmës që i jepte në rritjen e fëmijës nëna e saj. Sipas tij, paratë e vendosura në llogarinë bankare të znj. G. N., në BKT dhe ish-Bankën Amerikane, kanë qenë kursime familjare të familjes N., të cilat janë tërhequr në vitin 2009 dhe së bashku me kursime të tjera të kësaj familjeje, janë përdorur për të paguar shumën 25.000 euro.

**71.4.** Në përfundim të hetimit administrativ, u vërtetua se deklaratimet e subjektit janë të saka, pasi:

Së pari, nga deklaratimet vjetore të bashkëjetueses së subjektit, rezultoi se: në DPV-në e viti 2008 znj. G. N. ka deklaruar disa llogari bankare në BKT dhe “Intesa Sanpaolo Bank” (ish-Banka Amerikane), konkretisht: (i) shumat 5.000 euro dhe 500.000 lekë në Bankën Amerikane; (ii) shumat 2.800 USD, 7.350 euro dhe 250.000 lekë, në BKT. Ndërsa në DPV-në e vitit 2009,

<sup>65</sup>Shihni shkresën kthim përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 9.7.2021, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, shkresë kthim përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 15.4.2021, nga prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, në dosjen e Komisionit.

<sup>66</sup>Shihni procesverbalin e pyetjes së subjektit në ILDKPKI në vitin 2016, bashkëngjitur shkresës kthim përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 27.4.2020, në dosjen e Komisionit.

<sup>67</sup>Sipas kësaj deklarate znj. B. N. ka hapur një llogari bankare në emër të vajzës G. N. dhe për periudhën 2005 – 2009, ka depozituar shuma të ndryshme që kanë arritur vlerën totale 15.000 euro.

kur ka deklaruar kontratën e porosisë dhe pagesën e paradhënies në shumën 25.000 euro, në të njëjtën rubrikë, bashkëjetuesja e subjektit ka deklaruar se kjo shumë është tërhequr nga depozita e deklaruar në vitin paraardhës, nga BKT-ja, në datën 20.12.2009.

Së dyti, nga informacionet bankare, rezulton se znj. G. N. ka tërhequr disa shuma deri në datën 20.11.2009 dhe konkretisht: në BKT shumën 11.946 euro dhe në “Intesa Sanpaolo Bank”, shumën 9.820 euro, në total në vlerën 21.766 euro<sup>68</sup>, sikurse është treguar në tabelën vijuese.

Data e çeljes	Data e tërheqjes	Banka	Shuma në monedhën origjinale	Shuma në euro
10/5 dhe 4.11.2005	12.1.2009 <sup>69</sup>	Intesa Sanpaolo	577 000 lekë	4 206
13.11.2007	12.1.2009	Intesa Sanpaolo	5 613 euro	5 613
28/2 dhe 1.3.2007	8.5.2009	BKT	2 800 USD	1 918
	8.5.2009	BKT	762 euro	762
28.2.2007	8.5.2009	BKT	7 350 euro	7 350
19.6.2007	8.5.2009	BKT	262 809 lekë	1 916
	<b>Viti 2009</b>		<b>Totali në euro</b>	<b>21 766</b>

**71.5** Sa i takon burimit të krijimit të këtyre depozitave me të ardhura të ligjshme të prindërve të bashkëjetueses, të cilët Komisioni i konsideroi si persona të tjerë të lidhur<sup>70</sup> në kuptim të pikës 14, të nenit 3 dhe pikës 4, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016, gjatë hetimit administrativ u pyet subjekti mbi: (i) përbërjen familjare të znj. G. N.; (ii) kohën deri kur kanë jetuar motrat e saj me familjen dhe si janë përballuar shpenzimet familjare; (iii) iu kërkua të paraqiste dokumente që vërtetojnë të ardhura të ligjshme të familjes së bashkëjetueses.

**71.6.** Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka paraqitur përbërjen familjare të familjes N. në datën 31.12.2009, sipas certifikatës familjare të lëshuar më 9.4.2021, nga Njësia Administrative Nr. \*\*\*, në përbërjen e së cilës figurojnë shtetasit: P. N., B.N., A. N., larguar me martesë në datën 14.8.2006, A. N., larguar me martesë në datën 16.3.1995, G. N., ndarë nga trangu familjar më 15.4.2005 dhe E. N. Subjekti ka deklaruar se A. N. është larguar nga Shqipëria në vitin 1999, por lejen e qëndrimit në Itali e ka marrë në datën 20.2.2001, ndërsa bashkëjetuesja G. N., megjithëse është ndarë nga trangu familjar në prill të vitit 2005 ka vazhduar të jetojë me prindërit deri në vitin 2008.

**71.7** Sa i takon shpenzimeve familjare, subjekti sqaroi se ato janë përballuar me: (i) të ardhurat e siguruar nga aktiviteti tregtar, për periudhën 1991 – 2003, i prindërve B. dhe P. N., ushtruar në adresën rruga “\*\*\*\*”; (ii) nga viti 2003-2007 nga qiratë e dyqanit; (iii) me të ardhurat nga paga e bashkëjetueses si mësuese në kolegjin “\*\*\*\*”.

**71.8** Në lidhje me aktivitetin tregtar të prindërve të bashkëjetueses, subjekti ka deklaruar se fillimisht nëna e saj ka filluar ushtrimin e aktivitetit tregtar që në vitin 1991 në një dyqan në të cilin kishte punuar si shitëse dhe në vitin 1992 e ka blerë atë. Prindërit e bashkëjetueses i kanë shpjeguar subjektit se në vitet 1991 – 2002, si subjekt tatimpagues ka qenë e regjistruar znj. B. N., ndërsa nga viti 2003 i njëjti biznes u regjistrua në emër të z. P. N.. Për të provuar deklarinimet e mësipërme, si dhe të ardhurat e krijuara nga aktiviteti i prindërve të bashkëshortes, subjekti ka vënë në dispozicion disa dokumente shkresore<sup>71</sup>.

<sup>68</sup>Kursi i këmbimit 1 euro = 137.17 lekë dhe 1 USD = 93.98 lekë, Banka e Shqipërisë më 31.12.2009.

<sup>69</sup>Të dyja shumat e tërhequra në datën 12.1.2009 kanë përshkrimin “për shpenzime familjare”.

<sup>70</sup>Për shkak të marrëdhënieve të interesit që burojnë nga dhurimi i vlerave monetare që kanë shërbyer për krijimin e depozitave të bashkëjetueses G. N. deri në vitin 2007.

<sup>71</sup> - Kontratë e privatizimit të dyqanit nr. \*\*\*, datë 2.9.1992;

**71.9** Nga analiza e të gjithë dokumentacionit të përcjellë nga subjekti u vërtetua se prindërit e bashkëjetueses kanë ushtruar aktivitetet privat, për periudhën 1992 – 2003, por nuk rezultuan të dhëna mbi xhiron dhe fitimin nga ky aktivitet. Për këtë arsye, nga Komisioni u kërkua informacion nga DRT-ja Tiranë dhe Bashkia Tiranë, në lidhje me xhiron, fitimin e aktivitetit dhe detyrimet e paguara për personin fizik “B. N.” me NIPT \*\*\*. Me shkresën kthim përgjigje nr.\*\*\* prot., datë 19.7.2021, DRT-ja Tiranë informoi se subjekti “P. G. N.” me NIPT \*\*\*\*, rezultoi i çregjistruar nga sistemi tatimor dhe se nuk disponohen dosje të këtij subjekti në arshivën e këtij institucioni në lidhje me të ardhurat e deklaruara. Ndërsa Bashkia Tiranë nuk ka kthyer përgjigje sa i takon kërkesës së Komisionit, në lidhje me pagesën e taksave vendore dhe mbi aktivitetin e personit fizik B. N., regjistruar me vendimin nr. \*\*\*, datë 14.11.1991, të gjykatës.

**71.10.** Për shtetasen B. N. subjekti ka vërtetuar se ka përfituar të ardhura nga dhënia me qira e pasurive dhe janë kryer pagesat e tatimit në burim mbi qiratë për vitet 2004 – 2006<sup>72</sup> (po kështu dhe për vitet 2011 dhe 2012<sup>73</sup>), të ardhura të cilat janë përfshirë në analizën financiare. Gjithashtu, subjekti ka vërtetuar të ardhurat nga paga e bashkëjetueses si mësuese në kolegjin “\*\*\*\*”, në vitet 2005 – 2007, të cilat janë përfshirë, gjithashtu, në analizën financiare.

**71.11.** Bazuar në të dhënat e administruara deri në përfundim të hetimit administrativ, Komisioni kreu analizën financiare të familjes N. për periudhën 1992 – 2007, si në tabelën vijuese, sipas së cilës duket se bashkëjetuesja e subjektit dhe familja e saj prindërore, nuk kanë pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të krijuar depozitat e znj. G. N., në shumën 2.605.086 lekë ose 21.545 euro<sup>74</sup>, gjendje në fund të vitit 2007 (të krijuara në vitet 2005 dhe 2007), të cilat janë përdorur për pagesën e apartamentit në shumën 25.000 euro, në vitin 2009.

<i>Familja e bashkëjetueses</i>	<i>1992 – 2007</i>
---------------------------------	--------------------

- Dokumente të cilat provojnë regjistrimin e personit juridik B. N. në nëntor 1991 si: Vendimi Gjykatës së Rrethit Tiranë me nr. \*\*\* datë 15.11.1991 për regjistrimin e personit juridik; shkresa nr. \*\*\* prot., datë 27. 4.2021, nga DRT-ja Tiranë ku znj. B. N. është regjistruar në DRT Tiranë me kod fiskal \*\*\* dhe NIPT \*\*\* me datë fillimi të aktivitetit 21.11.1991; kopje të librezës së punës së znj. B.N. ku evidentohet se në datën 30.12.1991 ajo “kalon privat”; vërtetim nr. \*\*\*, datë 25.1.2001, nga Inspektorati Shtetëror i Punës, Prefektura Tiranë nr. \*\*\*, për regjistrimin e subjektit në Inspektoratin Shtetëror të Punës.

- Dokumente që i takojnë periudhave të ndryshme nëpërmjet të cilave provohet vazhdimi i ushtrimit të aktivitetit edhe gjatë viteve në vijim si: faturë datë 27.9.1994, për blerjen e kasës dhe procesverbal i instalimit dhe marrjes në dorëzim të kasës fiskale; certifikatë e regjistrimit në organin tatimor për vitin 1998, me objekt veprimtarie “tregti ushqimore, të ndryshme me pakicë”.

- Certifikatë regjistrimi në organin tatimor për vitin 2000;

- Vërtetim nr. \*\*\*, datë 25.1.2001 nga Inspektorati Shtetëror i Punës, Prefektura Tiranë nr. \*\*\*, për regjistrimin e subjektit në Inspektoratin Shtetëror të Punës; fletë llogaritje e tatimit mbi ndërtesa datë 25.1.2001 dhe mandatarkëtimi.

Shkresa nr. \*\*\* prot., datë 26.6.2020, lëshuar nga Bashkia Tiranë, e cila informon se znj. B. N. ka likuiduar detyrimet për taksat dhe tarifatat vendore për ushtrimin e aktivitetit të saj për vitet 2001 - 2002 dhe se ka paguar taksë ndërtese për vitet 2003 – 2019. Shkresa kthim përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 27.4.2021, nga DRT-ja Tiranë, e cila informon se: (i) P. N. është regjistruar në DRT Tiranë me kod fiskal \*\*\* dhe NIPT \*\*\*, me datë fillimi të aktivitetit 21.11.1991; (ii) pagesë e tatimit të thjeshtuar të fitimit shuma 88.000 lekë për vitin 2003; (iii) për sa i përket të dhënave të tjera tatimore, në lidhje me ushtrimin e aktivitetit, për këtë tatimpagues nuk gjendet e ruajtur dosja.

- Vërtetim i bazës së vlerësuar datë 18.9.2008, nga DR e ISSH Tiranë, i cili tregon pagën *bruto* të znj. B. N., mbi të cilën ajo ka paguar detyrimet pasi është e siguruar si person fizik me nr. \*\*\* për periudhën 1.1.1992 – 31.12.2002.

Kontratë qiraje nr. \*\*\*, datë 29.3.2004 midis znj. B. N. dhe qiramarrësit E. K. në vlerën 15.000 lekë/muaj, me fat 3-vjeçar. Kjo kontratë është zgjidhur me akt noterial në datën 31.10.2006. Bashkëlidhur këtyre dokumenteve subjekti ka paraqitur disa mandatarkëtime (të cilat janë mundur të gjenden) për pagimin e tatimit mbi të ardhurat nga qiraja dhe, konkretisht, për vitet 2004, 2005 dhe 2006.

- Mandat transfertë nga BKT-ja, sipas të cilit shuma 800.000 lekë ka kaluar nga llogaria e shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k. në llogarinë e shtetasve P. ose B. N. me përshkrimin “\*\*\*\*” sh.p.k. likuidim detyrimi në favor të znj. B. N. Sipas aneks kontratës nr. \*\*\*, datë 8.11.2007, lidhur bazuar në kontratën e sipërmarrjes nr. \*\*\*, datë 11.7.2005, me shoqërinë e ndërtimit “\*\*\*\*” sh.p.k., rezultoi se familja N. ka përfituar, ndër të tjera, edhe një të ardhur në shumën 80.000 lekë/muaj, duke filluar nga data 5.1.2007 deri në dorëzimin e apartamenteve.

<sup>72</sup>Shumat: 121.500 lekë në vitin 2004; 162.000 lekë në vitin 2005 dhe 135.000 lekë në vitin 2006.

<sup>73</sup>Përlllogaritjet e vlerës së qirasë janë kryer bazuar në informacionin e DRT-së Tiranë, duke aplikuar tatimin në burim në masën 10% mbi vlerën e qirasë së paguar për këto vite dhe, konkretisht, 202.500 lekë në vitin 2011 dhe 166.500 lekë në vitin 2012.

<sup>74</sup>Kursi i këmbimit 1 euro = 120.91 lekë, sipas Bankës së Shqipërisë datë 31.12.2007.

<b>Të ardhura</b>	<b>3 771 570</b>
Paga G. N. 2005 – 2007	840 000
Paga B. N. (nga ISSH) 1999 – 2002	647 059
Nga aktiviteti privat i B. dhe P. N. (vetëm viti 2003)	880 000
Nga qiraja 2004-2006	418 500
Nga kontrata me shoqërinë “***” sh.p.k., në vitin 2007	800 000
Nga interesat bankare	186 011
<b>Shpenzime</b>	<b>10 849 670</b>
Shpenzime jetese për 4 persona	3 717 984
Shpenzime të tjera	1 800
Blerë dyqani tek F. Q., më 2.9.1992	62 006
Blerë tokë bujqësore, më 24.3.1999	500 000
<i>Ndryshimi i likuiditeteve</i>	6 567 880
<b>Mundësia për kursim</b>	<b>-7 078 100</b>

**71.12.** Kjo analizë është bazuar në metodologjinë kumulative dhe periudha e analizuar është viti 1992, kur janë paraqitur dokumente mbi të ardhurat e prindërve të bashkëjetueses dhe deri në fund të vitit 2007, kur janë krijuar depozitat. Në këtë analizë, janë përfshirë:

- Të ardhurat e dokumentuara: pagat e bashkëjetueses dhe nënës së saj; të ardhura *neto* nga qiratë e prindërve për vitet 2004-2006; të ardhura nga detyrime kontraktuale dhe të ardhura të përfituara nga interesa bankare. Sa i takon të ardhurave nga ushtrimi i aktivitetit të prindërve të saj, janë përfshirë në analizë të ardhura vetëm për vitin 2003, pasi ka informacion mbi tatimet e paguara gjatë këtij viti. Sipas ligjit nr. 8978, datë 12.12.2002, “Për taksën vendore për biznesin e vogël”, personat fizikë që nuk janë subjekt i TVSH-së, paguajnë taksë vendore sipas llojit të aktivitetit dhe tatim të thjeshtuar mbi fitimin 4% mbi qarkullimin total të realizuar. Mbi bazën e 4% tatim i paguar, është përlllogaritur se xhiro e aktivitetit për vitin 2003 ka qenë 2.200.000 lekë. Duke konsideruar një marzh fitimi 40% për llojin e aktivitetit “tregti mallrash ushqimore”, fitimi për këtë vit ka rezultuar në vlerën 880.000 lekë.

- Shpenzimet: janë përfshirë shpenzimet e jetesës të familjes së znj. G. N., për periudhën 1992 – 1999 si 66% e të ardhurave familjare; nga viti 2000 e në vijim sipas standardit të ILDKPKI-së dhe përbërjes familjare<sup>75</sup>. Në analizë janë përfshirë, gjithashtu, të gjitha shpenzimet e evidentuara të kësaj periudhe.

- Pasuritë: dyqani dhe toka bujqësore blerë në këtë periudhë, si dhe likuiditetet nëpër banka të bashkëjetueses G. N. dhe prindërve të saj, sikurse kanë rezultuar nga informacioni i përcjellë nga bankat<sup>76</sup>.

**71.13.** Në kushtet kur: (i) deri në përfundim të hetimit administrativ, nuk janë vërtetuar të ardhura të ligjshme të familjes prindërore të bashkëjetueses së subjektit (përfshirë edhe bashkëjetuesen); (ii) është vërtetuar që subjekti dhe bashkëjetuesja kanë qenë në një lidhje të paktën që në vitin 2006, pasi fëmija ka lindur në janar të vitit 2007, Komisioni ka verifikuar mundësinë financiare të subjektit duke kryer analizën financiare për vitin 2007, me qëllim

<sup>75</sup>Bashkëjetuesja, 2 prindërit dhe vëllai i saj deri në fund të vitit 2006, pas lindjes së vajzës më 17.1.2007, ½ e shpenzimeve të vajzës janë ndarë midis nënës dhe babait (subjekti) të fëmijës.

<sup>76</sup>Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 15.1.2020, nga BKT-ja; shkresa nr. \*\*\* prot., datë 27.12.2019, nga “Tirana Bank”; shkresa nr. \*\*\* prot., datë 6.1.2020; shkresa nr. \*\*\* prot., datë 31.12.2019.

evidentimin e faktit nëse ka pasur mundësi për të krijuar me të ardhura të ligjshme depozitat e bashkëjetueses të krijuara përgjatë këtij viti (është përjashtuar depozita e vitit 2005). Nga analiza financiare e subjektit e vitit 2007, duket se nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme për krijimin e depozitave në shumën 2.025.900 leke, të cilat kanë shërbyer si burim për krijimin e shumës 25.000 euro, paguar si këst për prenotimin e apartamentit nga bashkëjetuesja në vitin 2009.

**72.** Në përfundim të hetimit administrativ, subjektit i ka kaluar barra e provës, pasi duket se:

- Nuk justifikohet me të ardhura të ligjshme kësti i paguar prej 25.000 euro, në vitin 2009 nga bashkëjetuesja e subjektit për prenotimin e apartamentit objekt shqyrtimi. Gjithashtu, me njohjen e rezultateve të hetimit, i është kërkuar subjektit të sqarojë sa ka qenë xhiroja e aktivitetit të familjes N. për periudhën 1991 – 2002, duke provuar që gjatë këtyre viteve aktiviteti nuk ka pasur detyrime të papaguara.

- Mbetet e paqartë: (i) përse në deklaratën noteriale me nr. \*\*\*, datë 21.3.2014, për revokimin e kontratës së porosisë nr. \*\*\*, datë 20.11.2009, mungon vullneti i shoqërisë ndërtimore; (ii) përse pasuria e përfiturar prej znj. B. N. është blerë me ½ e çmimit që bashkëjetuesja e subjektit kishte porositur një apartament me të njëjtën sipërfaqe; (iii) përse znj. B. N. ka porositur apartamentin e banimit në vitin 2011 (të cilin e bleu në vitin 2014), në kushtet kur ajo dhe bashkëshorti kanë përfiturar 10 apartamente në vitin 2010 për shkak të këmbimit të tyre me një truall të dhënë për investim. Në këto kushte, për të hequr çdo dyshim që pasuria e blerë nga nëna e bashkëjetueses së subjektit në vitin 2014 mund të jetë një pasuri e blerë nga subjekti dhe bashkëjetuesja, subjekti të japë sqarime në lidhje me këto konstatime, si dhe të japë sqarime dhe dokumente që vërtetojnë burimin e të ardhurave që kanë shërbyer për blerjen e apartamentit nga znj. B. N., në shumën 54.840 euro.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit, vlerësimi i Komisionit bazuar në faktet dhe provat e administruara gjatë procesit të rivlerësimit dhe në ligjin e zbatueshëm**

**73.** Në lidhje me të ardhura të ligjshme që justifikojnë shumën 25.000 euro, paguar në vitin 2009 nga bashkëjetuesja, në hyrje të parashtrimeve të tij, subjekti ka deklaruar se, sipas tij, veprimet e kryera nga bashkëjetuesja në vitin 2009 nuk duhet të ishin objekt verifikimi, sepse sipas ligjit të kohës bashkëjetuesja nuk përfshihej në rrethin e personave të lidhur, por e ka deklaruar gabimisht kontratën e porosisë në DPV për vitin 2009. Po kështu, sipas subjektit, pavarësisht se pagesa e shumës prej 25.000 euro është kryer në vitin 2009, paratë në depozitë bankare, që janë përdorur për kryerjen e kësaj pagese, janë krijuar në depozitë në vitet 2005 dhe 2007, vite në të cilat nuk kishte filluar bashkëjetesa. Gjithashtu, subjekti pretendoi se nuk është i përfshirë në transaksionet e kryera apo në marrëdhënien mes bashkëjetueses dhe prindërve të saj dhe se, shuma prej 25.000 euro i është kthyer znj. B. N., duke mos u përdorur për krijimin e ndonjë pasurie prej tij dhe bashkëjetueses. Sipas tij, fakti që veprimi/kontrata e porosisë është deklaruar në DPV për vitin 2009 pa pasur detyrimin për deklarim, tregon që as bashkëjetuesja dhe as subjekti nuk kishin arsye për të mos e deklaruar apo për ta fshehur këtë transaksion.

**74.** Sa i takon këtyre pretendimeve, është e vërtetë që bashkëjetuesja e subjektit nuk ka pasur detyrimin ligjor për deklarim në DPV-në e vitit 2009, pasi ky detyrim i ka lindur asaj me ndryshimet ligjore të vitit 2014. Në konsideratë të pretendimeve të subjektit dhe faktit që DPV-ja përbën provë në procesin e rivlerësimit, nga Komisioni është vlerësuar pozitivisht deklarimi i bashkëjetueses së subjektit në DPV-në e vitit 2009, pasi ky deklarim ka ndihmuar në procesin e rivlerësimit pasuror të subjektit në kuadër të procesit të rivlerësimit sipas ligjit nr. 84/2016. Sa i takon bashkëjetesës, është e vërtetë që bashkëjetesa faktike e çiftit N. është deklaruar për herë të parë në vitin 2008, por, fakti që fëmija është lindur në janar të vitit 2007, dëshmon se

marrëdhënia mes tyre ka nisur më herët nga viti 2008, sikurse është deklaruar nga subjekti. Kështu që, pavarësisht mungesës së një bashkëjetese fizike, siç subjekti pretendon, lidhja e subjektit me znj. G. N., të paktën që në vitin 2006, ka bërë të domosdoshme kryerjen e hetimeve për të hequr çdo dyshim për lidhje dhe kontribute të subjektit të rivlerësimit me apartamentin e porositur nga bashkëjetuesja në vitin 2009, ndonëse nuk u evidentua përfshirja e tij në transaksionet e kryera për këtë apartament. Po kështu, Komisioni ka kryer verifikime për të hequr çdo dyshim për lidhje të subjektit me apartamentin e blerë nga nëna e bashkëjetueses në vitin 2014, pasi u revokua kontrata e porosisë së lidhur me bashkëjetuesen e tij në vitin 2009.

**75.** Në lidhje me ligjshmërinë e burimit të shumave të derdhura në llogarinë e bashkëjetueses së tij në vitet 2005 – 2007, të cilat kanë shërbyer për pagimin e kështit me vlerë 25.000 euro, në vitin 2009, me të ardhura të familjes N., si dhe ligjshmërinë e burimit të vlerës prej 54.840 euro, paguar nga nëna e bashkëjetueses për blerjen e apartamentit në vitin 2014, subjekti ka këmbëngulur se nuk e ka detyrimin për të provuar ligjshmërinë e këtyre shumave, por pavarësisht kësaj, ka dhënë parashtrime dhe sqarime të detajuara, bazuar në dokumente shkresore, si vijojnë:

**75.1.** Duke përmendur edhe një herë burimet e krijimit të këtyre depozitave, subjekti parashtrori se e vetmja gjë që cenon analizën financiare të Komisionit është mungesa e të dhënave mbi xhiron e aktivitetit të prindërve të bashkëshortes për vitet 1992 – 2002, për të cilat ka pretenduar se ndodhet në kushtet e pamundësisë objektive për t'i provuar, duke përmendur/listuar edhe një herë të gjitha dokumentet e administruara nga Komisioni gjatë hetimit administrativ.

**75.2.** Në argument të këtij pretendimi, subjekti sjell në vëmendje të Komisionit disa nga dokumentet e paraqitura prej tij gjatë hetimit administrativ mbi të ardhurat e prindërve të bashkëjetueses së tij G. N. nga aktiviteti i tyre privat për vitet 1992 – 2003. Ndër këto dokumente, subjekti e vë theksin mbi shkresën me nr. \*\*\* prot., datë 27.4.2021, lëshuar nga DRT-ja Tiranë, ku midis të tjerash, vërtetohet se autoritetet e tatim - taksave kanë mundur të gjejnë pagesën e tatimit të thjeshtuar të fitimit vetëm për vitin 2003, ndërsa për të dhënat e tjera tatimore, në lidhje me ushtrimin e aktivitetit nuk rezulton të jetë ruajtur dosja. Ndërkohë, subjekti ka paraqitur edhe shkresën me nr. \*\*\* prot., datë 6.1.2022, të lëshuar nga DRT-ja Tiranë, nga e cila vërtetohet edhe një herë se z. P. N. është regjistruar me NIPT \*\*\*\*, me datë fillimi të aktivitetit 21.11.1991 dhe kod fiskal \*\*\*, si dhe ka ushtruar aktivitetin deri në vitin 2003, i cili nuk ka detyrime tatimore të papaguara. Sipas kesaj shkrese, për të dhënat e tjera tatimore, në lidhje me ushtrimin e aktivitetit, nuk rezulton të jetë e ruajtur dosja sipas niptit dhe kodit fiskal të sipërcituar. Në vijim, gjatë seancës dëgjimore të datës 14.1.2022, subjekti ka paraqitur një vërtetim nga Bashkia Tiranë, i cili vërteton se personi fizik B. N. ka paguar tarifën dhe taksat vendore për vitet 2001 dhe 2002, fakt që tregon se prindërit e bashkëjetueses kanë ushtruar dhe deklaruar aktivitetin e tyre privat për këto vite.

**75.3.** Bazuar në sa më sipër, referuar edhe jurisprudencës së Kolegjit<sup>77</sup>, subjekti kërkon të vlerësohet se është në kushtet e pamundësisë objektive sipas nenit 32/2 të ligjit nr. 84/2016, për të paraqitur akte të tjera shkresore që të tregojnë të ardhurat faktike nga aktiviteti i nënës apo babait të bashkëjetueses, pasi organet tatimore kanë konfirmuar dy herë se pavarësisht të dhënave që vërtetojnë plotësisht ekzistencën e këtij aktivitetit në vitet 1991 – 2003, nuk gjendet e ruajtur dosja. Në këto kushte, subjekti kërkon që për këtë periudhë të merret për bazë xhiroja dhe fitimi i përlllogaritur nga Komisioni për vitin 2003, pra një xhiro në vlerën 2.200.000 lekë/vit dhe një fitim prej 880.000 lekësh/vit, të cilat sipas tij janë në kufirin minimal. Subjekti e vlerëson të logjikshëm konsiderimin nga Komisioni në analizën financiare të vënë në

<sup>77</sup>I është referuar vendimit nr. 14/2021, në paragrafin 27, të Kolegjit, ku arsyetohet se: “Trupi gjykues vlerësoi që në kuadër të parimit të objektivitetit në gjykim, problematikat në ruajtjen dhe administrimin e dokumentacionit nga organet shtetërore, nuk duhet të rëndojnë mbi subjektin e rivlerësimit”.

dispozicion me rezultatet e hetimit administrativ, të një fitimi vjetor në shumën 880.000 lekë për periudhën 1991 – 2002, duke argumentuar se: (i) aktiviteti tregtar ushtrohej në të njëjtin vend ku për 12 vjet rresht ka qenë dyqani ushqimor i ish-Ndërmarrjes Tregtare; (ii) në fillim të aktivitetit xhiroja dhe marzhi i fitimit kanë qenë shumë më të larta për shkak të boshllëkut dhe urisë së konsumatorëve për mallrat në treg; (iii) konkurrenca në vitet e para ka qenë më e vogël.

**75.4.** Po kështu, subjekti deklaron se sipas prindërve të bashkëjetueses, xhiroja ka qenë shumë më tepër se kaq dhe se te ardhurat e realizuara kanë mundësuar investime në shuma të konsiderueshme në firmat piramidale në vitin 1996. Konkretisht, sipas shkresës së paraqitur me parashtrimet, me nr. \*\*\* prot., datë 10.1.2022, lëshuar nga Ministria e Financave/Shoqëritë Huamarrëse në Administrim, shtetasi P. N. ka depozituar paratë e kursyera në shoqëritë piramidale. Sipas kartelës së disponuar nga shoqëria huamarrëse “\*\*\*” rezulton se babai i bashkëshortes ka depozituar, në vitin 1996 (nga janari në korrik), në këtë fondacion, shumën 4.640.000 lekë<sup>78</sup> dhe ka tërhequr interesa në shumën 3.097.110 lekë në vitet 1996 dhe 1997.

**75.5.** Me parashtrimet e veta, subjekti ka paraqitur një analizë financiare të familjes N. për vitet 1992 – 2007, duke marrë në konsideratë se të ardhurat nga aktiviteti i tyre privat për periudhën 1992 – 2003 është në vlerën 10.560.000 lekë (880.000 x 11 vjet). Sipas kësaj analize, prindërit e bashkëshortes do të kishin një mundësi kursimi deri në fund të vitit 2007, në vlerën 3.481.900 lekë, e cila do të ishte mëse e mjaftueshme për krijimin e shumës 25.000 euro, të dhëna vajzës së tyre G. N.

**76.** Në analizë të të gjitha prapësimeve të subjektit, si dhe akteve të administruara gjatë hetimit administrativ dhe referuar vendimit nr. \*\*\*, paragrafi 27, të Kolegjit, sipas të cilit problematikat në ruajtjen dhe administrimin e dokumentacionit nga organet shtetërore nuk duhet të rëndojnë mbi subjektin e rivlerësimit, sikurse me të drejtë është pretenduar nga subjekti, Komisioni krijoi bindjen se:

i) Subjekti ka vërtetuar ushtrimin e aktivitetit privat të prindërve të bashkëjetueses nga viti 1992-2003.

ii) Subjekti është në kushtet e pamundësisë objektive për të provuar të ardhura nga ky aktivitet për periudhën 1992 – 2002 (për vitin 2003 janë administruar të dhëna), parashikuar nga neni 32/2 i ligjit nr. 84/2016, që parashikon se: *“Nëse subjekti i rivlerësimit është në pamundësi objektive për të disponuar dokumentin që justifikon ligjshmërinë e krijimit të pasurive, duhet t’i vërtetojë institucionit të rivlerësimit se dokumenti është zhdukur, ka humbur, nuk mund të bëhet përsëri ose nuk merret në rrugë tjetër. Institucionet e rivlerësimit vendosin nëse mosparaqitja e dokumenteve justifikuese është për shkaqe të arsyeshme”*. Në rastin konkret, Komisioni është pikërisht përpara faktit të vërtetuar se informacioni i kërkuar nuk mund të bëhet përsëri ose nuk mund të merret në rrugë tjetër, konfirmuar me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 27.4.2021, lëshuar nga DRT-ja Tiranë, sipas së cilës autoritetet e tatim-taksave kanë mundur të gjejnë pagesën e tatimit të thjeshtuar të fitimit për vitin 2003, ndërsa për të dhënat e tjera tatimore, në lidhje me ushtrimin e aktivitetit nuk rezulton të jetë ruajtur dosja.

<sup>78</sup>Në vendimin nr. 15/2021 të Kolegjit parashtrohet se: *“21.27 Kolegji vlerësoi, në kuptim të plotësisimit të kriterëve kushtetuese dhe ligjore për të ardhurën e ligjshme edhe shumat e përfituara prej familjes së origjinës së personit të lidhur nga shitja e një banese në vitin 1995 dhe shumat e përfituara prej përfshirjes së kësaj vlere në firmat piramidale, duke qenë se në ankim, mbështetur mbi rekomandimin e vëzhguesve ndërkombëtarë, ndonëse nuk ka një pretendim konkret kundërshtues, për këto të ardhura ngihen dyshime mbi vlerësimin ose jo të tyre si të ardhura të ligjshme, në kuptim të parashikimeve kushtetuese dhe ligjore.... 21.30..... Në këto kushte, gjendur para faktit se subjekti i rivlerësimit ka mundur të paraqesë dokumente të lëshuara nga institucione shtetërore (Ministria e Financave) që provojnë përfitimet periodike të marra nga familja K. nga huamarrja në firmat piramidale, Kolegji vlerëson se të ardhurat e krijuara nga familja K. prej këtij aktiviteti, e të përfituara para miratimit të ligjit nr. 8188, datë 23.1.1997, që ndaloi ushtrimin e kësaj veprimtarie, duhet konsideruar se plotësojnë kriteret e përcaktuara nga ligji për t’u konsideruar si të ardhura të ligjshme dhe, për pasojë, janë konsideruar si të tilla në analizën financiare të kryer për kontrollin e burimeve të ligjshme të familjes K. për financimin e ndërtimit të banesës të ndodhur në {\*\*\*}”*.

77. Për këto arsye dhe në mungesë të të dhënave konkrete të të ardhurave nga aktiviteti privat, në procesin e vlerësimit përfundimtar të çështjes, nga Komisioni u vlerësua se ka vend për të marrë për bazë xhiron e aktivitetit për vitin 2003 dhe duke e konsideruar atë të njëjtë edhe për vitet 1992 – 1997, por duke e ponderuar me normën e inflacionit<sup>79</sup>. Ndërsa për vitin 1998, xhironja të konsiderohet sa ajo e vitit 2003, sikurse është pretenduar nga subjekti, në konsideratë të faktit se me ligjin nr. 8313, datë 26.3.1998, “Për tatimin mbi biznesin e vogël” u përcaktua që biznes i vogël janë personat fizikë, të cilët kanë qarkullim 0-2 milionë lekë, duke futur kështu për herë të parë një vlerë xhironje prej 2 milionë lekësh. Në përfundim të procesit, Komisioni vlerësoi që të aplikohet marzhi i fitimit 40% mbi xhiron dhe fitimin/të ardhurat për aktivitetin e prindërve të subjektit, si në tabelën vijuese, kjo, edhe në konsideratë të periudhës dhe kushteve të Shqipërisë në vitet e para të ekonomisë së tregut.

Vitet	Norma vjetore e inflacionit	Xhironja e përlogaritur	Fitimi i përlogaritur
1992	236.6%	490 196	196 078
1993	30.9%	1 036 758	414 703
1994	15.8%	1 213 458	485 383
1995	6.0%	1 213 458	485 383
1996	17.4%	1 329 305	531 722
1997	42.1%	1 379 310	551 724
1998		2 200 000	880 000
1999		2 200 000	880 000
2000		2 200 000	880 000
2001		2 200 000	880 000
2002		2 200 000	880 000
2003		2 200 000	880 000
<b>Total</b>			<b>8 078 893 lekë</b>

Duke marrë për bazë këto të ardhura, analiza financiare e prindërve të bashkëjetueses në periudhën 1992 – 2007, kur pjesë përbërëse e familjes ka qenë edhe bashkëjetuesja e subjektit, dërguar me rezultatet e hetimit administrativ, do të ndryshonte si vijon:

<i>Prindërit e G. N.</i>	<b>1992 – 2007</b>
<b>Të Ardhura</b>	<b>14 188 805</b>
Paga G. N. 2005 – 2007	840 000
Paga B. N. (nga ISSH-ja) 1999 – 2002	647 059
Nga aktiviteti privat i B. dhe P. N.	8 078 893
Nga qiraja 2004 – 2006	418 500
Fituar nga interesat te V***	3 097 110
Nga kontrata me shoqërinë “***”, në vitin 2007	800 000
Nga interesat bankare	195 252
Interesa nga BKT-ja	111 991
<b>Shpenzime</b>	<b>13 691 839</b>
Shpenzime jetese për 4 persona	5 402 534
Blere dyqani te F. Q. 2.9.1992	62 006
Blere tokë bujqësore datë 24.3.1999	500 000
Shpenzime të tjera	1 800
<i>Ndryshimi i likuiditeteve</i>	7 725 499
<b>Mundësia për kursim</b>	<b>496 966</b>

<sup>79</sup>Norma e inflacionit është kumulative që do të thotë se për të përcaktuar xhiron e vitit 1992, nisur nga viti 1998, mbi xhiron 2.200.000 lekë, mund të aplikohet inflacioni i viteve 1992 – 1997.



**78.** Në përfundim të procesit të rivlerësimit, Komisioni krijoi bindjen se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur asnjë lidhje dhe kontribut sa i takon shumës 25.000 euro, paguar nga bashkëjetuesja e tij në vitin 2009 për porositjen e një apartamenti me kontratë porosie, revokimi i të cilës është bërë në vitin 2011, referuar në mënyrë të përmbledhur fakteve dhe rrethanave si vijojnë:

i) Është vërtetuar se shuma prej 25.000 euro, paguar në vitin 2009 për porositjen e një apartamenti nga bashkëjetuesja, deklaruar prej saj në DPV-në për këtë vit, nuk i është kthyer as subjektit dhe as bashkëshortes së tij, por nënës së saj, e cila e ka përdorur për blerjen e një apartamenti të ri blerë me kontratë shitje në vitin 2014, me të cilin nuk u evidentuan lidhje të subjektit dhe bashkëshortes së tij, fakt që përforcon bindjen se kjo shumë ishte kontribut i krijuar me të ardhura të familjes N..

ii) Depozitat në emër të bashkëjetueses, të cilat kanë shërbyer si burim për krijimin e këstit të paguar në rrugë bankare në vitin 2009 prej 25.000 euro, e kanë origjinën që në vitin 2005 dhe në këto depozita janë vërtetuar derdhje të herëpashershme vlerash monetare deri në vitin 2007. Pra, nuk ka të bëjë me një pagesë *cash* apo me një depozitë të hapur rishtazi përpara se të kryhej pagesa e këstit me vlerë 25.000 euro në vitin 2009, fakte që mund të krijojnë dyshimin se kjo shumë është krijuar me të ardhura të paligjshme të subjektit të rivlerësimit.

iii) Deklarata noteriale e lëshuar nga nëna e bashkëjetueses, znj. B. N., në datën 4.10.2010<sup>80</sup>, sipas së cilës ajo ka hapur një llogari në BKT, në vitin 2005, në emër të vajzës G. N. dhe se për periudhën 2005 – 2009 ka depozituar herë pas here shuma të ndryshme që kanë arritur në total shumën 15.000 euro, shumë e cila i është dhuruar vajzës me rastin e martesës, me burim të ardhura nga kursimet e familjes dhe aktiviteti privat, vlerësohet nga Komisioni si një provë shkresore në kohë reale që vërteton pretendimet e subjektit (duhet mbajtur në kujtesë fakti që bashkëjetuesja e subjektit ka çelur llogari bankare edhe në “Intesa Sanpaolo Bank”, ku ka të depozituar vlera monetare të tjera).

iv) Bazuar në të dhënat që disponohen, nuk mund të thuhet se familja N. nuk ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të mundësuar pagimin e shumës 25.000 euro për porositjen e apartamentit të banimit nga znj. G. N., në vitin 2009.

v) Është vërtetuar se pas vitit 2011, vit në të cilin subjekti nuk ka qenë në detyrë, është ndërprerë çdo marrëdhënie e bashkëjetueses G. N. dhe, për pasojë edhe e subjektit, me pasurinë e porositur në vitin 2009 dhe kjo pasuri i është shitur dikujt tjetër në datën 7.4.2014.

**79. Mbi paqartësitë e evidentuara nga Komisioni, subjekti ka dhënë sqarime për të gjitha sa i janë kërkuar nga Komisioni, me qëllim heqjen e dyshimeve për një pasuri të mundshme të fshehur prej tij, si vijon:**

**79.1.** Lidhur me mungesën e vullnetit të shoqërisë ndërtimore në deklaratën noteriale nr. \*\*\*, datë 21.3.2014, të lëshuar nga znj. G. N. për revokimin e kontratës së porosisë nr. \*\*\*, datë 20.11.2009, subjekti ka sqaruar se ky vullnet është shprehur me veprime konkludente në momentin kur shoqëria i ka kthyer<sup>81</sup> në vitin 2011 znj. B. N. shumën 25.000 euro, sipas miratimit edhe të znj. G. N. Po kështu, edhe gjatë hetimit administrativ shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k. ka konfirmuar revokimin dhe zgjidhjen e kontratës me shtetasen G. N..

<sup>80</sup>Shihni deklaratën noteriale nr. \*\*\*, datë 4.10.2010, përçjellë nga ILDKPKI-ja së bashku me procesverbalin e datës 10.3.2016 të mbajtur pranë këtij institucioni.

<sup>81</sup>Bazuar në parashikimet e Kodit Civil, kontrata e porosisë (sipërmarrjes) nuk është kontratë formale. Kjo do të thotë se për lidhjen dhe zgjidhjen e saj nuk është e rëndësishme forma për efekt vlefshmërie. Nga ana tjetër, bazuar në nenin 868 të Kodit Civil, kontrata e porosisë është e vetmja kontratë, ku porositësi si palë e kësaj kontrate, ka të drejtë të zgjidhë kontratën në mënyrë të njëanshme edhe pse ka filluar zbatimin e saj.

Sqarimet e subjektit vlerësohen bindëse, pasi edhe gjatë hetimit administrativ shoqëria e ndërtimit e ka konfirmuar revokimin e kontratës së porosisë dhe nuk ka ngritur pretendime lidhur me këtë fakt. Ndërkohë, është e vërtetë se pavarësisht mungesës së shprehjes së vullnetit me një akt specifik, duke kthyer shumën 25.000 euro në vitin 2011, me veprime konkludente shoqëria ka pranuar revokimin e kontratës që në këtë vit. Veç këtyre, është i logjikshëm deklarimi i subjektit se deklarata e bashkëshortes e vitit 2014 është bërë me kërkesën e palës së re blerëse L. G., me qëllim krijimin e bindjes për mungesën e çdo lloj pretendimi nga znj. N. mbi pasurinë e porositur në vitin 2009, pasi është vertertuar shitja e apartamentit të ky shtetas, nëpërmjet kontratës së shitjes nr.\*\*\*, datë 7.4.2014.

**79.2.** Lidhur me çmimin e përcaktuar në kontratën e znj. B. N., pothuajse sa ½ e çmimit që bashkëshortja e subjektit do të blinte pasurinë, sipas subjektit, ky çmim është vendosur bazuar në vullnetin dhe lirinë kontraktuale të palëve dhe nuk është i lidhur me të si subjekt apo me detyrën e tij. Subjekti ka paraqitur, gjithashtu, dy kontrata shitjeje të ngjashme të dy apartamenteve të ndodhura në pallatin ku ka blerë apartamentin znj. B. N., në pronësi të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., në të cilat, sipas tij, çmimi i shitjes për metër katror është shumë i përafërt me çmimin e përcaktuar në kontratën me znj. B. N.<sup>82</sup>. Në këtë mënyrë, subjekti ka vërtetuar se nuk është rasti i vetëm që apartamentet me një sipërfaqe të përafërt janë shitur pothuajse në të njëjtin çmim. Gjithsesi, marrëdhënia e shitblerjes së vjehrrës së subjektit, znj. B. N., me shitësin e pasurisë mbetet një shprehje e vullnetit të tyre të lirë, i cili nuk u vërtetua të jetë ndikuar nga asnjë fakt e rrethanë që ka lidhje me subjektin dhe aq më tepër me detyrën e tij. Për më tepër, nuk u vërtetua asnjë lidhje e subjektit dhe bashkëshortes së tij me këtë apartament.

**79.3.** Lidhur me arsyet e porositjes së një apartamenti në vitin 2011 nga znj. B. N., kur në vitin 2010 prej bashkëshortit të saj ishin përfituar 10 apartamente nga këmbimi i një trualli, subjekti ka sqaruar se kjo lidhje me faktin që ky apartament, i porositur nga znj. B. N., ndodhej në një zonë shumë më të mirë sa i takon shërbimeve publike dhe sociale se zona ku ndodhen apartamentet e përfituara me shkëmbim, një zonë tërësisht informale ku mungonte uji i pijshëm, kanalizimet, asfaltimi i rrugëve dhe shërbimi i transportit publik.

**79.4** Subjekti pretendoi duke dhënë prova dhe argumente bindëse se së bashku me bashkëjetuesen e tij nuk kanë asnjë lidhje me pasurinë e blerë nga znj. B. N. në vitin 2014, pasi: (i) në këtë apartament ka jetuar gjithmonë çifti N., që kur apartamenti është bërë i banueshëm e deri më sot; (ii) vetë (subjekti) ka banuar gjithmonë në lagjen nr. \*\*\*, ose lagjja \*\*\* Tiranë, ku fëmijët e tij ndjekin kopshtin dhe shkollën publike të zonës, deri në vitin 2018, kur ka filluar të banojë në apartamentin e ri po me adresë në K\*\*\*\*, rruga: “\*\*\*\*”, pasuri e deklaruar në deklaratën *Vetting* si në paragrafin 18 të vendimit. Këto deklarime të subjektit përputhen edhe me pagesat për shpenzimin e energjisë elektrike në këtë pasuri, të cilat kanë nisur që prej majit të vitit 2016 në vlera aforfe, ndërkohë që pagesat e mirëfillta për shpenzimin e saj fillojnë në dhjetor të vitit 2018. Subjekti i ka vërtetuar pretendimet me dokumentet shkresore bashkëlidhur parashtrimeve si vijojnë:

- Kontratë e furnizimit të energjisë elektrike e lidhur në datën 31.7.2012 me palë kontraktuese furnizuesi “CEZ shpërndarje” dhe klientit B. A. N., me adresë banimi/konsumatori për shërbimin e dërgimit të faturës, “\*\*\*\*”, Tiranë.

- Kontratë për shërbime ujësjellës kanalizime lidhur në datën 31.7.2012 midis UKT-së dhe konsumatorit B. N. me adresë: “\*\*\*\*”, pallati \*\*\* sh.p.k.

<sup>82</sup>Shihni kontratën e shitjes nr. \*\*\*, datë 23.2.2015 dhe kontratën e shitjes nr. \*\*\*, datë 31.5.2016 dhe dokumentet bashkëlidhur.

- Kontratë e pajtimtarit për shërbimin publik telefonik fikse datë 4.12.2013 lidhur midis rrjetit të operatorit të telefonisë fikse “Albtelecom”, dhe pajtimtar z. P. G. N. me adresë banimi “\*\*\*\*” (i cili është numri i pallatit tek BKT-ja, shënim i cili gjendet edhe në kontratë).

- Kontratë për shërbimin IPTV të datës 22.12.2015 lidhur midis shoqërisë “Albtelecom” dhe z. P. N. për apartamentin afër pallatit me shigjeta te BKT-ja (shënim i shkruar në kontratë).

- Vërtetim i datës 24.12.2021 nga Njësia Administrative Nr. \*\*\*, Bashkia Tiranë, ku vërtetohet se z. P. N. me nr. identifikimi personal \*\*\* është banor i Njesisë Administrative Nr. \*\*\*, me vendndodhje “\*\*\*\*”.

- Deklaratë noteriale me nr. \*\*\*, datë 5.1.2022, me deklarues shtetasin P. H., i cili deklaron se është administrator i një pallati të ndërtuar nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k. dhe shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., i ndodhur në “\*\*\*\*”, përballë kompleksit “\*\*\*\*”, në afërsi të urës së L\*\*\*, te pallati me shigjeta. Në këtë objekt, në katin e katërt, shkalla nr. \*\*\*, apartamenti nr. \*\*\* banon edhe familja e z. P. N. që nga dhjetori i vitit 2013, pa ndërprerje.

- Vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 22.12.2021, lëshuar nga shkolla 9-vjeçare “\*\*\*\*”, Tiranë, ku vërtetohet se nxënësja S. D. P., lindur më 17.1.2007, në Tiranë, është nxënëse në klasën e nëntë për vitin shkollor 2021 - 2022 dhe ka përfunduar: klasën e 8-të në vitin 2020 - 2021; klasën e 7-të në vitin 2019 - 2020; klasën e 6-të në vitin 2018 - 2019; klasën e 5-të në vitin 2017 - 2018; klasën e 4-t në vitin 2016 - 2017; klasën e 3-të në vitin 2015 - 2016; klasën e 2-të në vitin 2014 - 2015; klasën e 1-rë në vitin 2013 - 2014.

- Vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 22.12.2021, nga shkolla 9-vjeçare “\*\*\*\*”, Tiranë, ku vërtetohet se nxënësi A. D. P., lindur më 21.2.2015, në Tiranë, është nxënës në klasën e parë për vitin shkollor 2021 - 2022 dhe figuron i regjistruar me numër amze 9080.

- Vërtetim nga Drejtoria e Përgjithshme e Çerdheve dhe Kopshteve, Bashkia Tiranë, me nr. \*\*\* prot., datë 29.12.2021, ku vërtetohet se fëmija A. D. P. ka frekuentuar çerdhe/kopsht publik nr. \*\*\* (me vendndodhje në K\*\*\*\*) për periudhën korrik 2017 – korrik 2021. Bashkëlidhur këtij vërtetimi ndodhet analizë veprimesh klienti për fëmijën A. D. P.

- Vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 28.12.2021, nga Njësia Administrative Nr. \*\*\*, Bashkia Tiranë, me anë të të cilit vërtetohet se shtetasi Drini S. Pali me nr. ID \*\*\* është banor i Njesisë Bashkiake Nr. \*\*\*, në rrugën “\*\*\*\*” dhe konfirmohet vërtetimi i lëshuar nga ndërlihdhësi me komunitetin se ky shtetas dhe familja e tij janë banorë të vjetër në këtë njësi.

**79.5.** Në përmbushje të kërkesës për të vërtetuar të ardhura të ligjshme të familjes N. për blerjen e apartamentit në vitin 2014, në çmimin 54.840 euro, subjekti ka parashtruar se shuma prej 25.000 euro i është kthyer znj. B.N. në vitin 2011 dhe është përdorur për blerjen e pasurisë, fakt i vërtetuar edhe gjatë hetimit administrativ, në mënyrën e shtjelluar më sipër në vendim.

Sa i takon pjesës prej 29.840 euro<sup>83</sup>, në përpjekje për të vërtetuar të ardhura që kanë shërbyer si burim për këtë shumë, subjekti ka deklaruar se pas vitit 2007 çifti N. ka realizuar edhe të ardhura të tjera, duke parashtruar se: “...bazuar në aneks kontratën nr. \*\*\* datë 8.11.2007, lidhur bazuar në kontratën e sipërmarrjes me nr. \*\*\*, datë 11.7.2005, me shoqërinë e ndërtimit ‘\*\*\*\*’ sh.p.k., rezulton se familja N. ka përfutuar, ndër të tjera, mbi bazën e kësaj kontrate edhe një të ardhur në shumën 80.000 lekë/muaj, duke filluar nga data 5.1.2007deri në dorëzimin e apartamenteve. Zonja dhe z. N. kanë deklaruar se apartamentet janë marrë në dorëzim në datën 12.5.2010 dhe gjatë kësaj periudhe ata kanë përfutuar çdo muaj sipas kontratës së shkëmbimit vlerën 80.000 lekë, çdo muaj. Fakt i vërtetuar përveç kontratave të sipërcituara edhe nga deklaratat noteriale bashkëlidhur këtyre prapësimeve. Sipas

<sup>83</sup>Shuma e mbetur për t’u paguar nga çmimi total i apartamentit, pas pagesës së vlerës 25.000 euro.

*përlllogaritjeve të kryera, vlera e përfituar nga kjo kontratë nga data 1.11.2007 - 12.5.2010 (30 muaj) është e barabartë me 2.400.000 lekë... ”.*

Gjithashtu, subjekti ka informuar edhe në lidhje me të ardhura të përfituara nga qiratë për disa pasuri të paluajtshme, në pronësi të prindërve të bashkëjetueses së tij në vitet 2008 – 2014, të cilat arrijnë në vlerën 1.995.000 lekë<sup>84</sup>. Sa i takon kësaj të ardhure, sipas informacionit të përcjellë nga DRT-ja Tiranë, janë provuar pagesat e tatimit në burim nga disa prej qiramarrësve për vitet 2011 dhe 2012<sup>85</sup> dhe, për këtë arsye, qiratë e përfituara janë të ardhura reale të çiftit N..

Pavarësisht perpjekjeve të subjektit, në përfundim, Komisioni çmoi se është në pamundësi objektive për të kryer një analizë të mirëfilltë financiare të familjes N. dhe për rrjedhojë, nuk mund të arrihet në një konkluzion përfundimtar nëse prinderit e bashkëjetueses së subjektit kanë pasur ose jo mjaftueshëm të ardhura për të paguar shumën prej 54.840 euro si çmim për blerjen e apartamentit në vitin 2014.

**80.** Në përfundim të procesit të rivlerësimit, Komisioni nuk ka pasur më dyshime që pasuria apartament banimi i blerë nga vjehrra e subjektit B. N. në vitin 2014, mund të ishte një pasuri e fshehur e subjektit dhe bashkëjetueses së tij, referuar në mënyrë të përmbledhur fakteve dhe rrethanave si vijojnë:

i) Nuk u vërtetua asnjë lidhje e subjektit apo bashkëshortes së tij me pasurinë si: kontrata të çdolloji, aktmarrëveshje, ndërveprime vlerash monetare në rrugë bankare ose jo, etj.. Po kështu, nuk ka pasur asnjë informacion nga cilido burim i ligjshëm për një pasuri të fshehur të subjektit dhe bashkëjetueses së tij. Megjithatë, gjatë gjithë procesit të rivlerësimit, subjekti ka dhënë shpjegime konsistente e të detajuara, si dhe ka paraqitur një numër të konsiderueshëm dokumentesh shkresore, në përpjekje për të vërtetuar sa i është kërkuar nga Komisioni në lidhje me këtë pasuri.

ii) U vërtetua që edhe pse bashkëshortët N. kanë përfituar disa apartamente në këmbim të një trualli në vitin 2010, ata kanë përdorur rregullisht apartamentin e banimit objekt shqyrtimi që në vitin 2014 deri më sot, ndërkohë që subjekti dhe bashkëshortja kanë banuar në një banesë tjetër në K\*\*\*.

iii) Përpos faktit që e drejta e zgjedhjes së banimit është individuale dhe në varësi të kushteve familjare të gjithsecilit, në parashtrime dhe në seancën dëgjimore subjekti paraqiti argumente për arsyet e mospërdorimit të asnjë prej apartamenteve të fituara me këmbim të një trualli nga çifti N. në vitin 2010, ashtu sikurse edhe për arsyet e blerjes prej tyre të apartamentit në vitin 2014.

iv) Me të dhënat që disponohen nga Komisioni, nuk mund të arrihet në përfundimin që prindërit e bashkëjetueses së subjektit nuk kanë pasur të ardhura të mjaftueshme për të porositur blerjen e apartamentit në vitin 2009, të cilin e blenë në vitin 2014, në çmimin 54.840 euro, ndërkohë, që nuk u vërtetua asnjë fakt rrethanë që ky çmim mund të jetë paguar me kontribute të subjektit apo bashkëjetueses së tij.

**81.** Nga të dhënat e sistemit *TIMS* konstatohet se subjekti dhe bashkëjetuesja kanë udhëtuar me automjetet me targat: \*\*\*, \*\*\*, \*\*\* dhe \*\*\*. I pyetur gjatë procesit të rivlerësimit mbi qëllimin e udhëtimit dhe pronarët e këtyre automjeteve, subjekti sqaroi se, kryesisht, udhëtimet kanë qenë ekskursione me kolektivin e punës së kolegjit “\*\*\*\*”, nga ana e bashkëjetueses së tij ose vizita turistike. Për shtetasit e deklaruar nga subjekti si pronarë, të konfirmuar edhe në sistemin

<sup>84</sup>Subjekti ka listuar shtatë kontrata qiraje, duke përshkruar numrat repertor dhe koleksion, afatin, vlerën mujore të qirasë dhe qiramarrësin, si dhe ka përlllogaritur të ardhura të përfituara nga çdo kontratë, por nuk ka vënë në dispozicion kontrata.

<sup>85</sup>Shihni shkresën \*\*\* prot., datë 19.7.2021, në dosjen e Komisionit.

e AMF-së, nuk rezultuan çështje të shqyrtuara<sup>86</sup> nga subjekti me palë këta shtetas apo procedime penale<sup>87</sup> në emër të tyre.

**82.** Nga të dhënat e regjistrimit noterial rezultuan një numër i konsiderueshëm aktesh noteriale nga subjekti dhe bashkëshortja. Pas administrimit të akteve noteriale nga noterët, nuk rezultuan veprime noteriale të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëjetueses së tij në lidhje me pasuri të tjera të paluajtshme dhe të luajtshme, përveç atyre të deklaruara prej tyre.

**83.** Për efekt të përlllogaritjes së shpenzimeve të jetesës, u pyet subjekti: (i) për përbërjen faktike të familjes së tij për periudhën<sup>88</sup> nga fillimi i detyrës deri në vitin 2008, kur ka filluar bashkëjetesën; dhe (ii) për të ardhurat e ligjshme të prindërve dhe familjarëve me të cilët janë përballuar shpenzimet familjare; (iii) për shumat e kontributeve nga motrat e tij nga Gjermania kur dhe si janë sjellë ato tek prindërit, duke vërtetuar burimin e ligjshëm të të ardhurave të tyre.

Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka deklaruar dhe vërtetuar me dokumenta<sup>89</sup>, se motrat e tij R. P. dhe R. L. janë larguar në Gjermani, përkatësisht, në vitet 1997 dhe 1999, por janë regjistruar rregullisht në Gjendjen Civile përkatëse në Gjermani në vitet 2001 dhe 2002

Sa i takon të ardhurave me të cilat janë paguar shpenzimet për vitet 2003 – 2008 subjekti ka specifikuar si burime: (i) të ardhurat nga puna e tij si prokuror në Prokuroritë e Rrethit Fier dhe Durrës; (ii) kontributet e dhëna nga motrat R. L. dhe R. P. duke paraqitur dhe një deklaratë të bashkëshortit të motrës R. L., shtetasit H. L., i cili ka deklaruar se mbështesin prindërit e subjektit duke dërguar në Shqipëri një shumë afërsisht 2.400 euro/vit me të ardhura të ligjshme Ndërkohe, ka vënë në dispozicion dokumenta që vërtetojnë të ardhura të ligjshme të secilës prej motrave të tij në Gjermani (trajtuar kur janë analizuar pasuritë e deklaruara si në paragrafët 38 dhe 41), si. Për rrjedhojë, prurjet e motrave nga Gjermania, janë konsideruar si të ardhura shtesë me të cilat prindërit e subjektit kanë përballuar shpenzimet të tyre.

**84.** Për shkak se vendbanimi i subjektit është i ndryshëm nga vendi i punës, është pyetur mbi kostot dhe mënyrën e transportit. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka dhënë spegime në lidhje me shpenzime transporti për periudhën 1.10.2002 - 15.10.2003. kur ka punuar në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Fier dhe për periudhën tetor 2003 – 2010, kur ka punuar në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Durrës, të cilat janë përfshirë në analizën financiare të viteve përkatëse.

**85.** Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 15.4.2021, DRT-ja Tiranë ka informuar se shtetasi Drini S. Pali është i regjistruar si individ privat në Drejtorinë Rajonale Tatimore Durrës. Me qëllim heqjen e dyshimeve që subjekti mund të ketë ushtruar aktivitet privat në kundërshtim me nenin 143 të Kushtetutës, sipas të cilit “*Qenia gjyqtar nuk pajtohet me asnjë veprimtari tjetër shtetërore, politike ose private*” dhe ligjin nr. 9877, datë 18.2.2008 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit i është kërkuar të japë sqarime dhe të paraqesë dokumente.

Në parashtrimet e datës 10.1.2022, subjekti ka deklaruar se në asnjë periudhë të caktuar kohore nuk ka zhvilluar aktivitet privat. Sipas tij, përgjigja e DRT-së Durrës, e pashpjeguar plotësisht,

<sup>86</sup>Shihni shkresën kthim përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 19.4.2021, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës dhe shkresën kthim përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 9.7.2021, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, në dosjen e Komisionit.

<sup>87</sup>Shihni shkresën kthim përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 19.4.2021, nga SPAK-u në dosjen e Komisionit.

<sup>88</sup>Sipas certifikatës së gjendjes familjare të datës 31.12.2008, rezultojnë shtatë persona në trungun familjar të subjektit.

<sup>89</sup>Vërtetim banimi i zgjeruar nga D\*\*\* datë 28.4.2021 për shtetasen R. L., sipas të cilit ajo është regjistruar me banesë në D\*\*\*-Gjermani nga data 20.9.1997, ka banuar në vijimësi dhe banon aktualisht në këtë qytet. Vërtetim banimi i zgjeruar nga M\*\*\* datë 22.4.2021 për shtetasen R. D., sipas të cilit ajo është regjistruar me banesë në O\*\*\*-Gjermani nga data 1.9.2003, ka banuar në vijimësi në qytete të ndryshme dhe aktualisht banon në M\*\*\*.

i referohet regjistrimit të tij si individ për deklarimin individual vjetor të të ardhurave. Për të vërtetuar pretendimin e tij ka paraqitur shkresën nr. \*\*\*, datë 28.12.2021, lëshuar nga Drejtoria e Shërbimit të Tatimpaguesve/Drejtoria Rajonale Tatimore Durrës, sipas së cilës, nga verifikimi i të dhënave të sistemit tatimor C@ats, vërtetohet se shtetasi Drini Pali, me nr. ID \*\*\* është i regjistruar për deklarim individual vjetor të të ardhurave dhe ka deklaruar periudhën 2019 - 2020, sipas deklaratave bashkëngjitur përgjigjes. Ndërkohë, nga verifikimi në faqen zyrtare të QKB-së, por edhe nga shkresa kthim përgjigje e QKB-së<sup>90</sup> nuk rezultojnë të dhëna për ndonjë subjekt tregtar me emër Drini Pali.

### Analiza financiare

**86.** Për të verifikuar justifikimin e pasurive dhe shpenzimeve me të ardhura të ligjshme gjatë periudhës së rivlerësimit, në përfundim të hetimit administrativ me ndihmën e Njesisë së Shërbimit Ligjor, u krye analiza financiare e subjektit për të gjithë periudhën e rivlerësimit, sipas së cilës pamundësia totale e subjektit (shuma e viteve me balancë negative) ishte në vlerën 1.754.269 lekë. Duke qenë se gjatë procesit të vlerësimit përfundimtar të çështjes nuk u vërtetuan lidhje të subjektit me shumën 25.000 euro, paguar për porositjen e një apartamenti nga bashkëjetuesja në vitin 2009, krijuar pjesërisht gjatë vitit 2007 (kur është vlerësuar që subjekti dhe bashkëjetuesja kanë qenë në një lidhje), kjo shumë nuk u konsiderua si shpenzim i subjektit të rivlerësimit për këtë vit. Për rrjedhojë, balanca e vitit 2007 bëhet nga negative në pozitive dhe, përfundimisht, subjekti rezulton me një balancë negative të pa konsiderueshme në vlerën 3.934 lekë për të gjithë periudhën e rivlerësimit, sikurse është treguar në tabelën vijuese, shumë e cila nuk vlerësohet me pasojë në vlerësimin përfundimtar të kriterit të pasurisë.

	1	2	3	4	5	6
Përshkrimi	Pasuri	Detyrime	Pasuri <i>neto</i> (1-2)	Të ardhura	Shpenzime	Mundësia për kursime 4-3-5
<i>Deri në fund 2003</i>	0	0	0	1 075 641	545 913	529 729
2004	51 236	0	51 236	1 192 645	354 492	786 917
2005	-18 176	0	-18 176	1 149 041	431 293	735 923
2006	-28 313	0	-28 313	1 122 468	401 271	749 510
2007	0	0	0	1 206 072	587 648	618 424
2008	953 835	0	953 835	2 149 618	857 697	338 086
2009	704 170	0	704 170	1 639 785	520 182	415 433
<i>31.5.2010</i>	-140 659	0	-140 659	487 047	323 043	304 663
2013	2 369 413	0	2 369 413	3 582 106	617 287	595 406
2014	703 217	0	703 217	1 637 201	937 918	-3 934
2015	4 873 256	1 000 000	3 873 256	5 682 826	987 262	822 308
2016	-205 034	0	-205 034	1 709 299	1 216 547	697 785

Gjithashtu, në rezultatet e hetimit administrativ, viti 2011, në të cilin subjekti nuk ka qenë në detyrë, kishte rezultuar me një balancë negative me vlerë 7.329.737 lekë, për shkak të konsiderimit si shpenzim të shumës 6.645.908 lekë për blerjen e dy apartamenteve prej bashkëjetueses G. N. nga babai i saj gjatë këtij viti. Për shkak se në procesin e vlerësimit

<sup>90</sup>Shihni shkresën kthim përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 31.12.2019, nga QKB-ja në dosjen e Komisionit.

përfundimtar, Komisioni krijoi bindjen e mbështetur në prova se dy apartamentet ishin dhuruar dhe, për pasojë, subjekti dhe bashkëjetuesja nuk kanë paguar asnjë vlerë monetare, rezultati i vitit 2011 u bë – 683.829 lekë, balancë e cila nuk mund të përbëjë shkak për penalizimin e subjektit.

### **Metodologjia e përdorur gjatë analizës financiare**

**87.** Në analizën financiare, për çdo pasuri të krijuar dhe/ose shpenzim të kryer, është analizuar mundësia financiare e subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur me të, duke krahasuar në çdo rast informacionet e marra në rrugë zyrtare nga institucionet kompetente ligjore me deklaratimet e subjektit. Kjo analizë është kryer duke marrë në konsideratë:

#### **87.1 Të ardhurat**

Subjekti është analizuar për periudhën e rivlerësimit që përfshin periudhën 01.10.2002 deri 31.05.2010 dhe nga 01.01.2013 deri 31.12.2016, sipas përberjes së tij familjare e për rrjedhojë, në analizën financiare janë konsideruar të ardhurat e dokumentuara të:

- subjektit: paga e tij nga data e emërimit në detyrë<sup>91</sup>;
- të ardhura nga prurjet e motrës së subjektit nga Gjermania për periudhën nga fillimi i detyrës deri në fund të vitit 2007, kur subjekti ka jetuar me prindërit e tij;
- të ardhura nga paga<sup>92</sup> e bashkëjetueses së subjektit, nga fillimi i bashkëjetesës në vitin 2008 deri në fund të periudhës së rivlerësimit.
- të ardhura nga ekzekutimi i vendimit gjyqësor nr.\*\*\* dt.22.09.2011, të kredituara në llogarinë e subjektit në vitin 2013.
- të ardhura nga interesa bankare sipas informacionit të përcjellë nga bankat e nivelit të dytë.

#### **87.2 Shpenzimet**

- shpenzimet e jetesës, janë konsideruar sipas standartit të ILDKPKI për vitet kur subjekti ka qenë në detyrë dhe në varësi të përberjes së tij familjare: nga fillimi i detyrës deri në fund të vitit 2007, janë përfshirë shpenzime jetese për 3 persona, subjekti dhe dy prindërit e tij; nga viti 2008 shpenzimet për subjektin, vajzën dhe b/jetuesen e tij; nga shkurt 2015 pas lindjes së fëmijës së dytë, për 4 persona.

-Shpenzimet e udhëtimit janë bazuar në raportin e sistemit *TIMS* dhe sqarimeve të dhëna nga subjekti gjatë procesit të hetimit administrativ. Metodologjia e përlllogaritjes së këtyre shpenzimeve është ajo e përcaktuar në vendimin (JR) nr. 11, datë 22.5.2019, të Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

- Shpenzimet e transportit nga banesa në vendin e punës janë përlllogaritur në këtë mënyrë: Për periudhën 1.10.2002 - 15.10.2003, subjekti ka udhëtuar nga Fieri në Tiranë me mjete të transportit publik. Çmimi i biletës Tiranë-Fier-Tiranë është konsideruar në vlerën 700 lekë dhe 1 muaj është konsideruar me 22 ditë pune.

Për periudhën tetor 2003 - 2010 ka përdorur mjete të transportit publik, si dhe ka udhëtuar me kolegë të punës duke ndarë shpenzimet e udhëtimit. Çmimi i biletës Tiranë-Durrës-Tiranë është konsideruar në vlerën 300 lekë dhe 1 muaj është konsideruar me 22 ditë pune, ndërsa muaji gusht nuk është përfshirë në këto përlllogaritje.

Për periudhën 2013 - 2015 ka udhëtuar Tiranë-Durrës-Tiranë me automjetin e një kolegu të tij, duke ndarë shpenzimet e udhëtimit. Shpenzimet e transportit janë përlllogaritur si ½ e karburantit të shpenzuar<sup>93</sup>.

<sup>91</sup>Vërtetim nr.\*\*\* dt.13.10.2016, nga Prokuroria prane Gjykata e Shkallws sw Parw Fier, për periudhën e punësimit nga 01.10.2002-15.10.2003; vërtetim 2017, nga Prokuroria prane Gjykatws sw Shkallws sw Parw Durrws, për periudhën e punësimit nga 15.10.2003 deri 31.05.2010 dhe 01.01.2013 e deri sot.

<sup>92</sup> Vërtetim page nga F\*\*\* G\*\*\*

<sup>93</sup>Distanca x 7 litra/100 km x çmimi mesatar i karburantit për atë vit.

Nga viti 2015 e në vijim, subjekti ka përdorur automjetin e tij tip “Mercedes-Benz”, me targa \*\*\*\*, ku janë përlogaritur kostot e karburantit për distancën Tiranë-Durrës-Tiranë.

-është përfshirë çdo shpenzim i evidentuar gjatë hetimit administrativ, nga dokumenta të administruara nga Komisioni dhe ILDKPKI.

### **87.3 Pasuritë**

-Është përfshirë apartamenti i prenotuar nga bashkëjetuesja në vitin 2009, me likuidite të krijuara nga familja e saj e origjinës, kontrata e të cilit është revokuar dhe paratë e paguara janë kthyer në vitin 2011.

-Apartamenti i prenotuar në Korrik të vitit 2015 nga subjekti dhe bashkëjetuesja e tij, në shumën 5 Mln Lekë.

- Shuma 1 Mln lekë e dhënë hua nga tek një individ.

- Blerja e automjetit në dhjetor 2015.

- Likuiditetet janë trajtuar si pjesë e pasurive në një zë të veçantë. Këtu janë përfshirë gjendjet e llogarive bankare<sup>94</sup> të subjektit dhe prindërve në fund të çdo viti/date të analizuar dhe gjendjet *cash*, sikurse janë deklaruar nga subjekti në DPV-të dhe sqarimet e dhëna gjatë procesit të rivlerësimit.

- Ndryshimi i likuiditeteve, pakësimi ose shtesa nga viti në vit, është pasuria e krijuar nga subjekti për çdo vit.

- Shuma e pasurive dhe likuiditeteve, përbën totalin e pasurisë së akumuluar nga subjekti, nga fillimi i detyrës deri në fund të periudhës së vlerësimit.

### **87.4. Detyrimet**

- Është përfshirë detyrimi i mbetur pa paguar te shoqëria ndërtuese për apartamentin e blerë në vitin 2015.

## **Vlerësim përfundimtar në lidhje me kriterin e pasurisë**

**88.** Në përfundim të procesit të rivlerësimit, referuar nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe dispozitave të kreut IV të ligjit nr. 84/2016, Komisioni krijoi bindjen se subjekti i rivlerësimit Drini Pali ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, pasi ka kryer deklarime të sakta në deklaratën Vetting dhe ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë e dhe shpenzimet e kryera për të gjithë periudhën e rivlerësimit. Pasaktësitë e konstatuara në deklaratimet periodike vjetore, nuk rezultuan të kenë qenë të qëllimshme apo të kenë pasur si synim fshehje të pasurive apo deklarime të rreme. Subjekti nuk rezultoi të kete qene në ndonjë rrethanë të konfliktit të interesit.

### **Kontrolli i figurës**

**89.** Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/206. Për këtë qëllim, DSIK-ja ka dërguar raportin nr. \*\*\* prot., datë 2.11.2017, mbi kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit Drini S. Pali, i deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. \*\*\*, datë 16.1.2020, të KDZH-së, protokolluar nga

---

<sup>94</sup>Shkresat nr.\*\*\* dt.27.12.2019 nga “Raiffeisen Bank”; nr. \*\*\* dt.15.01.2020 nga BKT Bank; nr. \*\*\* dt.27.12.2019 nga “Tirana Bank”; nr. \*\*\* dt.31.12.2019 nga ISP Bank; nr.\*\*\* dt.27.12.2019 nga RFZ Invest.



Komisioni me nr. \*\*\* prot., datë 21.1.2020, nga ku rezulton se: (i) formulari i deklaramit është i plotë dhe i plotësuar në mënyrë të saktë në përputhje me përcaktimet ligjore të ligjit nr. 84/2016; (ii) ka pasur dhe ka të njëjtat gjeneralitete si ato të deklaruara prej tij në deklaratën për kontrollin e figurës; (iii) nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për implikimin e tij apo për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar. Në konkluzion të këtij raporti, DSIK-ja ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit Drini S. Pali.

**90.** Gjatë hetimit administrativ, pas kërkesës së Komisionit për përditësim të dhënash me shkresa konfidenciale, institucionet kompetente kanë bërë me dije se për këtë subjekt kishte informacion të përditësuar. Në këto kushte, Komisioni verifikoi informacionet pranë organeve ligjzbatuese dhe, referuar të dhënave të evidentuara, kërkoi dhe administroi dosjen e procedimit penal që i përket shtetasit G. K. (trajtuar në rubrikën *vlerësimi i aftësive profesionale*), si dhe i kërkoi DSIK-së të bënte përditësimin e të dhënave.

**91.** Në vijim, DSIK-ja, bazuar në informacionin e përditësuar, ka dërguar raportin e rishikuar për subjektin Drini Pali, ku evidentohet ndryshimi i konstatimit nga përshtatshmëri në papërshtatshmëri për vijimin e ushtrimit të detyrës, deklasifikuar pjesërisht me vendimin nr. \*\*\*, datë 20.12.2021, të KDZH-së. Me njoftimin e rezultateve të hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit i është kërkuar të japë sqarime dhe dokumente në lidhje me këtë konstatim.

**92.** Në parashtimet e tij subjekti deklaroi se konkluzioni i DSIK-së është jologjik dhe jo i drejtë, ndërkaq shprehet se vetë Komisioni nuk ka një konstatim apo konkluzion të nxjerrë mbi bazën e hetimit të kryer prej tij. Sipas tij, Komisioni i ka kërkuar shpjegime mbi raportin e DSIK-së, por nga ana tjetër nuk i ka bërë me dije provat (informacion dhe dokumentacion i klasifikuar) ku e mbështet konkluzionin e tij dhe, në këto kushte, nuk ka si të mbrohet. Megjithatë, nisur nga supozimet e tij, të dhënat që DSIK-ja referon mund të jenë në kuadër të hetimeve të kryera nga SPAK-u, lidhur me procedimin penal nr. \*\*\*, regjistruar në datën 18.12.2019, pushuar nga GjPKKO-ja, me arsyetimin që fakti nuk ekziston. Bazuar në këtë fakt, sipas subjektit, dyshimet e ngritura për veprime korruptive nuk janë të mbështetura as në prova dhe as në *indicie* apo të dhënë tjetër sado minimale, për këtë arsye, sipas tij, ai arrin një nivel të besueshëm të kontrollit të figurës.

**93.** Nga sqarimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit, por edhe provat e administruara gjatë hetimit administrativ, nuk u provuan informacionet për veprime korruptive të kryera nga subjekti i rivlerësimit në lidhje me procedimin penal që i përket shtetasit G. K. Për me tepër, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, me vendimin nr. \*\*\*, datë 20.10.2020, ka vendosur pushimin e procedimit penal nr.\*\*\*, datë 20.12.2019, të regjistruar nga SPAK-u, duke arsyetuar se nga analiza e të gjitha veprimeve hetimore ka rezultuar se: shtetasit e dyshuar për veprën penale “korrupsion” (prokurori Drini Pali dhe Drejtuesi i Prokurorisë së Durrësit, z. A. Gj.) nuk kanë pasur komunikime telefonike me njëri-tjetrin dhe, përveç informacionit të referuar, nuk ekzistojnë *indicie* të tjera që të përmbajnë elementë të veprës penale; është e pamundur që vetëm bazuar në mënyrën e përfundimit të procedimit penal, e cila mund të jetë në dukje si lehtësuese për të pandehurin, të arrish në konkluzione se pas kësaj vendimmarrjeje ka elementë të veprave penale të korrupsionit aktiv/pasiv.

**94.** Në përfundim, Komisioni nuk evidentoi fakte dhe rrethana që cenojnë figurën e subjektit të rivlerësimit apo kontakte me persona të përfshirë në krimin e organizuar. Në këto kushte, Komisioni çmoi se subjekti i rivlerësimit Drini Pali është i përshtatshëm për vijimin e ushtrimit të detyrës, për shkak se ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas

parashikimit të germës “b”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016 dhe se nuk ka vend për një vlerësim negativ të kriterit të kontrollit të figurës.

### **Vlerësimi i aftësive profesionale**

**95.** Në zbatim të nenit 44 të ligjit nr. 84/2016 është bërë rivlerësimi profesional i subjektit të rivlerësimit Drini Pali, bazuar në: (i) raportin me nr. \*\*\* prot. për analizimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, të kryer nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, protokolluar nga Komisioni me nr. \*\*\* prot., datë 29.7.2020; (ii) informacionin e marrë nga burime të ligjshme; (iii) kriteret e vlerësimit të parashikuara në nenin 71 e vijues të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

**96.** Në raportin për analizimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, KLP-ja ka evidentuar saktësinë e formularit të vetëdeklarimit, përvojën profesionale në 10 vitet e fundit, detyrat e kryera 3 vitet e fundit dhe të dhënat statistikore, trajnimet në 3 vitet e fundit, të dhënat nga Drejtoria e Menaxhimit të Dokumentacionit Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse në Prokurorinë e Përgjithshme, si dhe ka kryer analizën e tri dokumenteve ligjore, të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit sipas parashikimeve ligjore dhe pesë dosjeve të përzgjedhura me short, nga ku nuk janë evidentuar problematika.

**97.** Sipas të dhënave nga burime arkivore, është konstatuar se me urdhrin nr. \*\*\*, datë 29.10.2009, të Prokurorit të Përgjithshëm, subjekti i rivlerësimit Drini Pali është shkarkuar nga detyra e zv/Drejtnesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, ndërsa me urdhrin nr. \*\*\*, datë 19.11.2009, është filluar një procedim disiplinor ndaj tij. Procedimi disiplinor ka filluar pas kontrollit të ushtruar nga Drejtoria e Inspektimit dhe Burimeve Njerëzore të Prokurorisë së Përgjithshme. Në fund të inspektimit janë konstatuar shkelje në detyrë të prokurorit, e më tej i është propozuar Presidentit të Republikës shkarkimi i tij, i cili me Dekretin nr. \*\*\*, datë 20.5.2010, ka vendosur shkarkimin e prokurorit Drini Pali, me motivacionin: “Për kryerjen e akteve dhe veprimeve që diskreditojnë rëndë figurën e prokurorit”. Në janar të vitit 2013, bazuar në vendimin nr. \*\*\*, datë 22.9.2011, të Gjykatës së Apelit, lënë në fuqi nga Gjykata e Lartë me vendimin nr. \*\*\*, datë 12.4.2012, subjekti është rikthyer në pozicionin e mëparshëm si prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, ku vazhdon dhe ushtrimin e funksionit.

Me kërkesë të Komisionit, Prokuroria e Përgjithshme<sup>95</sup> vuri në dispozicion të Komisionit praktikën e plotë duke filluar që nga data e regjistrimit të procedimit disiplinor sipas urdhrit nr. \*\*\*, datë 19.11.2009, të Prokurorit të Përgjithshëm, deri në marrjen e vendimit nr. 341, datë 28.6.2012, të Gjykatës së Lartë, i cili vendosi lënien në fuqi të vendimit nr. \*\*\*, datë 22.9.2011, të Gjykatës së Apelit Tiranë.

Në analizë të të gjitha akteve shpresore të administruara gjatë hetimit administrativ, nga Komisioni u konstatua se: (i) çështja e shkarkimit të subjektit Drini Pali është bërë objekt i shqyrtimit gjyqësor nga dy shkallë të gjyqësorit dhe në përfundim të këtij procesi, është rikthyer në detyrë, pasi nga gjykata është vlerësuar se shkaku i shkarkimit të tij nga detyra e prokurorit nuk është i bazuar në ligj dhe në prova; (ii) sa i takon shkeljeve të evidentuara nga Prokuroria e Përgjithshme pas inspektimit të punës së tij si prokuror, ato i përkasin periudhës 2007 - 2008, pra jashtë periudhës së vlerësimit të aftësive profesionale në kuptim të procesit të rivlerësimit sipas nenit 41/3 të ligjit nr. 84/2016. Referuar këtyre rrethanave, si dhe nisur nga fakti që subjekti është rikthyer në detyrë, pasi është shteruar shqyrtimi gjyqësor, si dhe nga fakti se në vitet pasardhëse të karrierës së tij profesionale nuk janë evidentuar problematika të ngjashme, por përkundrazi referuar po burimeve arkivore, në periudhën 2013 – 2016 është vlerësuar

---

<sup>95</sup>Shihni dokumentacionin bashkëngjitur shkresës kthim përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 22.11.2021, nga Prokuroria e Përgjithshme në dosjen e Komisionit.

pozitivisht sipas vendimeve të Prokurorit të Përgjithshëm, nga Komisioni nuk u çmua i domosdoshme vlerësimi i problematikave/shkeljeve të evidentuara nga Prokuroria e Përgjithshme pas inspektimit, në kuadër të vlerësimit tërësor të aftësive profesionale.

**98.** Pasi nga KLP-ja është evidentuar se për vitet kalendarike 2013, 2014, 2015 dhe 2016, subjekti ka marrë vlerësimin “shumë mirë” për aftësitë profesionale nga Prokurori i Përgjithshëm i Republikës së Shqipërisë, në analizë të të gjitha të dhënave dhe materialeve që ka marrë në shqyrtim, bazuar në kriteret ligjore të parashikuara në ligjin nr. 96/2016, ky institucion ka vlerësuar subjektin e rivlerësimit Drini Pali si vijon:

### **98.1 Për aftësitë profesionale**

*a) Njohuritë ligjore:* prokurori Drini Pali shfaq aftësi në drejtim të zbatimit të ligjit. Ai ka të qartë drejtimin e hetimit që do të kryejë në rastin konkret. Pasi urdhëron regjistrimin e procedimit, subjekti i rivlerësimit përcakton detyrat me shkrim për oficerin e policisë gjyqësore, duke i përshkruar konkretisht se çfarë duhet të kryejë dhe duke i vendosur afatin e kryerjes së tyre.

*b) Arsyetimi ligjor:* subjekti i rivlerësimit Drini Pali shfaq aftësi në arsyetimin ligjor. Tregon vëmendje që aktet e përgatitura prej tij të paraqiten të strukturuar me një gjuhë të kuptueshme. Tek aktet e përgatitura nga subjekti i rivlerësimit, konstatohet se prej tij bëhet analizë mbi rrethanat e faktit dhe provave të mbledhura, duke shprehur qëndrimin e tij logjik mbi zgjidhjen ligjore.

### **98.2 Për aftësitë organizative**

*a) Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë:* prokurori Drini Pali, në periudhën e rivlerësimit, ka trajtuar gjithsej 817 materiale. Nga analiza e pesë çështjeve të përzgjedhura në short, qëndrimi i tij është brenda afateve, sipas kërkesave të ligjit procedural penal. Analiza e të dhënave është bërë në referencë të ligjit procedural penal, Kushtetutës dhe jurisprudencës së Gjykatës së Lartë, të cilat vendosin detyrimin për respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut. Lidhur me efektivitetin në aspektin sasior në raport me kohëzgjatjen e trajtimit të çështjeve dhe kërkesave të ndryshme penale, prokurori, subjekt rivlerësimi, ka përballuar ngarkesën e punës, me efikasitet.

*b) Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore:* subjekti i rivlerësimit, prokurori Drini Pali, merr pjesë në gjykim, si palë, duke përfaqësuar Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës. Konstatohet se tregon profesionalizëm në gjykim dhe në qëndrimin që mban për çështjet në gjykim.

*c) Aftësia për të administruar dosjet:* dosjet janë të administruara rregullisht, materialet janë të vendosura në rend kronologjik, të njohin me faktin penal, me qëndrimin e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës dhe disponimin e gjykatës.

### **98.3 Për etikën dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale**

*a) Etika në punë:* gjuha e përdorur nga subjekti i rivlerësimit në përpilimin e akteve është në përputhje me etikën profesionale të prokurorit.

*b) Integriteti:* nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e tij ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

*c) Paanësia:* nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit prokurorit Drini Pali. Në asnjë prej pesë dosjeve të vëzhguara nuk ka të dhëna mbi ndonjë shkak paanësie të dokumentuar. Nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elemente të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit.

## 98.4 Për aftësitë personale dhe angazhimi profesional

a) *Aftësitë e komunikimit*: komunikimi është në përputhje me etikën e prokurorit dhe i qartë.

b) *Aftësia për të bashkëpunuar*: nuk rezultojnë të dhëna konkrete që flasin mbi aftësinë e subjektit për të bashkëpunuar mes kolegësh apo më gjerë.

c) *Gatishmëria për t'u angazhuar*: subjekti Drini Pali rezulton se ka marrë pjesë në një sërë trajnimesh me temë në fushën penale, të organizuar pranë dhe jashtë programit të Shkollës së Magjistraturës, të cilat janë përshkruar më sipër.

### Informacioni i marrë nga burime të ligjshme

**99.** Si informacion i marrë nga burime të ligjshme janë konsideruar informacionet e marra nga: (i) tri vendimet e përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit dhe pesë çështjet e shortuara sipas nenit 43 të ligjit nr. 84/2016, nga analiza e të cilave rezultuan të njëjtat gjetje të konstatuara edhe nga KLP-ja në raportin e tij; (ii) 7 denoncimet nga publiku, të administruara për subjektin e rivlerësimit, në tri prej të cilave<sup>96</sup> nuk referoheshin shkelje ligjore të kryera nga subjekti i rivlerësimit ose ngiheshin pretendime mbi vendimmarrje të padrejtë të subjektit, vlerësimi i të cilave, në zbatim të pikës 4, të nenit 73, të ligjit nr. 96/2016, është jashtë tagrit të vlerësimit nga Komisionit, si dhe (iii) informacionet e organeve ligjzbatuese.

Për 4 denoncime të paraqitura nga publiku, janë kryer verifikimet si vijojnë:

**100.** Denoncim nga shtetasi Q. K.<sup>97</sup>, i cili ngre pretendime për shkelje të rënda nga prokurori Drini Pali. Konkretisht, ka informuar se ka kallëzuar në prokurori në datën 13.7.2015 shtetasin S. K. me akuzën “falsifikim dokumentesh”. Për këtë kallëzim, prokurori Drini Pali, me vendimin nr. \*\*\*, të vitit 2015, ka vendosur mosfillimin e procedimit penal me arsyetimin se ka kaluar afati 5-vjeçar i ndjekjes penale. Pas ankimit ndaj këtij vendimi, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, me vendimin nr. \*\*\*, datë 22.10.2015, vendosi prishjen e tij dhe detyrimin e organit të prokurorisë të rifillojë hetimet duke arsyetuar se: “*Arsyetimi i prokurorit se akti i falsifikuar është përdorur vetëm në vitin 2000 është i pasaktë. AMTP-ja nr. \*\*\* është përdorur nga shtetasi S. K. në vitin 2015 dhe saktësisht është përdorur në Gjykatën Administrative Durrës, ndaj afati i parashkrimit nuk qëndron*”. Në zbatim të këtij vendimi, prokurori i njoftoi akuzën shtetasit S. K. për veprën penale “falsifikim të dokumenteve”, mbyll hetimet dhe dërgon çështjen në gjykim. Në momentin e bisedimeve përfundimtare prokurori Drini Pali, sipas denoncuesit, në mënyrë të çuditshme dhe të paprecedentë paraqet kërkesë për tërheqjen e akteve dhe vendos haptazi në kundërshtim me ligjin pushimin e çështjes me të njëjtin arsyetim që e pushoi herën e parë. Pas ankimit për të dytën herë ndaj vendimmarrjes së prokurorit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, me vendimin e datës 9.7.2019, e prishi vendimin e pushimit të prokurorit Drini Pali dhe vendosi përsëri vazhdimin e hetimit.

**100.1** Gjatë hetimit administrativ, me qëllim verifikimin e pretendimeve të denoncuesit mbi shkeljet e prokurorit Drini Pali, u administrua nga Prokuroria Durrës<sup>98</sup> dosja e procedimit penal nr. \*\*\* ndaj të kallëzuarit S. K., nga shqyrtimi i akteve të së cilës, Komisioni evidentoi të gjitha rrethanat e çështjes dhe veprimet hetimore të kryera, të pasqyruara hollësisht në rezultatet e hetimit administrativ. Në analizë të çdo prove shkresore, në përfundim të hetimit administrativ, nga subjekti dukej se:

<sup>96</sup>Shihni denoncimin nga shtetasi K. H., protokolluar nga Komisioni me nr. \*\*\* prot., datë 13.7.2018; denoncim nga shtetasi G. E., protokolluar nga Komisioni me nr. \*\*\* prot., datë 15.11.2019; denoncim nga shtetasi F. D., protokolluar nga Komisioni me nr. \*\*\* prot., datë 17.6.2021 në dosjen e Komisionit.

<sup>97</sup>Shihni denoncimin nga shtetasi Q. K., protokolluar nga Komisioni me nr. \*\*\* prot., datë 13.12.2019, denoncim nga shtetasi Q. K. protokolluar nga Komisioni me nr. \*\*\*, datë 16.11.2020, në dosjen e Komisionit.

<sup>98</sup>Shihni dokumentet bashkëngjitur shkresës kthim përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 16.9.2021, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, në dosjen e Komisionit.

- Kishte zvarritje të hetimeve pasi: (i) nga data e regjistrimit të emrit të personit në regjistrin e veprave penale (18.5.2016) e deri në paraqitjen e kërkesës për pushimin e çështjes para gjykatës (18.2.2019) hetimet kanë zgjatur rreth 2 vjet e 9 muaj, në tejkalim të afateve të parashikuara në nenin 324 të Kodit të Procedurës Penale; (ii) ka 8 vendime për zgjatje të afatit të hetimeve me nga tre muaj, përkatësisht të datave 20.5.2017, 20.8.2017, 20.11.2017, 20.1.2018, 20.4.2018, 20.7.2018, 20.10.2018 dhe 20.1.2018 për shkaqe të pajustificuara sipas nenit 324/2 të Kodit të Procedurës Penale, sipas të cilit zgjatja e afatit kushtëzohet me kompleksitetin e hetimeve dhe pamundësisë për t'i përfunduar ato brenda afatit të zgjatur.

- Kishte moszbatim të detyrave të lëna nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës në vendimin nr. \*\*\*, datë 9.7.2019, për të cilat ka vendosur kthimin e akteve të procedimit penal nr. \*\*\*, të vitit 2015. Pas këtij vendimi nuk konstatohen veprime hetimore të kryera nga subjekti i rivlerësimit.

Me njoftimin e rezultateve të hetimit subjektit iu kërkuan sqarime e dokumenta në lidhje me këto konstatime.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

**100.2** Në parashtrimet e veta subjekti ka paraqitur sqarime të detajuara bazuar në dokumente shkresore, si vijon:

Së pari, lidhur me kohëzgjatjen e afatit të hetimeve, subjekti ka sqaruar se në rastin konkret nuk ka kaluar afati dyvjeçar sipas nenit 324 të Kodit të Procedurës Penale, pasi ky procedim penal është dërguar për gjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës në datën 4.7.2016 me të pandehur shtetasin S. K. për veprën penale “falsifikim të dokumenteve” të parashikuar nga neni 186/1 i Kodit Penal dhe, në këtë moment, është ndërprerë afati i hetimit paraprak pas përfundimit të hetimeve dhe ka filluar afati gjyqësor. Pas shqyrtimit gjyqësor të çështjes Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, me vendimin nr. \*\*\*, datë 31.1.2017 (i cili ka marrë formë të prerë në datën 10.2.2017), ka vendosur kthimin e akteve të procedimit penal nr. \*\*\*, Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës, fashikull i cili është protokolluar në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Durrës me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 20.2.2017 dhe, në këtë moment, ka filluar afat i ri i hetimit paraprak.

Së dyti, lidhur me zgjatjen e afatit të hetimeve, subjekti ka sqaruar se zgjatja e afatit të hetimeve i është njoftuar të pandehurit, mbrojtësit dhe kallëzuesit dhe nuk ka pasur kontestime prej tyre sipas nenit 324 të Kodit të Procedurës Penale në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës, si dhe, nuk kanë ngritur pretendime për pavlefshmëri apo papërdorshmëri të akteve procedurale. Ndërsa sa i takon vendimeve për zgjatjen e afatit të hetimeve sipas nenit 324/2 të Kodit të Procedurës Penale subjekti parashtron se: (a) procedimi penal nr. \*\*\* ka qenë i deleguar me urdhër delegimi dhe me afat oficerit të policisë gjyqësore, pra nuk është mbajtur fizikisht nga prokurori; (b) sipas ngarkesës në punë në vitet 2017 – 2019, dokumentuar me vërtetimin e lëshuar nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Durrës rezulton se prokurori Drini Pali ka pasur një ngarkesë të konsiderueshme krahasuar edhe me prokurorë të tjerë të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës; (c) zgjatja e afatit të hetimit, i cili i është njoftuar rregullisht të pandehurit, mbrojtësit dhe kallëzuesit dhe nuk ka pasur kontestime prej tyre sipas nenit 324 të Kodit të Procedurës Penale në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës. Gjatë procesit gjyqësor nuk kanë ngritur pretendime për pavlefshmëri apo papërdorshmëri të akteve procedurale; (d) në seancën paraprake palët, por edhe vetë gjykata nuk ka konstatuar zvarritje dhe pavlefshmëri për shkak të zgjatjes së afatit të hetimeve; (e) hetimet kanë qenë komplekse, pasi janë bashkuar disa procedime penale me të njëjtin kallëzues.

Në mbështetje të pretendimeve të tij, subjekti ka paraqitur si prova: shkresën kthim përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 7.1.2022, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës mbi raportet vjetore të ngarkesës në punë të prokurorit Drini Pali në periudhën 2017 – 2019.

Në lidhje me konstatimin për moszbatim të detyrave të lëna nga gjykata, subjekti ka informuar dhe sqaruar Komisionin se ky vendim ka ardhur fizikisht i zbardhur në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Durrës, në datën 21.5.2020, dhe prokurori menjëherë ka filluar hetimet pasi njoftimi i akteve të prokurorit bëhet nëpërmjet sekretarisë, e cila në momentin e ardhjes së vendimit vendos vulën përkatëse në ekstremin e aktit. Në datën 29.5.2020, kallëzuesi Q. K. ka kërkuar pushimin e çështjes penale ndaj të dyshuarit S. K., vëllai i tij i datëlindjes 1942 (rreth 80 vjeç), ku kërkon pushimin e ndjekjes penale për shkak se shtetasi S. ka ndërruar jetë. Pra, vetë kallëzuesi nuk ka qenë i interesuar që të vazhdojë procesi penal ndaj vëllait të tij, tashme të vdekur. Duke qenë se sipas germës “e”, të pikës 1, të nenit 328, të Kodit të Procedurës Penale kjo është një rrethanë për të cilën ndjekja penale nuk mund të vazhdojë dhe është kërkuar pushimi i çështjes kërkesë, e cila është miratuar nga gjykata.

### **Vlerësimi i Komisionit**

**100.3.** Në lidhje me kohëzgjatjen e hetimeve, për sa pretendohet nga subjekti se afati i hetimeve paraprake është ndërprerë dhe ka nisur afati gjyqësor, ku pretendimi qëndron, pasi nga verifikimi i akteve të dosjes penale konstatohet se me vendimin e datës 4.7.2016, prokurori Drini Pali ka vendosur dërgimin e çështjes në gjykatë, e cila me vendimin nr. \*\*\*, datë 31.1.2017 (marrë formë të prerë në datën 10.2.2017) ka vendosur kthimin e akteve të procedimit penal nr. \*\*\* të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës, e administruar në Prokurorinë e Durrësit në datën 20.2.2017. Duke llogaritur këtë moment si afat të ri të hetimeve, kohëzgjatja e çështjes është afërsisht 2 vjet (20.2.2017 – 18.2.2019).

Sa i takon pretendimeve të subjektit mbi zgjatjen e afatit të hetimeve, nga verifikimi i akteve në dosje është e vërtetë që ndaj këtyre vendimeve nuk ka pasur kontestime, por nga përmbajtja e këtyre vendimeve, në drejtim të argumenteve të shtyrjes, përmendet vetëm një veprim hetimor i pakryer dhe, në këtë kuptim, nuk mund të flitet për veprime hetimore komplekse. Për më tepër, bashkimi i procedimeve penale, i përdorur nga subjekti si argument për të përligjur kompleksitetin e hetimeve, ka ndodhur në vitin 2019, ndërsa të gjitha vendimet e shtyrjes së afatit të hetimeve i përkasin viteve 2017 dhe 2018. Nga ana tjetër, konstatohet se referuar raporteve vjetore të ngarkesës në punë të prokurorëve të Prokurorisë Durrës për periudhën 2017 – 2019, është një ndër 6 prokurorët me ngarkesën më të lartë të kësaj prokurorie.

Sa i takon pretendimeve në lidhje me moszbatimin e detyrave konkrete të lëna nga gjykata, nga verifikimi i akteve të dosjes penale, është e vërtetë që vendimi i gjykatës është administruar nga sekretaria e Prokurorisë në datën 21.5.2020, ndërkohë që vetë kallëzuesi në datën 29.5.2020 ka kërkuar pushimin e çështjes ndaj vëllait të tij, i cili kishte ndërruar jetë, pra nuk ishte më i interesuar për hetimin e çështjes. Në këto kushte, duke qenë se, sipas germës “e”, të pikës 1, të nenit 328, të Kodit të Procedurës Penale, fakti i vdekjes, është një rrethanë për të cilën ndjekja penale nuk mund të vazhdojë nga prokurori, me të drejtë është kërkuar pushimi i çështjes dhe kjo kërkesë është pranuar nga gjykata. Nuk rezultojnë shkelje të subjektit të rivlerësimit në këtë drejtim.

Në konkluzion të sa më sipër, nga Komisioni vlerësohet se subjekti mund ta kishte menaxhuar me më shumë eficiencë kohën e trajtimit të çështjes. Megjithatë, duke mbajtur në konsideratë edhe ngarkesën e subjektit të rivlerësimit në këtë periudhë, dhe në konsideratë të faktit se kjo nuk është një shkelje e përsëritur nga subjekti, Komisioni vlerësoi që problematika e kësaj çështjeje është e pamjaftueshme për ta konsideruar subjektin me mangësi profesionale sipas germës “b”, të nenit 44, të ligjit nr. 84/2016.

**101.** Denoncim nga shtetasi R.D.<sup>99</sup>, i cili ngre pretendime për veprime korruptive dhe arbitrare të prokurorit Drini Pali. Konkretisht, denoncuesi ka informuar se ka pasur një llogari personale në degën e “Raiffeisen Bank” në Durrës, në shumën prej 400.000 USD, por kur paraqitet për të tërhequr një pjesë të tyre vihet në dijeni se në llogari nuk ka asnjë lekë. Pas denoncimit të kësaj vjedhjeje, çështja kaloi për trajtim në Prokurorinë e Durrësit, duke iu caktuar prokurorit Drini Pali. Ky prokuror urdhëroi kryerjen e ekspertizës së firmës së denoncuesit në mandatin e bankës dhe, sipas aktekspertimit, thuhet që *firma duhet të jetë shkruar dhe nënshkruar nga shtetasi R. D.*, por pa përcaktuar saktësisht nëse është apo nuk është nënshkrimi i tij. Nisur nga ky aktekspertim, prokurori Drini Pali e dërgon çështjen për gjykim, duke akuzuar denoncuesin për kallëzim të rremë dhe e trajton si të pandehur. Me zhvillimin e seancës së parë gjyqësore në datën 4.12.2017, gjyqtari i çështjes konstatoi se aktekspertimi nuk është i saktë, pasi nuk është përcaktuar i kujt është nënshkrimi në dokumentin e bankës dhe, për këtë arsye, iu la prokurorit një afat prej 3 muajsh për plotësimin e dosjes. Denoncuesi pretendon se nga dhjetori i vitit 2017 dhe deri më sot (data e dërgimit të denoncimit 17.10.2019) nuk është kryer asnjë veprim hetimor.

**101.1** Me qëllim verifikimin e pretendimeve të denoncuesit mbi moskryerjen e veprimeve hetimore, u administrua nga Prokuroria Durrës<sup>100</sup> dosja e procedimit penal nr. \*\*\*, viti 2018, në ngarkim të shtetasit R. D., nga shqyrtimi i akteve të së cilës, Komisioni evidentoi të gjitha rrethanat e çështjes dhe veprimet hetimore të kryera, të pasqyruara hollësisht në rezultatet e hetimit administrativ. Në analizë të çdo prove shkresore, në përfundim të hetimit administrativ, dukej se:

i) Subjekti kishte mungesë të veprimeve hetimore të kryera nga subjekti i rivlerësimit, pasi, nuk ka kryer të gjitha veprimet hetimore të përcaktuara nga vetë ai në urdhrin për delegimin dhe kryerjen e veprimeve hetimore të datës 18.1.2018, si pyetja e shtetasit V. K., drejtor i bankës rajonale “Raiffeisen Bank”, Durrës, si dhe nuk ka sekuestruar pamjet filmike të kamerave të zyrave të “Raiffeisen Bank” në datat e pretenduara të depozitimit dhe tërheqjes; si dhe, nuk ka kryer veprimin hetimor të ballafaqimit të shtetasit R. D. me dy punonjëset e bankës R. C. dhe B. T.

ii) Subjekti kishte zvarritje të hetimeve duke mos respektuar afatet procedurale dhe afatet e lëna nga gjykata, pasi: (a) nuk është respektuar afati i përcaktuar për kryerjen e veprimeve hetimore në urdhrin e datës 18.1.2018 dhe në dosje nuk ka urdhra për shtyrje të afatit të hetimeve; (b). nuk është respektuar afati i përcaktuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës në vendimet e saj nr. \*\*\*, datë 3.12.2018 dhe nr. \*\*\*, datë 6.5.2019 për plotësimin e hetimeve nga prokuroria.

iii) Subjekti nuk ka përmbushur në mënyrë të përsëritur detyrat e gjykatës për kryerje aktekspertimi nga grup ekspertësh dhe nuk është mbajtur në konsideratë orientimi i dhënë sipas të cilave prokurori duhet të mundësonte një aktekspertimi, ku të përcaktohej jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm nëse emri dhe mbiemri i shtetasit R. D. janë shkruar nga ky shtetas.

Me njoftimin e rezultateve të hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit iu kërkua të japë sqarime në lidhje me këto konstatime.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

**101.2** Në parashtrimet e tij në lidhje me konstatimin për moskryerje të veprimeve hetimore, subjekti ka sqaruar se pamjet filmike nga banka nuk mund të merreshin, pasi kishte kaluar një kohë e gjatë nga momenti i kryerjes së transaksionit dhe, konkretisht, nga data 5.8.2013, deri

<sup>99</sup>Shihni denoncimin nga shtetasi R. D., protokolluar nga Komisioni me nr. \*\*\* prot., datë 17.10.2019, në dosjen e Komisionit.

<sup>100</sup>Shihni dokumentet bashkëngjitur shkresës kthim përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 16.9.2021, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, në dosjen e Komisionit.

kur procedimi u regjistrua në datën 17.1.2018, pra rreth 6 vjet, konfirmuar me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 11.10.2019, të “Raiffeisen Bank”, e cila ka kthyer përgjigje që afati i ruajtjes është 30 ditë. Në këto kushte, sipas tij, nuk mund të merreshin pamjet filmike. Në rastin konkret, prova thelbësore ka qenë aktekspertimi grafik, nga ku del se nënshkrimi R. D. në dokumentin e transfertës mund të jetë shkruar nga vetë shtetasi R. D. Ndërsa sa i takon veprimin tjetër hetimor, subjekti ka sqaruar se vetë gjykata në arsyetimin e vendimit nr. \*\*\*, datë 7.12.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës ka rrezuar kërkesën për lejimin e provës me dëshmitarë të shtetasve R. C. dhe V. K., pasi nuk kanë kryer veprime dhe nuk kanë nënshkruar dokumentin objekt hetimi. Kjo do të thotë se provat e marra nga prokurori kanë qenë sipas ligjit procedural.

Në lidhje me mosrespektimin e afateve procedurale dhe afateve të lëna nga gjykata, subjekti ka sqaruar se në respektim të nenit 304 të Kodit të Procedurës Penale prokurori i ka deleguar kryerjen e veprimeve hetimore oficerit të policisë gjyqësore të Drejtorisë Vendore të Policisë Durrës me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 18.1.2018, që nuk është respektuar prej tij e konfirmuar dhe me urdhrin e delegimit të datës 21.5.2018, ku i është kërkuar vazhdimi i kryerjes së detyrave të deleguar në urdhrin e datës 18.1.2018. Më tej, subjekti ka sqaruar se ky procedim është hetuar fillimisht për veprën penale të falsifikimit të dokumenteve për ekzistencën e faktit të falsifikimit dhe në momentin e konstatimit të faktit penal të kallëzimit të rremë është proceduar me komunikimin e akuzës në datën 27.10.2018, datë në të cilën ka filluar edhe afati i hetimit ndaj shtetasit R. D., pasi deri në atë moment ka qenë me cilësinë e kallëzuesit dhe deklaruesit. Ky procedim është dërguar për gjykim në datën 18.11.2018, brenda afatit 3-mujor të parashikuar nga neni 323 i Kodit të Procedurës Penale.

Sa i takon konstatimit mbi mosrespektimin e afatit të hetimit të vendosur nga gjykata, subjekti ka informuar se ka qenë shkak objektiv mosardhja e aktekspertimit grafik të urdhëruar nga vetë gjykata, akt i cili vjen nga Instituti i Policisë Shkencore Tiranë. Kështu është administruar aktekspertimi grafik nr. \*\*\*, datë 9.8.2019 me një ekspert dhe në datën 20.9.2019 është marrë vendim dhe i është dërguar sërish ISHP-së dhe me shkresën nr. \*\*\*, datë 2.10.2019 është dërguar pranë ISHP-së vendimi i ekspertimit, akt i cili nuk është realizuar nga ekspertët deri në datën e seancës së radhës 30.10.2019, ku pas kërkesës së prokurorit u vendos zgjatja e afatit të hetimeve deri në datën 30.12.2019, pavarësisht se u depozituan edhe prova të tjera të mbledhura gjatë këtij afati.

Në lidhje me mospërbushjen e detyrave të lëna nga gjykata për kryerjen e ekspertimit me grup ekspertësh sqaron se në vendimin e ekspertimit është urdhëruar kryerja e ekspertimit nga grup ekspertësh, por në kundërshtim me sa ka urdhëruar prokurori, ekspertimi grafik përsëri është kryer me një ekspert nga Instituti i Policisë Shkencore, pra shkak nuk ka qenë prokurori, por ekspertët e Institutit të Policisë Shkencore pranë Ministrisë së Brendshme. Për këtë shkak me vendimin e datës 30.7.2019 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës vendosi të zgjasë afatin e hetimit edhe për tre muaj.

Përveç sa më sipër, subjekti ka informuar se të njëjtat ankesa që ka bërë ky shtetas në Prokurorinë e Përgjithshme ka bërë edhe në ILD, e cila pasi ka shqyrtuar pretendimet e të pandehurit R. D. ka vendosur rrëzimin e pretendimeve të tij, duke konstatuar se prokurori ka qenë në përbushje të rregullt të detyrës. Subjekti ka paraqitur vendimin e marrë nga ILD-ja në lidhje me këtë rast.

### **Vlerësimi i Komisionit**

**101.3** Për sa pretendohet nga subjekti i rivlerësimit lidhur me mosmarrjen e kamerave filmike të bankës, ky pretendim qëndron pasi nga verifikimi i akteve të dosjes së procedimit penal, referuar shkresës kthim përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 11.10.2019, të “Raiffeisen Bank”, afati i ruajtjes së pamjeve filmike është 30 ditë. Po kështu, referuar udhëzimit nr. \*\*\*, datë 5.3.2010,



të KMDP-së mbi “Përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera”, i ndryshuar, të dhënat e sistemit të video survejimit ruhen për një periudhë deri në dy muaj. Po kështu, sa i takon veprimin tjetër hetimor lidhur me pyetjen e shtetasit V. K., në arsyetimin e vendimit nr. \*\*\*, datë 7.12.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, rezulton se kjo gjykatë ka rrëzuar kërkesën për lejimin e provës me dëshmitarë të shtetasve R. C. dhe V. K., pasi nuk kanë kryer veprime dhe nuk kanë nënshkruar dokumentin objekt hetimi. Në këto kushte, shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit vlerësohen bindëse dhe të mbështetura në prova.

Në lidhje me mosrespektimin e afatit procedural prej 60 ditësh të vendosur në urdhrin e datës e datës 18.1.2018, ashtu sikurse është konstatuar edhe nga analiza e akteve, është e vërtetë që me urdhrin e datës 21.5.2018 prokurori ka kërkuar, ndër të tjera, edhe vazhdimin e detyrave të lëna në urdhrin e datës 18.1.2018 për oficerin e policisë gjyqësore, por nga ana tjetër vlerësohet se afatet e caktuara nuk duhet të jenë vetëm të shkruara, por të zbatueshme dhe nga ana e prokurorit duhet të merren masa në rast moszbatimi të tyre.

Sa i takon mosrespektimit të afateve të caktuara nga gjykata, nga verifikimi i akteve në dosje rezultoi se në të dyja rastet ka ardhur për shkak të moskryerjes së aktekspertimit në kohë. Konkretisht, afati i parë i caktuar me vendimin nr. \*\*\*, datë 3.12.2018, ka qenë 4.3.2019, ndërkohë aktekspertimi është kryer në datën 19.3.2019, ndërsa afati i caktuar me vendimin nr. \*\*\*, datë 6.5.2019 ka qenë 30.7.2019, ndërkohë që aktekspertimi është kryer në datën 9.8.2019. Pra, siç vërehet, të dyja aktet janë kryer disa ditë jashtë afatit të caktuar nga gjykata.

Ndërsa, sa i takon pretendimeve të subjektit mbi mospërbushjen e detyrave për kryerjen e aktekspertimit grafik nga një grup ekspertësh dhe jo nga një ekspert i vetëm, vërehet se ato qëndrojnë, pasi nga verifikimi i akteve rezulton se me vendimet e datave 119.2.2019, 18.6.2019 dhe 20.9.2019 oficerit të policisë gjyqësore i është kërkuar kryerja e ekspertimit teknik grafik nga grup ekspertësh.

Në konkluzion të sa më sipër, sqarimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit çmohen bindëse dhe të bazuara në prova. Për më tepër, shkeljet e pretenduara nga denoncuesi janë bërë objekt shqyrtimi edhe nga ILD-ja si organi kompetent i vlerësimit të shkeljeve profesionale të subjekteve dhe, në përfundim, nuk janë vlerësuar si të tilla. Po kështu, edhe nga informacioni i marrë gjatë hetimit administrativ<sup>101</sup> ka rezultuar se denoncuesi (nëpërmjet vëllait të tij) ka bërë një kallëzim penal ndaj subjektit të rivlerësimit për shpërdorim detyre, në lidhje me këtë çështje. Ky kallëzim penal është trajtuar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, e cila në përfundim të hetimit ka vendosur mosfillimin e procedimit penal. Pas ankimit ndaj këtij vendimi, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë, me vendimin nr. \*\*\*, ka rrëzuar kërkesën e shtetasit R. D. dhe vendimi ka marrë formë të prerë. Pra, siç vërehet, pretendimet e vëllait të denoncuesit për shpërdorim detyre nga subjekti Drini Pali janë bërë objekt shqyrtimi gjyqësor dhe, në përfundim, të këtij procesi nuk ka rezultuar që subjekti të ketë konsumuar veprë penale.

**102.** Denoncim nga shtetasi P. M.<sup>102</sup>, i cili ngre pretendime për shkelje të rënda ligjore të kryera gjatë hetimit të çështjes penale nr. \*\*\*, viti 2018, të filluar nga subjekti Drini Pali, i cili ka ngritur ndaj denoncuesit një akuzë të pabazuar në prova dhe në ligj. Sipas denoncuesit, pas përfundimit të hetimeve shtesë, pa kryer detyrat e vendosura në vendimin e gjykatës, subjekti e kaloi përsëri çështjen për gjykim dhe gjykata, me vendimin e datës 18.10.2019, vendosi pushimin e këtij procedimi penal.

<sup>101</sup>Shihni dokumentacionin bashkëngjitur shkresës kthim përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 22.11.2021 nga Prokuroria e Përgjithshme në dosjen e Komisionit.

<sup>102</sup>Denoncim nga shtetasi P. M., protokolluar nga Komisioni me nr. \*\*\* prot., datë 3.12.2019.

**102.1** Me qëllim verifikimin e pretendimeve të denoncuesit mbi shkeljet nga ana e prokurorit Drini Pali, u administrua nga Prokuroria Durrës<sup>103</sup> dosja e procedimit penal nr. \*\*\*, viti 2018, në ngarkim të të pandehurit P. M., nga shqyrtimi i akteve të së cilës, Komisioni evidentoi të gjitha rrethanat e çështjes dhe veprimet hetimore të kryera, të pasqyruara hollësisht në rezultatet e hetimit administrativ. Në analizë të çdo prove shkresore, në përfundim të hetimit administrativ, rezultoi se:

- Nga data e regjistrimit të procedimit penal me emër personi datë 16.3.2018 deri në dërgimin e çështjes në gjykim më 15.3.2019, hetimet kanë zgjatur 1 vit.

- Ka tri vendime për zgjatje të hetimeve me nga tre muaj përkatësisht të datave 15.6.2018, 15.9.2018 dhe 15.12.2018 me arsyetimin e nevojës së kryerjes së të njëjtave veprime hetimore, por pa argumentuar arsyet e moskryerjes së tyre brenda afatit të caktuar.

- Subjekti ka kryer pjesërisht veprimet hetimore të lëna si detyrë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës në vendimin nr. \*\*\*, datë 7.5.2019, ndërkohë që nga aktet në dosje rezultoi se shtetasi B. T. ka qenë jashtë shtetit dhe, për këtë arsye, nuk është bërë e mundur të realizohen veprimet hetimore të ballafaqimit me këtë shtetas, të lëna si detyrë nga gjykata.

Në përfundim të hetimit administrativ, dukej se tri vendimet për zgjatjen e afatit të hetimeve nuk janë të arsyetuara në përputhje me nenin 324/2 të Kodit të Procedurës Penale, sipas të cilit zgjatja e afatit kushtëzohet me kompleksitetin e hetimeve dhe pamundësisë për t'i përfunduar ato brenda afatit të zgjatur. Me njoftimin e rezultateve të hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit iu kërkuan sqarime në lidhje me këtë konstatim.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

**102.2** Në parashtrimet e tij, subjekti ka sqaruar se vendimet e zgjatjes kanë qenë të bazuara në ligj dhe të arsyetuara, pasi nuk janë konstatuar si të pavlefshme nga gjykata, edhe pas kërkesave të të pandehurit, çka tregon që vendimmarrja e prokurorit për zgjatjen e afatit të hetimit është e bazuar. Konkretisht, në vendimin për zgjatjen e afatit të hetimit të datës 15.6.2018 - 15.9.2018 është arsyetuar se përse hetimet nuk mund të përfundonin duke lënë si detyrë, ndër të tjera, pyetjen e kallëzuesit B. T. dhe pyetja e tij determinonte edhe kryerjen e detyrave të tjera të deleguara oficerit të policisë gjyqësore. Pyetja e këtij shtetasi nuk është realizuar, pasi nga këqyrja e sistemit TIMS kallëzuesi rezultonte jashtë shtetit.

Lidhur me vendimin e zgjatjes së afatit të hetimit, për periudhën 15.9.2018 - 15.12.2018, është arsyetuar se duhet të kryhet edhe administrimi i tabulateve telefonike të kërkuara nga shoqëritë telefonike celulare për moskryerjen e detyrave të lëna në urdhrin e delegimit dhe, pas zgjatjes së parë, këto veprime nuk janë kryer nga oficeri i policisë gjyqësore, pasi prania e kallëzuesit determinonte të gjitha veprimet e deleguara. Pavarësisht nga kjo rrethanë, në datën 25.9.2018 është kërkuar informacion nga shoqëria telefonike \*\*\*\*. Lidhur me vendimin e zgjatjes së afatit të hetimit, 15.12.2018 - 15.3.2019, nuk janë arsyetuar se përse nuk janë kryer veprimet e deleguara që kanë qenë shkak dhe për zgjatje të tjera theksohet se mungesa e kallëzuesit vështirësonte kryerjen e këtyre veprimeve të deleguara.

Përveç sa më sipër, sipas subjektit, në konkluzionet e arritura nga Komisioni, duhet të merret parasysh edhe ngarkesa në punë, e cila sipas vërtetimit përkatës të lëshuar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës (bashkëlidhur këtij observacioni), ka qenë e lartë dhe, pavarësisht kësaj, ai ka zbatuar me korrektësi ligjin penal dhe procedural.

### **Vlerësimi i Komisionit**

---

<sup>103</sup>Shihni dokumentet bashkëngjitur shkresës kthim përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 16.9.2021, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, në dosjen e Komisionit.

**102.3.** Duke vlerësuar pjesërisht të bazuara pretendimet e subjektit, argumentet e dhëna se arsyeja e shtyrjes së afatit ka qenë pikërisht mungesa e kallëzuesit B.T., çka, sipas tij, determinonte edhe kryerjen e veprimeve të tjera hetimore, nuk janë tërësisht bindëse, pasi siç ka rezultuar nga analiza e dosjes, në përfundim çështja është mbyllur pa u kryer ky veprim hetimor. Gjithashtu, bazuar në nenin 324/2 të Kodit të Procedurës Penale, sipas të cilit, zgjatja e afatit kushtëzohet me kompleksitetin e hetimeve dhe pamundësisë për t'i përfunduar ato brenda afatit, vërehet se subjekti nuk ka dhënë sqarime bindëse mbi kompleksitetin e hetimeve për të cilin hetimet duhet të shtyreshin tri herë. Në procesin e vlerësimit përfundimtar të çështjes, duke mbajtur në konsideratë edhe ngarkesën e konsiderueshme të subjektit në këtë periudhë, referuar raporteve vjetore të ngarkesës së prokurorëve të Prokurorisë Durrës, nga Komisioni u vlerësua se kjo problematikë nuk ka peshë në vlerësimin tërësor dhe nuk cenon aftësitë profesionale të subjektit të rivlerësimit.

**103.** Denoncim nr. \*\*\* nga shtetasi F. D.<sup>104</sup>, ku pretendohet se prokurori Drini Pali ka vendosur në mënyrë të padrejtë mosfillimin e procedimit penal në lidhje me dy prokurorët D. P. dhe A. M., duke shtuar edhe prokurorin N.T. Konkretisht, denoncuesi pretendon se në emisionin televiziv “\*\*\*” është provuar që mjeku i senatoriumit F. C., i cili u kap nga kamera e fshehtë, kishte marrë shumën 600.000 lekë nga një i afërm i pacientit të tij, por pavarësisht kësaj, prokurori N. T. e pushoi çështjen, edhe pse gjithçka u shfaq me zë dhe figurë.

Nga përmbajtja e denoncimit rezulton se denoncuesi ka paraqitur një kallëzim penal pranë SPAK-ut për prokurorin N.T., që i është përcjellë për trajtim Prokurorisë së Durrësit, konkretisht, prokurorit Drini Pali. Ky i fundit ka vendosur mosfillimin e procedimi penal. Sipas denoncuesit, prokurori Drini Pali nuk ka kryer veprime hetimore në lidhje me rastin, ashtu siç referohej në shkresën nr. \*\*\* prot., datë 3.11.2021, të SPAK-ut, sipas së cilës “... duhet të kryhen veprime të mëtejshme në lidhje me faktet e pretenduara nga kallëzuesi F. D. në lidhje me veprimet e kundërligjshme të pretenduara të kryera nga ish-prokurori N. T., në lidhje me vendimmarrjen e tij të datës 13.6.2017, për pushimin e hetimeve për procedimin penal nr. \*\*, të vitit 2017...”. Me njoftimin e rezultateve të hetimit, subjekti iu kërkua të japë sqarime në lidhje me pretendimet e denoncuesit për moskryerje të veprimeve hetimore, duke paraqitur në çdo rast dokumente që mbështesin pretendimet e tij.

**103.1** Në parashtrimet e tij, subjekti ka informuar se për këtë material është vendosur mosfillimi i procedimit penal, pasi thelbi i pretendimit të kallëzuesit ishte vendimmarrja e prokurorit Ndini Tavani në procedimin penal nr. \*\*\* dhe organi i akuzës nuk mund të hetojë ligjshmërinë e vendimmarrjes apo të urdhëresave të një prokurori. Sipas tij, edhe vetë SPAK-u, duke mos regjistruar procedim penal për këtë material kallëzues, është shprehur se në shkresën nr. \*\*\*, datë 3.11.2021, konstatohet se nuk ka asnjë të dhënë apo *indicie*, që të mbështesë pretendimet e kallëzuesit për rifillim të hetimeve për faktin penal të parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal, duke mos qenë para situatave ligjore të parashikuara nga nenet 329, 329/c të Kodit të Procedurës Penale, sipas të cilit vendimi i pushimit të akuzës apo çështjes mund të revokohet në rast rrethanash apo provash të reja, si dhe kur mbi bazën e ankimit të të interesuarve gjykata urdhëron kthimin e akteve dhe vazhdimin e hetimeve.

Siç vërehet, subjekti ka dhënë argumentet e tij duke iu referuar faktit se ai si prokuror nuk mund të hetonte në lidhje me ligjshmërinë e vendimmarrjes apo të urdhëresave të një prokurori, argumente të cilat Komisioni i çmoni bindëse, pasi organi i akuzës nuk mund të hetojë ligjshmërinë e vendimmarrjes së një prokurori tjetër, por kjo mund të jetë objekt shqyrtimi gjyqësor. Përveç kësaj, Komisioni thelloi bindjen e tij duke mbajtur në konsideratë edhe vlerësimin e çështjes nga Kolegji<sup>105</sup>, gjatë shqyrtimit të shkaqeve të ankimit të subjektit të

<sup>104</sup>Shihni informacionin e protokolluar nga Komisioni me nr. \*\*\* prot., datë 25.11.2021, në dosjen e Komisionit.

<sup>105</sup>Shihni vendimin nr. 33, datë 3.11.2021, të Kolegjit, f. 47.

rivlerësimit N. T. për denoncimin e shtetasit F. D., sipas të cilit konkluzioni i Komisionit për kryerje veprimesh hetimore jo të plota nga ana e subjektit N.T. nuk qëndronte. Nisur nga ky fakt, dhe jo vetëm, Komisioni i çmoi jo të mbështetura pretendimet për moskryerje veprimesh hetimore, e aq më pak nga subjekti i rivlerësimit Drini Pali në lidhje me procedimin penal ndaj subjektit N.T.

**104.** Nisur nga informacioni i marrë pranë agjencive ligjzbatuese, Komisioni ka administruar nga Prokuroria Durrës<sup>106</sup> dosjen e procedimit penal nr. \*\*\*, viti 2020, nga shqyrtimi i akteve të së cilës, në përfundim të hetimit administrativ nuk u konstatuan mangësi procedurale në trajtimin e çështjes nga subjekti i rivlerësimit Drini Pali.

**105.** Pas informacioneve të marra pranë organeve ligjzbatuese, Komisioni administroi nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës<sup>107</sup>, dosjen e procedimit penal nr. \*\*\*, viti 2016, në ngarkim të shtetasit G.K., i akuzuar fillimisht për veprën penale “vrasje me dashje”, parashikuar nga neni 76 i Kodit Penal dhe veprën penale “prodhim dhe mbajtje pa leje e armëve luftarake dhe municionit”, parashikuar nga neni 278/5 i Kodit Penal, nga shqyrtimi i akteve të së cilës, Komisioni evidentoi të gjitha rrethanat e çështjes dhe veprimet hetimore të kryera, të pasqyruara hollësisht në rezultatet e hetimit administrativ. Në analizë të çdo prove shkresore, në përfundim të hetimit administrativ, u konstatua se:

i) Në datën 1.3.2016 dita kur ka ndodhur ngjarja (vrasja e një shtetasi) dhe deri kur është bërë zëvendësimi i prokurorit V.M. me prokurorin Drini Pali, prokurori V. M. ka regjistruar procedimin penal për shtetasin G. K. për kryerjen e veprës penale “vrasje me dashje” e kryer në bashkëpunim dhe veprës penale “prodhim dhe mbajtje pa leje e armëve luftarake”. Nga prokurori V. M. janë kryer të gjitha veprimet hetimore për këtë çështje me bindjen që cilësimi ishte “vrasje me dashje” e kryer në bashkëpunim dhe në atë kohë nuk është urdhëruar kryerja e një aktekspertimi psikiatrik ligjor.

ii) Pas zëvendësimit të prokurorit V. M. me prokurorin Drini Pali, nga ky i fundit është vendosur kryerja e ekspertimit psikiatrik ligjor i të pandehurit G. K., pas 4 muajsh nga data që kishte ndodhur ngjarja (akti është bërë në datën 1.7.2016), akt ky që nisur nga koha e kaluar do ishte e vështirë pas 4 muajsh të bëhej ekspertimi psikiatrik i të pandehurit.

iii) Në materialet e referimit të prokurorit të çështjes Drini Pali është bërë ndryshimi i cilësimit të veprës penale për të pandehurin G. K. nga “vrasje me dashje e kryer në bashkëpunim” dhe “mbajtje dhe prodhim të armëve luftarake”, në “vrasje e kryer në gjendje të tronditjes së fortë psikike” dhe për shtetasin B. K. vepra penale “moskallëzim të krimit” vetëm pasi aktekspertimi psikiatrik ligjor konfirmoi se i pandehuri G. K. e ka kryer veprën penale të vrasjes në kushtet e gjendjes së rëndë psikike, akt ky i bërë pas 4 muajsh nga dita e ndodhjes së ngjarjes (datë 1.3.2016), afat ky i kaluar dhe për të cilin do të ishte e vështirë të përcaktonte gjendjen psikologjike të para 4 muajve të të pandehurit.

iv) Në kërkesën për gjykim të çështjes nga prokurori Drini Pali për gjykimin e të pandehurit G.K., akuzuar për veprën penale “vrasje e kryer në gjendje të tronditjes së fortë psikike”, nuk gjendet i pasqyruar deklarimi i personit, i cili ka marrë në automjetin e tij viktimën A. K. që është ndjekur nga dy të pandehurit, ku pasi është futur në automjetin e këtij të fundit kanë vijuar ta godasin atë me grushte dhe sende të forta, pra ka vijueshmëri veprimesh aktive të dhunshme ndaj viktimës. Ky deklarim përforconte faktin se vrasja nuk është kryer në kushtet e tronditjes së fortë psikike, por është kryer me dashje pasi i pandehuri G. K., që në fillim ka pasur me vete armën dhe ka vijuar të ushtrojë dhunë mbi viktimën në mënyrë të vazhdueshme edhe pasi ai e

<sup>106</sup>Shihni dokumentet bashkëngjitur shkresës kthim përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 16.9.2021, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, në dosjen e Komisionit.

<sup>107</sup>Shihni dosjen e bashkëngjitur shkresës kthim përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 25.10.2021, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, në dosjen e Komisionit.

kishte qëlluar atë (deklarimi i drejtuesit të automjetit që e shoqëroi në spital viktimën), pra që me veprime aktive konsistente dhe jo aty për aty.

v) Gjithashtu, veprimet e të pandehurit me armën me të cilën kreu veprën penale të marrjes së saj, futjes në brez dhe përdorimit gjatë konfliktit janë veprime që tregojnë se nuk janë marrë nga i pandehuri në kushtet e tronditjes së fortë psikike.

vi) Ndryshimi i cilësimit të veprës penale nga “vrasje me dashje” në “vrasje kryer në gjendje të tronditjes së fortë psikike” i lehtëson të pandehurit pozitën e tij në drejtim të aplikimit të marzhit të dënimit, pasi vrasja me dashje parashikon një marzh dënimi më të rëndë (nga 10 deri në 20 vjet), ndërkohë që vepra penale “vrasje e kryer në gjendje të tronditjes së fortë psikike” parashikon një marzh dënimi më të ulët për të pandehurin (dënohet me burgim deri në 8 vjet).

vii) Në konkluzionet përfundimtare përpara gjykatës, prokurori Drini Pali ka kërkuar:

*1. Deklarimin fajtor të të pandehurit G. K. për kryerjen e veprës penale “vrasje e kryer në gjendje të tronditjes së fortë psikike të çastit”, të parashikuar nga neni 82 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 8 vjet burgim. 2. Për veprën penale “prodhim dhe mbajtje pa leje të armëve luftarake”, parashikuar nga neni 278/2 i Kodit Penal dënimin e tij me 4 vjet burgim. 3. Në aplikim të nenit 55 të Kodit Penal, në bashkim të dënimeve, dënimin e të pandehurit me 10 vjet burgim. 4. Deklarimin fajtor të të pandehurit B. K. për kryerjen e veprave penale “moskallëzim të krimit”, të parashikuar nga neni 300 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 1 vit e 8 muaj burgim”.*

viii) Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, me vendimin nr. (\*\*\*) \*\*\*, ka vendosur:

*“1. Deklarimin fajtor të të pandehurit G. K. për kryerjen e veprës penale “vrasje me dashje”, e parashikuar nga neni 76 i Kodit Penal dhe sipas kësaj dispozite dhe nenit 48/b<sup>108</sup> të dënojë të pandehurin G. K. me 10 vjet burgim. 2. Deklarimin fajtor të të pandehurit G. K. për kryerjen e veprës penale “mbajtje pa leje e armëve luftarake”, parashikuar nga neni 278/2 i Kodit Penal dhe sipas kësaj dispozite, dënimin e tij me 1 vit burgim. 3. Në aplikim të nenit 55 të Kodit Penal, në bashkim të dënimeve ta dënojë përfundimisht me 10 vjet burgim. Ky dënim të fillojë nga data e arrestimit 2.3.2016 dhe vuhet në burg të sigurisë së zakonshme. 4. Të deklarojë fajtor të pandehurin B. K. për kryerjen e veprës penale “moskallëzimit të krimit”, parashikuar nga neni 300 i Kodit Penal. Sipas kësaj dispozite ta dënojë të pandehurin B. K. me 1 vit e 7 muaj burgim. Ky dënim të fillojë nga data e arrestimit 2.3.2016”.* Gjykata, në vendimin e saj, ka renditur disa arsye që e çuan në marrjen e vendimit për ndryshimin e cilësimit. Ndodhur para këtyre provave, gjykata vlerësoi se nuk është para veprës penale “vrasje në kushtet e tronditjes së fortë psikike”, por para veprës penale “vrasje me dashje”, parashikuar nga neni 76 i Kodit Penal.

ix) Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. \*\*\*, ka vendosur: *“1. Ndryshimin e vendimit penal me nr. (\*\*\*)\*\*\*, datë 20.3.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës për sa më poshtë: 1. Deklarimin fajtor të të pandehurit G. K. për veprën penale “vrasje e kryer në gjendje të tronditjes së fortë psikike”, të parashikuar nga neni 82 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 7 vjet e 6 muaj burgim; 2. Dënimin e të pandehurit G. K. me 1 vit burgim për veprën penale “mbajtje pa leje të armëve luftarake”, të parashikuar nga neni 278/2 i Kodit Penal; 3. Bazuar në nenin 55 të Kodit Penal mbi caktimin e dënimit për disa vepra penale, e dënon përfundimisht të pandehurin G. K. me 8 vjet e 6 muaj burgim; 4. Në aplikim të nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale mbi uljen e dënimit e dënon përfundimisht të pandehurin G. K. me 5 vjet e 8 muaj burgim; deklarimin e pafajshëm të të pandehurit B. K. për veprën penale*

<sup>108</sup>Neni 48 “Rrethanat lehtësuese” lehtësojnë dënimin në rrethanat që vijnë: “(b) kur vepra është kryer nën ndikimin e tronditjes psikike të shkaktuar nga provokimi ose veprime të padrejta të viktimës apo të ndonjë personi tjetër”.

*“moskallëzim të krimit”, të parashikuar nga neni 33 i Kodit Penal. Lënien në fuqi të disponimeve të tjera të bëra në vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës”.*

**105.1** Përveç sa më sipër, gjatë hetimit administrativ, Komisioni u informua se Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, me vendimin nr. \*\*\*, datë 20.10.2020, ka vendosur pushimin e procedimit penal nr. \*\*\*, datë 20.12.2019, të regjistruar nga SPAK-u. Nga përmbajtja e vendimit të gjykatës, nga materialet hetimore ka rezultuar se Drejtuesi i Prokurorisë A. Gj. në bashkëpunim me shtetasin Drini Pali, prokuror në Prokurorinë e Durrësit, në vitin 2017, kanë lehtësuar pozitën e të pandehurit G. K., duke ndryshuar cilësimin e veprës penale nga “vrasje me dashje” në “vrasje në kushtet e tronditjes së fortë psikike të çastit”, kundrejt një përfitimi të paligjshëm në vlerën 50.000 euro. Nga analiza e vendimmarrjeve ka rezultuar se në lidhje me procedimin penal në ngarkim të të pandehurit G. K., prokuroria ka vendosur dërgimin e çështjes në gjyq në ngarkim të të pandehurit G. K., për kryerjen e veprave penale “vrasje e kryer në kushtet e tronditjes së fortë psikike të çastit” dhe “mbajtje pa leje e armëve luftarake”, parashikuar nga nenet 82 dhe 278/2 të Kodit Penal. Në përfundim, gjykata ka arsyetuar se nga analiza e të gjitha veprimeve hetimore ka rezultuar se: shtetasit e dyshuar për veprën penale të korrupsionit nuk kanë pasur komunikime telefonike me njëri-tjetrin; përveç informacionit të referuar nuk ekzistojnë *indicie* të tjera që të përmbajnë elemente të veprës penale të korrupsionit; është e pamundur që vetëm bazuar në mënyrën e përfundimit të procedimit penal, e cila mund të jetë në dukje si lehtësuese për të pandehurin, të arrish në konkluzione se pas kësaj vendimmarrje ka elementë të veprave penale të korrupsionit aktiv/pasiv.

**105.2.** Në përfundim të hetimit administrativ, me njoftimin e rezultateve të hetimit, subjektit iu kërkua të japë sqarime në lidhje me konstatimin, duket se subjekti i rivlerësimit ka lehtësuar pozitën e të pandehurit, duke ndryshuar cilësimin juridik të veprës penale nga vepra penale “vrasje me dashje” në veprën penale “vrasje e kryer në gjendje të tronditjes së fortë psikike”.

**105.3.** Në parashtrimet e tij, subjekti ka sqaruar se veprimet hetimore, të kryera në procedimin penal, janë kryer bazuar në parashikimet e Kodit të Procedurës Penale dhe udhëzimeve të Prokurorit të Përgjithshëm në fuqi dhe, gjithashtu, cilësimi juridik i veprës penale është kryer bazuar në provat e administruara, si dhe në bindjen e tij të brendshme. Ky cilësim juridik është mbështetur nga Gjykata e Apelit dhe masa e dënimit e dhënë nga gjykata e shkallës së parë, pavarësisht cilësimit juridik të ndryshëm të veprës penale, ka qenë e njëjtë me masën e dënimit të kërkuar nga ana e tij në seancë gjyqësore. Në këto kushte, sipas tij, konstatimi i Komisionit se ka lehtësuar pozitën e të pandehurit, objektivisht nuk qëndron.

Më tej, subjekti ka sqaruar se edhe nga vetë emri, tronditja psikike është e çastit dhe se ekspertët psikiatër kur kryejnë aktekspertime për të vlerësuar nëse ka pasur apo jo tronditje psikike, i nxjerrin konkluzionet e tyre bazuar në veprimet dhe sjelljen e të pandehurit në momentin që ka ndodhur vepra penale, bazuar në aktet hetimore, sepse është e pamundur që ekspertimi të kryhet në çastin që ka ndodhur vepra penale. Gjithmonë ekspertimi kryhet të paktën disa ditë edhe muaj nga momenti që mund të ketë ndodhur tronditja dhe mbi bazën e akteve të dokumentuara nga policia gjyqësore gjatë hetimit të çështjes. Në vijim, subjekti argumenton se: *“Nga ana ime do të ishte urdhëruar kryerja e aktekspertimit menjëherë sapo të ishte regjistruar procedimi penal (nëse do të isha caktuar që në fillim për ushtrimin e ndjekjes penale në këtë çështje penale). Në fakt, vendimi për kryerjen e ekspertimit psikiatrik është marrë nga oficeri i policisë gjyqësore, por unë kam qenë në dijeni dhe kam qenë dakord për kryerjen e këtij veprimi procedural, i cili në fakt kryhet pothuajse gjithmonë në rastet kur jemi përpara çështjeve penale të regjistruara për veprën penale të vrasjes”.*

Në përfundim, subjekti thekson se Gjykata e Posaçme Kundër Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit ka pushuar procedimin penal sipas germës “a”, të nenit 328, të Kodit të

Procedurës Penale, pra “fakti penal nuk ekziston”. Kjo do të thotë gjykata nuk ka gjetur asnjë element apo *indicie* të çfarëdolloj natyre për ekzistencën e veprës penale “korrupsion pasiv” apo ndonjë veprë tjetër penale të parashikuar në legjislacionin penal.

### **Vlerësimi i Komisionit**

**105.4** Nga analiza e akteve të dosjes penale dhe sqarimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit, vlerësohet se gjatë trajtimit të çështjes nga prokurori Drini Pali nuk janë vërejtur mangësi të karakterit procedural. Ndërsa, bazuar në përcaktimet e pikës 4, të nenit 73, të ligjit nr. 96/2016, sipas të cilit *vlerësuesi çmon aftësitë profesionale të prokurorit pa gjykuar mbi korrektësinë dhe themelin e çështjes, si dhe pa zëvendësuar interpretimin ose logjikën e prokurorit që vlerësohet*, Komisioni gjendet para pengesës ligjore për të vlerësuar kualifikimin e veprës penale, arsyetimin dhe analizimin e elementëve të saj, të cilat janë tagër e prokurorit, bazuar në provat dhe bindjen e tij të brendshme dhe duke qenë të lidhura me themelin e çështjes, dalin jashtë tagrit të vlerësimit të Komisionit. Një vlerësim i mundshëm nga Komisioni mbi kualifikimin e veprës penale nga subjekti, do të zëvendësonte interpretimin dhe logjikën e tij si prokuror i çështjes dhe, për rrjedhojë, elemente të kualifikimit ligjor të veprës penale nuk mund të përdoren për një vlerësim negativ të aftësive profesionale, në kuptim të nenit 61/4 të ligjit nr. 84/2016.

Për të arritur në këtë përfundim, Komisioni iu referua edhe vendimit nr. 28, datë 23.10.2020, të Kolegjit, për subjektin F. V., i cili ndër të tjera, shprehet: *“Kolegji çmon se gjykimi apo vlerësimi mbi zgjidhjen e një çështjeje gjyqësore nuk mund të jetë një alternativë vlerësimi e përdorur prej organeve të rivlerësimit, për sa kohë që ky lidhet me vlerësimin e çmimit e provave dhe mbështetet mbi bindjen e brendshme të magjistratit. Në rastin konkret, pikërisht vlerësimi i aftësive profesionale të magjistratit, duke gjykuar e vlerësuar logjikën apo bindjen e tij të brendshme të formuar e shpalosur si pjesë e vendimmarrjes në trupën gjyqësore përkatëse, duke arsyetuar mbi provat e të gjitha rrethanat e çështjes së gjykuar, del jashtë misionit dhe kompetencës ligjore të organeve të rivlerësimit, prandaj edhe Kolegji vlerëson se konkluzioni se subjekti ka dhënë një zgjidhje të gabuar, duke deklaruar pafajësinë e njërit prej të gjykuarve, është një konkluzion në tejkalim të kompetencës kushtetuese të organeve të rivlerësimit dhe, si i tillë, nuk mund të përdoret për të kryer vlerësimin e tij”*.

Veç sa më sipër, Komisioni nuk evidentoi shkaqe që mund të shkaktonin cenimin e besimit të publikut nga subjekti për shkak të trajtimit të kësaj çështjeje, referuar edhe faktit se vendimmarrja e prokurorit pas shqyrtimit gjyqësor është vlerësuar e drejtë nga Gjykata e Apelit Durrës, si i vetmi autoritet që mund të kontrollojë çështjet e vendimmarrjes si në rastin konkret dhe, për më tepër, nuk janë vërtetuar elemente të karakterit korruptiv nga subjekti gjatë hetimit të çështjes nga organi i akuzës.

### **Rivlerësimi profesional sipas kritereve të parashikuara në nenin 71 dhe vijues të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”**

**106.** Gjatë procesit të vlerësimit përfundimtar të çështjes, bazuar edhe në opinionin e Komisionit të Venecias<sup>109</sup> dhe në jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese<sup>110</sup>, të cilët kanë vendosur qartë kufirin ndarës për një vlerësim negativ të aftësive profesionale, i cili bëhet vetëm në rastet e gabimeve thelbësore dhe serioze dhe/ose kur ekziston një seri e qartë dhe e vazhdueshme e gjykimeve të gabuara që tregojnë mungesë të aftësive profesionale të subjekteve të rivlerësimit, Komisioni nuk i çmoi problematikën e evidentuarë dhe të trajtuara hollësisht në këtë vendim si shkaqe që cenojnë aftësitë profesionale të subjektit të rivlerësimit

<sup>109</sup>Shihni opinionin \*\*\* të Komisionit të Venecias.

<sup>110</sup>Shihni vendimin nr. 2, datë 18.1.2017, të Gjykatës Kushtetuese.

sipas parashikimeve të germës “E” të Aneksit të Kushtetutës, apo që ta bëjnë atë të papërshtatshëm në drejtim të aftësive profesionale, në kuptim të nenit 61/4 të ligjit nr. 84/2016.

Në përfundim, në zbatim të pikës 1 të nenit 42 dhe të nenit 43 të ligjit nr. 84/2016, si dhe nenit 77 të ligjit nr. 96/2016, është kryer vlerësimi përfundimtar lidhur me secilin prej kritereve të vlerësimit të aftësive profesionale të magjistratit, sipas kritereve të parashikuara në kreun II të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në zbatim të pikës 2, të nenit E, të Aneksit të Kushtetutës, duke u vlerësuar se:

i) Subjekti i rivlerësimit ka treguar aftësi të mira profesionale sipas nenit 73 të ligjit nr. 96/2016.

ii) Subjekti i rivlerësimit ka treguar aftësi të mira organizative sipas nenit 74 të ligjit nr. 96/2016.

iii) Subjekti i rivlerësimit ka treguar etikë dhe angazhim ndaj vlerave profesionale sipas nenit 75 të ligjit nr. 96/2016.

iv) Subjekti i rivlerësimit ka treguar aftësi personale dhe angazhim profesional sipas nenit 76 të ligjit nr. 96/2016. Për sa më sipër, sipas germës “a”, të nenit 44, të ligjit nr. 84/2016, me propozim të relatores së çështjes, subjekti i rivlerësimit është vlerësuar “i aftë” profesionalisht, për shkak se ka arritur nivelin kualifikues për vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të germës “c”, të pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016.

Për sa më sipër, sipas germës “a”, të nenit 44, të ligjit nr. 84/2016, me propozim të relatores së çështjes, subjekti i rivlerësimit është vlerësuar “i aftë” profesionalisht, për shkak se ka arritur nivelin kualifikues për vlerësimin e aftësive profesionale.

#### **IV. SEANCA DËGJIMORE**

**107.** Në datën 14.1. 2022, sipas nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, u zhvillua seanca dëgjimore për procedurën e rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit Drini Pali, në përfundim të së cilës, kërkoi konfirmimin në detyrë. Në përfundim të procesit të rivlerësimit, trupi gjykues i Komisionit, pasi dëgjoji relatoren e çështjes, komisionere Firdes Shuli, e cila rekomandoi konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, si dhe pasi administroi dokumentet shkresore, përfundoi procedurën e rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit Drini Pali dhe shpalli vendimin në seancën e datës 18.1.2022, sipas pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.

#### **V. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT**

**108.** Gjatë procesit të rivlerësimit, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave, si dhe krijimin e bindjes së brendshme, trupi gjykues ka komunikuar me anë të postës elektronike me subjektin e rivlerësimit, sipas nenit 46 të ligjit nr. 84/2016, si dhe gjatë seancës dëgjimore. Në të gjitha komunikimet, subjekti ka qenë në çdo rast i gatshëm, duke u treguar tërësisht bashkëpunues, pasi i është përgjigjur me korrektesë dhe brenda afateve të caktuara të gjitha pyetjeve, duke dhënë shpjegime në mënyrë shteruese për informacionin e kërkuar dhe duke paraqitur në dokumente shkresore për të vërtetuar pretendimet e tij, sidomos në lidhje me dy pasuritë e përfituara nga bashkëshortja, me dhurim nga prindërit e saj dhe një pasuri tjetër në pronësi të prindërve të saj. Gjithashtu, Komisioni konstatoi se subjekti ka dhënë shpjegime të detajuara në lidhje me pretendimet e ngritura në disa denoncime, duke argumentuar në çdo rast shkaqet e veprimeve apo mosveprimeve të tij. Gatishmëria dhe qëndrimi bashkëpunues gjatë gjithë procesit janë mbajtur në konsideratë gjatë procesit të vendimmarrjes, sipas parashikimit të nenit 48 të ligjit nr. 84/2016.



## **VI. KONKLuzion Përfundimtar**

**109.** Bazuar në parimet e barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë, si dhe në parimin e proporcionalitetit sipas pikës 5, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, në përfundim të procesit të rivlerësimit Komisioni krijoi bindjen se:

- Referuar nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut IV të ligjit nr. 84/2016, lidhur me kriterin e pasurisë, subjekti i rivlerësimit Drini Pali ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë sipas nenit 59/a të ligjit.

- Referuar nenit DH të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut V të ligjit nr. 84/2016, lidhur me kriterin e pastërtisë së figurës, subjekti i rivlerësimit Drini Pali ka arritur nivel të besueshëm për kontrollin e figurës sipas nenit 59/b të ligjit.

- Referuar nenit E të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut VI të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit Drini Pali ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale sipas nenit 59/c të ligjit.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Trupi gjykues, pasi u mbledh në dhomë këshillimi në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar sipas parashikimit të pikës 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, bazuar në germën “a”, të pikës 1, të nenit 58 dhe pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

### **V E N D O S I:**

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Drini Pali, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.
2. Vendimi, i arsytuar me shkrim, i njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjektet e interesuara brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 18.01.2022.

### **ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES**

**Etleda ÇIFTJA**  
**Kryesuese**

**Firdes SHULI**  
**Relatore**

**Roland ILIA**  
**Anëtar**

*Sekretare gjyqësore*  
*Ertugena Sokoli*